

Në një tekst shkollor, botuar nën kujdesin e Ernest Koliqit, në kohën kur ishte ministër i arsimit në Shqipëri, në treguesin e emrave në fund të librit, shkruhet:

LUX SECRETA: Asht pseudynimi i zonjushës Luçija Seregji nga Shkodra. Vjershat e veta i ka shkruar nëpër disa të përkohëshme.

LUX SECRETA

poetja dhe përkthyesja shkodrane e viteve '30

Nga Andreas Dushi

NË FILLIM RA ZYLO

Fatbardh Amursi (Rustemi)

... unë që ia njihja krijimtarinë, për të mos thënë kisha regjistruar të gjitha luhatjet e tij, shkova përtej shakasë, pasi kisha bindjen se rrëzimi i Enver Hoxhës, u paralajmërua me rënien e shokut Zylo. Ky konstatim mund të shkaktojë habi, por shpresoj ta marrë pëlqimin tuaj...

(fq. 6)

Një perspektivë ndryshe mbi poezinë e Lleshanakut

LOJA/AMBIGUITETI ME VDEKJEN – SI ËSHTË DASHURIA?

nga Ballsor Hoxha


(fq. 7)

Poezia e Luljeta Lleshanakut është gjuhë e cila shkëputë shenja, gjymtyrë, situata, e kohë, për të ndërtuar metafora poetike narrative, universe në vete, që është në të vërtetë hapje dhe përballje me ankthin e të qenit, gjegjësisht me vdekjen. Me vdekjen e kudondodhshme dhe me vdekjen në çdo moment...

LLAMBO RUCI

Përkthyesi më i mirë i vitit
2019

(fq. 10)



ANTHONY HOPKINS:

‘Veproni sikur është e pamundur të dështoni’

(fq. 18)

**A ka patur
armiqësi letrare
WILLIAM FAULKNER
ERNEST HEMINGWAY**



(fq. 21)



Foto Marubi

Reflektime mbi aktualitetin e historisë:

RASTI "ARBNI HISTORIK, GJEOGRAFIK, KISHTAR DHE POLITIK" I AUREL PLASARIT

(fq. 12)

Nga Artan R. Hoxha, Ph.D.

Si mundën historianët të kapërcejnë kufijtë ontologjikë që disiplina e historisë imponon mbi periodizimin e historisë? Si mund të lexojë një historian që studion shekullin XX një provë mbi shekujt XI–XIV? Në çfarë mënyre, një libër që shqyrton ...

BIBLIOTEKË

Zija Çela

Fluturimi i dytë

(fq. 11)

Richard Desjardins

Natak

Arbër Selmani

Adam

(fq. 14)

Meti Disha

*Kujtimet në shtambën
e harresës*

(fq. 15)

Isak Dinesen

Unaza

(fq. 22)

PËR VEPRËN E RULFOS

Nga Bajram Karabolli

(fq. 16)

Aty nga viti 2000, rastësisht, në një revistë letrare në Buenos Aires, lexova tregimin *Thua ju të mos më vrasin* të shkrimtarit meksikan Huan Rulfo. Ky lexim më la një mbresë të fuqishme. U mahnita me artin magjik...

LUX SECRETA

poetja dhe përkthyesja shkodrane e viteve '30

Nga Andreas Dushi

Për Lux Secreta ka pak të dhëna. Për herë të parë, emrin e saj e lexova në një tekst shkollor, botuar nën kujdesin e Ernest Koliqit në kohën kur ky i fundit ishte ministër i arsimit në Shqipëri. Në treguesin e emrave në fund të librit, shkruhet:

LUX SECRETA: *Asht pseudynimi i zonjushës Luçija Seregji nga Shkodra. Vjershat e veta i ka shkruar nëpër disa të përkohëshme.*

Deri atëherë, e kisha dëgjuar vetëm si ide ekzistencën e saj, veç nëpërmjet pseudonimit, por pa u përballur drejtpërdrejt me të. Prandaj, vendosa të kërkoja materiale që mbanin autorësinë e saj.

Në një shënim të Nasho Jorgaqit (2018), lexojmë “...Zërit poetik të vajzës gjirokastrite (bëhet fjalë për Selfixhe Ciun) do t'i bashkohej ndërkaq zëri i vajzës shkodrane Luçie Sereqi (1910-1993), që nënshkruan vjershat e saj me pseudonimin Lux Secreta...”

Sikurse lexohet, Koliqi shkruan *Luçija Seregji*, ndërsa Jorgaqi, *Luçie Sereqi*. E vërteta është se kemi të bëjmë me të njëjtin person – çka na e tregon edhe pseudonimi i përdorur prej saj – emri i të cilit nuk shkruhet saktë në asnjërin rast. Kjo del po të konsiderojmë një dëshmi tjetër, atë që ndoshta është më autentikja, shënimin e fotografisë së saj në Muzeun Kombëtar të Fotografisë *Marubi*. Në fotografinë e shkrepur nga Geg Marubi më 1940, emri i saj është shkruar *Luçie Serreqi*.

Gjatë komunizmit, emri i Serreqit nuk përmendet thuajse asnjëherë, ndërsa pas tij, mund të jetë

përmendur shumë rrallë, më tepër si ide – njohje me faktin se ajo ekziston – por jo konkretisht. Prandaj, kërkimi duhej orientuar para ardhjes së komunizmit, gjithnjë bazuar në të dhënat e marra nga dy shënimet e sipërcituara.

Kështu, zbulova çka po paraqesim në vijim: Disa poezi të botuara në të përkohshmet “Illyria” dhe “Cirka” përgjatë viteve 1935 – 1938. Sigurisht, kjo nuk përjashton mundësinë që krijimtaria e saj të ketë filluar më herët dhe/apo të ketë mbaruar më vonë, prandaj, ky shkrim shpresoj të shërbejë si nxitje për studiuesit, që ta konsiderojnë seriozisht edhe emrin e Serreqit.

Përkasshi përkthimit që ajo i bën nga frëngjishtja poezisë “Nanës s’ëme” të Pashko Vasës (marrë nga vepra e panjohur e tij “Rose e spine”, botuar në vitin 1873, për të cilën do të mund të lexoni në javët e ardhshme), botuar në “Cirka”, 1938, nr. 43, 10 prill, f.101, lexojmë: ...*Mâ andej po botojmë poezin e parë të librit “Rose e spine” në përkëthimin e bukur e besnik qi bâni për lexuesat e “Cirkës” stermesa e Pashko Vasës, bashkëpuntorja e jonë Zonjushë Lux Secreta.*

Pra, këtu marrim vesh edhe faktin se ajo ishte stërmbesë e poetit Pashko Vasa.

Në poezinë e saj, motivet janë ndër më të përhapurit ato vite: pastorale dhe kombëtare, trajtuar këndshëm në lirikë.

Renditja e mëposhtme është kronologjike, duke filluar me krijimet autentike e më pas, përkthimet.

Flamurit¹

Kaluen, ndonse kadalë, vuejtje e mjerime
Qi qindra vjetsh Shqipnín paten ngujue,
E tash dhe Shqipja krahët i ká t’shtrime
Mbí pelhurë n’t’kuq ngjyrtue.

S’u trëmbet mâ kërcnimeve qi motit,
Deshten m’e bâ të pá-kénun mbi ket botë
Njat tokën e fatosit t’madh, Kastriotit,
Qi sod gzon liri t’plotë.

Tash qi Flamuri valvitet nën kupë t’qiellit,
Difton se i mbushen njëzetetre vjet
Ç’së gzon përherë, nën rreze t’arta t’diellit
I lír n’tokën e vet.

Shtiellu n’ajrí, dija plakut bujár
Qi t’shkúndi për tokë pluhnin e robnís,
Qi t’naltoi n’Vlonë e t’bâni mâ krenár
Nepër çdo kând t’Shqipnís.

Shtiellu n’ajrí e nën fletë t’shpëndit t’zí
Rueje ket tokë me gjak fatosash lámun,
T’cillt s’u kursyen e për me t’pá n’lirí
Deken me ndër kan bâmun.

Rrnosh prá për jetë Flamur i ynë n’liri,
Rrnosh tue e gzue përherë kombin shqiptarë
Qi jetë I uron sunduesit t’ksaj Mbretnî
Mbretit t’vet ZOGUT i PARË.

Brí i lisit të rrxuem²

N’skáj të fushës n’blerim stolisë e në lule veshë,
Ku ajri i pastër percejellë jone t’lehta
Te’ i lis i rrxuem shtegtari pá pritë ndeshë...

Asht lisi qi mbí tokë për sá qindvjeta
Nuk ju përkul stuhís as rrfës kërcnuese,
Por tash mbí tokë i mbaroi ditt e veta.

Kje sá herë për shtegtarin lândë ngushlluese,
Sá herë nën hije t’tij merzín largonte
Nën lvizje t’degve t’tija shungulluese.

Brí tij dikúr sá gjânat i ândrronte
Nen t’Shqypes çerdhe, qi n’kujdes ndërtuemun
E kish per zogjt e vet, ç’n’të kaluemet mote.

Ândrra e dikurshme tash kishte kaluemun
Bashkë me trup t’lisit qi nën kup’n e qiellit
Tash s’bâte hije t’xëtít me i larguemun.

Me mâll kujton at kohë kur nder dit prillit
Bariu me fýll i ndillte t’qeta udhtime,
N’sá grigj’t pushojshin larg rrezeve t’diellit.

Sá herë gjuetari ulë brí tij plot gzime,
Me shokun e vet besnik prej gjahut kthymun,
Vrete sá shpënd qi vrau, me shum mundime.

Por mbasi lisi detyren e ká kryemun,
Mbí tokë pushon, tue dashtë ktë t’falnderojë,
Tue pritë dhe ato qi brí tij i janë shtýemun.

Për me përshndetë, pse mâ s’mund t’i pranojë
Nën t’pastrën hije, ku pau e ndieu sá gjâna
Për të cilat mâ nuk flet, s’difton... s’ká gojë,

Mbasi u shuen për të dhe dielli e hâna.

Së ndihet mâ fyelli³

Lodhun delet prej diellit
Mrizojnë nen t’hapten hije
T’degve qi nen kupë t’qiellit
Lshon ahi, n’sá per bríje
Vú kryet permbí tesha
Pushon dhe blegtoresha.


Dhe dy sýt t’kjarët si drita
Fillon m’i a rrëjtun gjumi,
Pse sá kish nisun dita,
Sá ishte freskue n’ujë lumi,
Tue pshtjellë kryet n’rubë me lara
Kish vûe berret përpara.

Hova hova e lét era
Lote me flokët e shprishun
Qi n’báll lshote perhera,
Dhe permbí pëmë, si t’grishun,
Tubë zogjët ishin vëndue
Si t’dojshin me këndue.

S’ish ditë qi nât kohë zhegu
Mos t’a trazote fylli
Qi bite nât anë bregu,
Dér n’kohë qi i mbramjes hylli
Niste atje nalt me ndritë
Si shëj se s’kish mâ ditë.

I gëjatë prá s’ish pushimi,
Pse, bash nder jone t’para
E çote ambel tingllimi
Qi tue pershkue sá ara
I kthielltë nder veshë i vîte
Thue se krejt ngëjet sajë bite.

Por n’ket ditë për çudí
Kush-di çka do t’ândrrote
Blegtoresha, e s’kish ndí
Fyellin qi prorë e gzote.



S'ndihej gjà nat anë lumi...
S'kish çka me e çue prej gjumi.

Ç'prej asajë ditë perhera
Dote me dijtë, pse s'ndihej,
Pse nuk i a bite era
T'fyellit jonet?... e mnîhej,
Pse s'e gzote n'kohë t'qetë
Veç kanga e zogjve e letë.

Kish muejtë dikûr t'hetote
Larg n'nji fushore t'blerë
Nji barí, qi pushote
Dhe aj, n'sá e kandshmja erë
Kangët i a trette pá dá,
Por tash, s'u shifte mâ.

Tue dalë me dele shifej
Nji plakë prej vjetësh perkulë,
Por fyelli mâ nuk ndihej.
Blegtoresha, tu u ulë
Bregut, shpesh desh me pvetë
Çka fyellin e kish gjetë...

Çerdhja e prishun⁴

Q'kahmot nen strehë nii çerdhe,
Me shum kujdes ndertue
Pritte nji „mirë se erdhe“
Dallndyshës me i a drejtue,
Porsá t'kthehet prëndvera
Permbî fushat e blera.
Sá t'kthiellë ruejti kujtimin
E ditve qi kaluene
Kûr t'vogjilit zogj gezimin
Mrênda sajë e provuene,
N'sá nana fluturim
I siellte pak ushqim.
Atje prej vëndesh t'xéta
Dallnysha shpesh ândrrrote,
N'sá i shkûndte t'létat fleta
Ndoshta dhe u permallote,
Dishrote qi perhera
T'rrite mbî tokë prëndvera.
S'kish gzim nder vënde tjera
Veç t'ftoftit e ngushtote
M'e lânë, sá t'hikte vera,
Çerdhen qi fort e dote,
Kohë t'gjata me kalue
N'vënde qi s'kish dishrue.
Po pse, dallnyshë e ngrata!,
Pse s'gzon nder vënde tjera?
Dhe atje me krânde t'thata,
Si i gjete ktû perhera,
Çerdhen do t'kësh ndertue.
Çka prá atje t'bân me psue?
Dishron vëndin e dashtun,
T'pelqen veç çerdhja e vjeter,
Rreth s'cilles, tue mos drashtun,
U knaqshe, s'dojshe tjeter
Banim mâ t'mirë e t'qetë
Se atë qi e lae të shkretë.
Shpejt prá se erdh prëndvera,
Gatou per fluturim;
Hidhu kah t'shtýeje éra,
Largoje ç'do mjerim;
Persndeti vëndet tjera
E kthe nder fusha t'blera.
Sá ké me u gzue kûr, s'largu,
Çerdhen ké me hetue,
Me u shkputun ké prej vargu,
Shoqet ké me i kalue;
Porsé çka pate ândrrue
Sot shum ká me t'trishtue.
Ké me kerkue, por kot,
Nuk ké me gjetun mâ
Çka pate ndreqë kahmot;
Si ké tash me i a bâ?
Kush t'a rrenoi banimin,
Kush po t'a siell mjerimin?
T'u kput pra shpresa e jote,
Tash siellu rreth plot vajë,



Dikuer zêmra t'u gzote,
Por tash s'ké mâ uzdajë.
Nuk kan me t'pá mâ fmija
Qi tash janë mshehë nder shpija.
Ndoshta tash janë pëndue
Pse kot t'a prishen çerdhen.
Shoqet qi ké kalue
Qe, shpejt mbas tejet, erdhen,
Gjeten t'vetat banime,
Veç ti... Provon idhnime...

Geraldina është e jona⁵

Letas fletët tue i shkundun Prilli
T'ditve t'bukra qi pat êndë,
Permbî lule t'hieshme dielli
Dishka thotë... doshka permëndë...
“Gzonju t'lume! se po u prînë
Sot Mbretnesha Geraldinë”

Lulja e bardhë! si njajo bora
Qi mlon malet e Shqypnís,
Kû sot zânat dora dora
Valle kndojnë qi n'veshë t'njertzís
Hova hova i bjen jehona:
“Geraldina është e jona”.

“Geraldinë mirë se na erdhe,
-Zogjt e shqypes t'thonë n'harë-
Tash pjestare e s'onës çerdhe
Je o Mbretnesha e jonë e ré”
“Mirë se T'prûni e bardhë prëndvera”
-N'gzim brohrisnin fushët e blera.-

Larg shkon jehu, vallja tretë
Permbî male e pertej detit,
Vala valen ka' e persndetë
Larg diftojnë per nuse të Mbretít,
Nalt mbî ré t'shkojnë vallet t'ona:
“Geraldina është e jona”

Geraldinë! t' argjantat gurra
N'gzim T'persndesin tu' u shperdà,
N'sá poshtë ulen neper curra
Valle e fej qi n'mal pá prâ
Sot po ushtojnë e blegtoresha
N'gzim t'persndetë o e bardhë Mbretnesha.

Permbî lule kûr bylbyli
Me shum mállë kangen pertrinë,
Shpesh do fjalë vetem zymyli
Zogut t'vogël po i a ndinë
Kur mënë zhurma n'kopshtë te e vona:
“Geraldina është e jona”

Erdh dallnysha si perhera,
Erdh ner né, por dishka tjeter
Çka s'kish ndî n'tjerat prëndvera
Tash po e ndinë, e n'çerdhe t'vjeter
Mâ me gzim n'fluturim drejtohet,
Kanga e sajë nalt ambel çohet.

Sà me gzim vashat shqyptare
Kûr n'lulishtë lule kerkojnë,
Lule t'bukra t'tokës amtare
Qi po çilin, po lulzojnë,
Thonë: perherë tash me kndue dona:
“Geraldina është e jona”

Foto Marubi

PËRKTHIME

Egoizëm e dashteni – Giacomo Zanella6

Kur dimni acar pyllin e zdeshtë gjethsh të bléra
Larin krenár e mnij për veshë t’papkun
Kah gzon, pse s’mujt ndo’i herë as bora as éra
Stolín m’ja hjekun.

Lulzim për kodër t’shkretë e krejt të zdeshun,
Por as mâ të voglit shpënd me fryte t’veta
Nuk mujt me i dhânë ushqim kur n’tê tue ndeshun
Pushoj me fleta.

Vetëm për tý, o hardhí, gjëj falnderime
Qi n’sá bjen bora e ara e bímë krejt mblon,
Kah shef për rreth natyrën e mbarë të píme
Për tjerë ankón.

Kur éra frÿn e lott t’i shkúndë për dhét
Ti me krye ulët qindron. N’sá plaku gzueshëm
Bri votrës kû i shndritë flaka ftyr’n e zbét
Shikjon mëndueshëm.

Nji gotë t’mbushun me’ i láng të kuq si gjaku
Tue u dridhë e avitë e tu buzët e çon,
Ndërsá kullosa e korra t’arta plaku
Me gzim ândrron.

Nanës s’ême – Pashko Vasa7

Ktu, n’sá ka pak e ka pak qielli errsohet
Per mbas malesh kah shkon dielli tue rá,
E hana prej ánës s’lindjes naltesohet,
Ktû n’sá n’heshtim e vetmitár, pá prá
N’luftim t’eger dashtninash, nper udhë t’qetë
Endem porsi njeri qi s’shpreson mâ,
Nji e permallshme harmoní létë, letë,
Shqiset amel m’i lmon e m’duket mue
Se po ndij zânin e nânës s’ême t’shkretë

Qi njinji vjerrsha e lot m’bân me dikue.

Po, n’frushullime t’ambëla
Të flladit t’natës un ndij
O nânë, njat gjâmë t’mallnjyeshme
Qi ti ma lshon nâjri;
Ajo nji jeh mizuer
Lshon t’birit tand n’krahner
Qi idhnimin tand t’pamatun
Me mënd e paraqet.

Sá herë n’rrezen e dridhëshme
Te diellit tuj prëndue
O Nanë! sÿnin e thekshëm
E nguli aj tuj vajtue!
Sá herë ksajë rreze yt bír
T’flaktin per ty dishír
Mbesue i a ká prej t’msheftave
Shëjtnore t’zëmres s’vet!

Ah kjáj, po kjáj o qyqëja
Nanë, e shfre dhimen n’vajë,
Dashtnìn e’i nânës m’u shuemun
As kohë as vënd s’múnd t’bájë!
Kjàn edhe yt bír pre’ idhnimit
N’vetmín e vrashtë t’mergimit
Dikùr prap m’u bashkuemun
Por tuj shpresue gjithnji.

E din se q’së ndritë t’qiellit
I çili sÿt e mjerë
N’ zëmer nji shpresë e àmelë
T’buzqeshi po q’at-herë...
N’gazmënd e n’lumtuní
T’and bír m’e shterngue ngjí...
N’shpírt me mâ t’parat andërra
Njikshtû shpresojshë ti.

Qe ç’shpresë! Por tash flijuemun
Per nji dashtnì madhshtore
Qi t’gjitha i kalon megjet
E çfardo flakës toksore,
Lojë e nji t’ziut tirâ


Pré e nji t’ashpřit mullâ,
Jyt bir, nânë e mjerueme,
Prej tejet larg lngon sot.

E mâ do t’lngojë, n’kjoftë shekulli
Prej gjumit t’zì se s’lkundet,
N’kjoftë se njerzimi i lirëshem
Me kënë ktu n’tokë nuk mundet,
N’kjoftë se i Shqypnís ngashrimi
S’do t’gjëjë kurrfarë ngushllimi
E n’kjoftë se i lumnís gjeni
Do t’jët i thirrun kot.

T’agojë, t’agojë e kthiellëta
Ditë dhimen qi t’pasojë,
Qi dishiret e zëmëres
T’i mbushë e t’i vlerësojë;
Tuj e bekue tand bír
N’kohë te rrezikut t’vshtír
I shton forcë per me kthymun
Prej lamës me plot ngadhnjim.

Shpreso, o e mjerë. Prej t’mektave
Fshâmë t’ua nji herë prâjë;
Nji forcë ást qi t’gjith njerzit
Baras per dekë múnd t’bájë!
Atëherë na t’gjith bashkue,
Dishiret n’né plotsue,
N’gzim t’njaj dashtnis do t’knaqemi
Qi kurr nuk ká mbarim.

¹ Flamurit. - Illyria, 1935, nr. 32, 28 nëntor, f. 4.
² Bri i lisi të rrxuem... - Illyria, 1936, nr.38, 11 janar, f.2.
³ Së ndihet ma fyelli... - Cirka, 1937, nr.17, 28 shkurt, f.45.
⁴ Çerdhja e prishun. - Cirka, 1937, nr.20-21, 9 maj, f.83.
⁵ Geraldina asht e jona. - Cirka, 1938, nr.44, 27 prill, f.114.
⁶ Egoizëm e dashtëni. Përkth.: L. Secreta / - Illyria, 1935, nr. 30, 9 dhjetor, f. 6.
⁷ Nanës s’eme. – Pashko Vasa /Përkth. : L. Secreta - Cirka, 1938, nr.43, 10 prill, f.101.



REFLEKTIME MBI AKTUALITETIN E HISTORISË: RASTI “ARBNI HISTORIK, GJEOGRAFIK, KISHTAR DHE POLITIK” I AUREL PLASARIT

Artan R. Hoxha, Ph.D.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Si munden historianët të kapërcejnë kufijtë ontologjikë që disiplina e historisë imponon mbi periodizimin e historisë? Si mund të lexojë një historian që studion shekullin XX një sprovë mbi shekujt XI–XIV? Në çfarë mënyre, një libër që shqyrton dinamika dhe procese historike të Mesjetës mund të jetë i vlefshëm për dikë puna e të cilit përqendrohet te transformimet socio-ekonomike dhe kulturore të shekullit të shkuar? Ashtu si ndodh me të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore, edhe zgjerimi i dijeve historike sjell ndarjen e vijeshme të punës, që përgjithësisht shprehet në specializimin tematik apo kronologjik. Veçse këto ndarje pavarësisht kriterëve mjaft të vlefshme që përdoren për t'i krijuar ato, janë artifice intelektuale, që kanë si funksion njohjen më të hollësishme të historisë përmes ngushtimit të fokusit të punës kërkimore. Por shpesh, sidomos kur vjen fjala për studimet historike, ndarjet e mëdha kohore që më konkretisht janë Lashtësia, Mesjeta, Periudha Moderne dhe ajo Bashkëkohore trajtohen si kuti të shkëputura, të cilat nuk komunikojnë me njëra-tjetrën. E vërteta është më e ndërlikuar. Shkrimi i historisë, edhe ai për periudhat më të largëta është një akt thellësisht aktual, që përcaktohet gjerësisht nga rrethanat historike si dhe nga debatet teorike dhe ideologjike të kohës në të cilat shkruan dhe jeton historiani. E thënë ndryshe, edhe studimet mbi Mesjetën apo Antikitetin prekin në fakt problematika me mjaft rëndësi për ditët e sotme.

Një gjë e tillë është veçanërisht e vërtetë për studimet që analizojnë formimin e identitetit etnik dhe kombëtar, rrënja e të cilëve shtrihet në Mesjetë. Këto analiza paraqesin interes sidomos në kuadrin e debatit mbi nacionalizmin. Sikundër kanë argumentuar shumë studiues së fundmi, përfshi edhe medievist, teza e zanafillës mesjetare të kombeve europiane është një sajësë e nacionalizmit. Kombi, thonë ata, është një krijesë e periudhës moderne. Ndaj çdo përpjekje për të argumentuar se Mesjeta është periudha e ngjizjes së kombeve të Europës përbën një manipulim me karakter politik në funksion të programeve nacionaliste dhe miteve që e mbajnë atë në këmbë. Por ka edhe të tjerë, të quajtur ndryshe primordialistë, që argumentojnë se rrënja e kombeve moderne është më e vjetër dhe se ndryshe nga sa thonë modernistët, ajo nuk duhet identifikuar vetëm te proceset ekonomike, politike dhe ideologjike të epokës moderne, por shtrihet më herët, tek etnitë e Mesjetës, të cilat kanë shërbyer si një themel për ndërtimin e kombeve moderne dhe i parapriu atyre.

Pikërisht një çështje të tillë trajton edhe studimi “Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik” i Aurel Plasarit, i cili plotëson temën e trajtuar prej tij mbi Skënderbeun dhe shtetin e drejtuar nga hero i ynë kombëtar. Në qendër të kësaj sprove është procesi kompleks që shndërroi emrin e një krahine të ngushtë të fasadës adriatikase, të lokalizuar në atë që sot është Shqipëria e Mesme, në një emërtim territorial etnik. Duke rilexuar nga një prizëm i ri dokumentacionin që tashmë njihet prej historianëve, Plasari hedh dritë mbi një varg çështjesh që kanë pasur dhe vijnë të kenë një domethënie mjaft të madhe politike. Ndër to është i ashtuquajturit hiatus nëntë shekullor nga Albanët e shekullit II të erës sonë të përmendur nga gjeografi grek, Ptolemeu, tek rishfaqja e tyre në burimet e shkruara në shekullin XI; si dhe raporti midis formimit të etnosit, ndërtimit të identitetit etnik dhe shtetformimit ndër arbrit.

Kriteri historik me atë politik kanë qenë pazgjidhmërisht të lidhur në afirmimin kombëtar të lëvizjeve nacionale përgjatë shekujve XIX–XX. Në fazën e lartë të imperializmit europian, përgjatë

shekullit XIX, europianët i ndanë popujt në dy grupe, në ata me histori dhe ata pa histori. Sipas këtij kategorizimi, vetëm popujt me formacione shtetërore, me institucione dhe kulturë të sofistikuar elitash që kontrollonin pushtetin politik cilësoheshin si kombe, e për rrjedhim, kishin histori. Popujt e tjerë, ata të cilët nuk identifikoheshin për nga etnia me parinë që kontrollonte pushtetin politik cilësoheshin si popuj pa histori. Kjo ndarje, e lindur në elitat politike, ekonomike dhe kulturore europiane shprehte raportet e pushtetit ndërmjet këtyre të fundit dhe pjesës tjetër të botës. Në një botë eurocentrike, ku fuqitë europiane nisën të modelonin botën sipas imazhit dhe interesave të tyre, klasifikimi i popujve me dhe pa histori krijonte hierarki që justifikonin imperializmin dhe ekspansionin europian në botë. Kështu, nën petkun moral të “misionit civilizues” apo atij racist dhe më të singërtë të “barrës së njeriut të bardhë”, popujt me histori fituan të drejtën të impononin autoritetin e tyre mbi popujt pa histori.


Ky kategorizim pati një rëndësi të dorës së parë për lëvizjet kombëtare të Ballkanit, aktivistët e të cilave nxituan të përdornin historinë si mjet për të legjitimuar themelimin e shteteve të tyre kombëtare si dhe shtrirjen e tyre territoriale. Nacionalizmi në qoshen juglindore të Europës huazoi gjuhën dhe ideologjinë e imperializmit të fuqive europiane. Shtetet e reja të Ballkanit, të dala nga kalbëzimi i pandalshëm i Perandorisë Osmane, teksa nxituan ta cilësonin veten si përfaqësuese të popujve me histori, nuk vonuan t'i emërtonin popujt fqinjë si grupe pa histori. Shqiptarët do të ishin një nga viktimat kryesore të këtij racizmi historik. Jo vetëm që ideologët dhe aparati propagandistik i shteteve serbe,

greke dhe bullgare do t'i cilësonin shqiptarët si ardhacak të kohës së Mesjetës në trojet ku ata jetonin – duke humbur kështu përparësinë që jepte autoktonia dhe lashtësia – por ata argumentuan gjerësisht edhe se shqiptarët nuk kishin histori, nuk kishin pasur shtet të tyrin dhe prandaj si etnos nuk gëzonin aftësi shtet-formuese. Prej kësaj, cilësoheshin si inferiorë dhe legjitimohej shndërrimi i tyre në subjekt të nënshtrimit nga etni superior. Kjo do të thoshte se shqiptarët humbnin të drejtën të kontrollonin vetë territorin ku ata banonin. Vërtetimi i autoktonisë dhe i aftësive shtetformuese të shqiptarëve, të cilat do të shpreheshin me krijimin e një elite politike dhe kulturore vendase ka përbërë një tematikë shumë të rëndësishme për historiografinë shqiptare. Teksa përpiqeshin të vërtetonin vijmësinë iliro-arbërore dhe shtetformimin si proces endogjen në radhët e arbërve, historianët shqiptarë synonin të delegjitimonin tezat e kolegëve të vendeve fqinje, që i shërbenin projekteve nacionaliste të shteteve përkatëse. Pra, tematika që trajton Aurel Plasari nuk është aspak e shkëputur nga historia bashkëkohore, por është pjesë e historisë politike të saj si dhe debateve ideologjike që kanë rrethuar lëvrimin e dijeve shoqërore në Shqipëri dhe Ballkan.

Merita e Plasarit nuk lidhet vetëm me përfshirjen e tij në këtë debat, por ajo shtrihet edhe në risitë metodologjike dhe konceptuale. Përmes analizës ndërdisiplinore që ndërthur qëmtimin e imtë të burimeve tekstuale me kontekstin politik vendas, rajonal e mesdhetar, si dhe faktorët ekonomik, fetar dhe kulturor të kohës, Plasari flladit debatin e polarizuar të historive kombëtare të rajonit. Në këtë studim, Plasari analizon se si emërtimi i një krahine dhe banorëve të saj u shndërrua gradualisht, në shekujt e Mesjetës së Lartë dhe të Vonë në etnonim, i cili do të përfshinte të gjithë grupet që flisnin një gjuhë të ngjashme. Argumenti i tij të sjell në mendje përkufizimin që antropologu i njohur norvegjez Fredrik Bart ka dhënë për etnosin. Sipas Bart, etnosi është një grup që diferencohet kulturalisht nga grupet e tjerë, proces ky që ndodh në kufijtë e tij, aty ky sendërtohet vetëdija mbi “veten” dhe “tjetrin”. Pra, Bart, nuk e sheh krijimin e identitetit etnik si një proces endogjen, por si ekzogjen, ndërveprues, ku ideja e “Ne” ndërtohet nga marrëdhëniet dhe ballafaqimi me të ndryshmit.

Një qasje të ngjashme mban edhe Plasari, i cili heq dorë nga ideja shpesh e pranuar *a priori* ne literaturën historike shqiptare – ku Plasari i quan “ide të ngulëta” – e cila i ka mëshuar proceseve endogjene, që zhvillohen brenda grupit. Në ndryshim nga këndvështrimi i deritanishëm, Plasari e shikon procesin e shndërrimit të emrit të fushës që shtrihet midis Matit dhe Erzenit – e cila quhej Arbni, që nënkuptonte ultësi – në emërtimin e një formacioni politik si “Principata e Arbrit” dhe më pas “Mbretëria e Arbrit” si një dukuri që ishte në thelb ekzogjene. Shturja e Perandorisë Bizantine, dalja në skenë e Despotatit të Artës, ekspansioni serb dhe ai katolik, si politik ashtu edhe fetar ishin faktorë themelor në shndërrimin e emrit të një krahine në një koncept politik. Nuk do të vononte dhe emri Arbëri do të shërbente si identifikues edhe për popullsinë që u përfshi brenda kufijve të saj politik. Shumë shpejt, arbër do të shndërrohej në një etnonim dhe do të kapërcente kufijtë politikë të shtetit të Arbrit dhe do të shtrihet përtej tij për të gjitha popullsitë që flisnin arbërisht.

Ky studim i Aurel Plasarit është pjesë e një vargu punimesh të botuara vitet e fundit në Shqipëri, që synojnë të injektojnë metoda dhe qasje te reja lidhur me analizimin e të shkruarës – e për rrjedhim nxisin edhe një mënyrë të re të të parit të së tashmes. Ndryshimi që sjell Plasari, në krahasim me këto qasje te reja qëndron në shkallën e rishikimit prej tij të tezave që kanë dominuar deri vonë mendimin historiografik shqiptar. Në dallim nga studimet e “reja”, që, në frymën migjeniane të paradigmës së “kthesës kulturore” të postmodernizimit kërkojnë përmbysjen e të “vjetrës”, “Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik” nuk kërkon të flaki në si të pavlera punimet e studiuesve të “vjetër” shqiptarë. Në fakt, studimi i Plasarit, më shumë se sa një analizë kritike e ideologjisë që fshihet mbrapa teksteve historike është një përpjekje për të ritrajtuar një çështje të mprehtë historike dhe politike. Më shumë se sa spekulim studimor i raportit mes historisë dhe politikës, “Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik” përfaqëson një rrekje për të ndërtuar ura lidhëse që lejojnë një kalim evolucionar mes brezave dhe jo një ndërprerje revolucionare të traditës së shkrimit të historisë. Për rrjedhim, ky studim këshillon edhe një rivlerësim më të kujdesshëm të së tashmes.



NË FILLIM RA ZYLO

Fatbardh Amursi (Rustemi)

“Sa herë që kalonim tek Shkëmbi i Kavajës, i thosha Sadijes: Ai shkëmb atje lart, prite kur të bjerë. Do ti që ra vërtetë.”-do më thoshte Driteroi vite më parë tek pushonim së bashku në Divjakë. Edhe pse po luante me ndjesinë e profecisë, me aftësinë e të parashikuarit, gjë që i njihej vetëm udhëheqësit, rrjedhimisht edhe shokut Zylo, unë që ia njihja krijimtarinë, për të mos thënë kisha regjistruara të gjitha luhatjet e tij, shkova përtej shakasë, pasi kisha bindjen se rrëzimi i Enver Hoxhës, u paralajmërua me rënien e shokut Zylo. Ky konstatim mund të shkaktojë habi, por shpresoj ta marrë pëlqimin tuaj, kur të mbaroni së lexuari këtë esse. Instiktet e shkrimtarit e arrijnë të vërtetën e pritëshme më shpejt nga vetëdija e tij, në tentativën për të shpëtuar nga ngurosja e klisheve, shablloneve, dogmave, duke kërkuar shpëtim. Këtë betejë e fitojnë vetëm të talentuarit, të tjerët kanë fatin e fosileve të kohës. Në sa e sa autokritika dëgjoje të ankoheshin se pa kuptuar qenë bërë armiq, sikurse bëheshe armik me zor. Ky lloj armiku, që i trëmbeshin të gjithë, ndihej frika ndaj një gabimi të mundshëm, ndëshkohej nga çensura me ndalim të krijimtarisë, ku të gjithë kanë “robërit” e tyre. “Arma edhe kur shkrepe pa dashje të vretë”-do e mbyllte Kadareja autokritikën e tij në mbledhjen autodafe për “Pashallarët e kuq”. Kjo shkrepe pa dashje, nuk i bindëte autoritetet, pasi duhej të kishte shtyrë dikush. Të gjithë shkrimtarët dhe artistët e talentuar ishin të dyshuar, nuk u zihej besë. (Lum kush e ka shkrimtarin pranë, në rastin tonë këtë fat e pati Demka dhe, mjerë kush e ka shkrimtarin afër, dhe ky kob i ra Zylos.) Në Shqipërinë komuniste konflikti më i mprehtë ishte ai midis zyrtarëve (Zylos) dhe shkrimtarëve apo artistëve (Demkës), të cilët rezikonin ta çonin talentin dëm. Nëse zylot dhe demkat ishin palë në konflikt, Driteroi e përjetoi këtë si një

konflikt të brendshëm, ku si ofiqar ishte në shoqërinë e zylove dhe si shkrimtar në bashkësinë e demkëve. (Kur recitohet “Hakërrima” e Ali Asllanit të shkon mendja se e ka shkruar ndonjë poet revolucionar i kohës së mbretit Zog, me gjasa shok i Qemal Stafës, kur autori ka qenë kryetar bashkie dhe prefekt i mbretërisë.) Drama “Fytyra e dytë” e Driteroit në dukje i bënte jehonë luftës së degjenerimit të kadrove, a priori palë me Zylon. Si shpjegohet që drama u hoq nga qarkullimi, u ndalua të shfaqet për publikun? (Kujt i ka rastisur ta shohë Driteron në tavolina të shtruara, kur ia merrte këngës, pasi kishte kthyer disa gota dhe në kulmin e gostisë të ngrinte dorën duke lëvizur gishtin tregues, sikur po shkrepe koburen, me patjetër do u shfaqej shëmbëlltyra e Zylos.) Le ta shpjegojmë këtë realitet paradoksal me fjalët e Demkës: “Në përgjithësi unë i dubloja të tjerët dhe veten. Bëja raporte. I mbante një i dytë para njerëzve. Ai i dyti në fakt isha unë, por pa trupin tim. Ky i dyti më mbante mua fjalim dhe përpiquej t’ më mbushte mua mendjen. Eh, unë i mbajta fjalim vetes! Por, ç’ është më e çuditshmja, duke e dëgjuar këtë të dytë, (fytyrën e dytë), besoja se ato nuk ishin fjalët e mija, por, të atij.” (Kur isha student, kohë zbori, që përkonte me një kampionat botëror, dikush më thotë se më kërkonte komisar, një profesor i histori-gjeografisë. Kur futem në dhomën e konviktit, ku rrinte profesori komisar, kurrë s’ kisha parë aq tym në një dhomë, i mbledhur në fund të krevat, i shpërfytyruar më thotë: “Ata lart më kërkojnë një fjalim për studentët, që e veshin për herë të parë rrobën ushtarake. Jam krejt i bllokuar! Ju të letërsisë keni dell, ju vjen dorësh për të shkruar!” Ngaqë doja të shihja ndeshjen, nuk i bëra naze dhe: unë fol e ai shkruaj. Të nesërmen, tek fusha e sportit, meqë tabela e basketbollit bënte hije, me një shok dolëm nga rreshti dhe, në qejfin tonë. Në vesh më vinin

fjalët, që autoriteti i lartë i lexonte me një ton solemn. Ishte një përjetim i çuditshëm! “Shokë ushtarë, futoni në rreshtë dhe dëgjoni!”-Në ditët e zborit oficerët kurrë nuk na drejtoheshin si student, por si ushtar!” Pa dëshirën time më ka qëlluar dhe herë të tjera të bëhem Demkë?! Nuk u falet, nëse zylot i kërkonin tek e shkuara e harruara, ata i janë rikthyer shkëlqimit të dikurshëm. Bëmat e dikurshme ia faturuan Demkës, të cilin e quan oborrtar, duke u ankuar se regjimi e rrëzoi padrejtësisht, kështu kopja ia hedh fajet orgjinalit.) Ka një përpjekje kritizërësh për të gjetur se cili prej tyre është fajtori: eprori apo mvartësi? Është njësoj si të pyesësh shqiptarët, pse duruan aq gjatë për të përmbysur diktaturën. Zylo nuk është i vetëdijshëm për sëmundjen, që e mundon, thot kritiku në një nga nalizat stereotipe. Flitej shumë në atë kohë: të merremi me sëmundjen dhe jo me të sëmurin. Isuf Kalo, mjeku personal i Enver Hoxhës u muar me sëmundjen e tij duke e bërë fajtor, që i zgjati jetën diktatorit, ndërkohë që të gjithë i uronin udhëheqësit të merrte nga ditët tona?! Kritika vë në dukje se tek Zylo bëhen bashkë: “qëllimi i mirë me humbjen e ndjenjës së realitetit”. Duke shpjeguar kopjen pa dashur merret në mbrojtje orgjinali. Zylo manifeston huqet e sundimtarit, si shëmbëlltyrë e tij. “Personazhi negativ nuk duhet të ngjitet në kodër, kur pozitivi zbret prej saj. Është njësoj si të ngjisësh të keqen në pedestal dhe të mirën, ta hedhësh në pus.”-këshillonte shoku Zylo një dramaturg, duke përligjur ngjitjen e tij në karrierë, ku një i dytë nuk duhet ta pretendonte. E vetmja gjë që s’ ndahet me tjetrin është karrigja. Që ta shijonte naltmadhënimin e vetës, duhej t’ i shinte të tjerët të katandisur. (Shpërthimi i Driteroit ndaj shkërdhatokracisë së Nanos, shfaqet si një pakënaqësi e hershme ndaj regjimit të Zylove, pasi dhe në kohën e re, Demka ndjehej i përjashtuar.) “Demkë, ne vijmë nga legjendat! Stërgjiysi, gjysi, babai janë përkundur në djepin e legjendave. Që ta kam fjalën, unë vij nga legjendat! U përpoqa ta fshij e ta bëj pluhur këtë legjendë... Prapë legjenda nga kam ardhur më ka ndjekur... vetëm kur të shkëputem nga legjenda do të jem i qetë.”-deklarohet Zylo, duke vënë në siklet të gjithë legjendarët. Në fakt e ndiqte legjenda urbane. Dhe kush vuante nga deliri i legjendave? Të naltmadhënuemit me pushtet. (Rëndom dëgjon të thonë: legjenda e sportit, e artit.) Pikërisht, kur Zylo po tentonte të linte qiellin, e bija e Stalinit në kujtimet e saj thotë se i jati, kish tentuar të jepte dorëheqjen, por oborrtarët ia shtonin dozat e fetishizimit. E donin të fantaksur. Kur Stalinin e gjetën të rrëzuar në dysheme në grahamat e fundit, në vend që t’ i gjendeshin, “shokët e idealit” e mbyllën derën dhe e lanë të vdiste. Frikeshin, se Stalini nuk do t’ ua falte, që ata e kishin parë në atë gjendje dhe mund t’ i ekzekutonte. Në fakt me “komplotin e bluzave të bardha” ishin eliminuar të gjithë mjekët e zotë, mbështetur nga denicimi i një mjekeje. Kësisoj orgjinali mbahej peng i kopjeve, që kishte prodhuar vetë. Një i tillë ishte dhe Zylo. “Kur njeriu shpreh një mendim jashtë standartit, e pyesin për shëndetin.”-rrëfehet Zylo para Demkës, i shkurajuar. “U zhduk nga faja e dheut kisha e vjetër e Vautdejës, ku ka dhënë meshë dhe Ndre Mjeda.”-e lëshon veten Zylo në një lloj reflektimi të çuditshëm, edhe pse ai udhëhiqte luftën kundër fesë dhe zakoneve prapanike. Pse përmend Ndre Mjedën dhe jo Fishtën? Pikërisht poshtëruesi i Demkës shpreh keqardhje më shumë për poetin se sa faltoren e tij? Këto reflektime nuk jan shfaqje të distancimit nhga e keqja, por thjeshtë për të lehtësuar ndërgjegjien e molepsur.

Shoku Zylo kishte një shkëlqim të rremë. Ai pasqyronte ndriçimin e Demkës. Krejt ngjashëm me pemët gllabëruese, të cilët kanë aftësi, që, duke zgjeruar trungun: të përfshihjnë pemën, që u rri ngjitur, deri sa ato bëhen njësh. Pra, të gjithë për një dhe një sa për të gjithë. Megallomania shfaqej si delir madhështie, pikërisht të kësaj peme gllabëruese, që shpallet monument kulture dhe ruhet nga shteti. Cvajku thotë: “Nuk ka gjë më të rrezikshme nga megallomania e njerëzve të vegjël”. Njeriu i vogël në këtë rast e kishte emrin Zylo, por zylot do të akuzojnë si të tillë: Demkën, në mos vetë shkrimtarin. Mitomani alternohesh shpesh me të qënin paranojak. Sëmundjet vinin nga lart, e shëndetshmja ngjitej nga poshtë. Ngaqë zbritja ishte më e shpejtë nga ngjitja u ndodhëm në një regjim të kalbur. Zylo përherë shfaqet më i rëndësishëm nga posti, që ushtron. Autorit nuk i lejohej të ngjitej lart, personazhi i tij duhej të ishte i një rangu të vogël, por nga mënyra se si ai ekspozohet, del mbi nivelin e një zyrtari të rëndomtë. I përshtatshëm në një shoqëri e mësuar të luante me veten. “Shoku Zylo e kishte dëndësuar duhanin dhe kjo i kishte shqetësuar shumë disa nga mirëdashësit e tij. Veçanërisht Taqi ishte shumë i alarmuar. Ai thoshte se duhej bërë çmos, që shoku Zylo ta rrallonte duhanin dhe, më në fund, ta linte se po dëmtonte shëndetin.” A s’ ishte Enver Hoxha që deklaronte se shokët e partisë i ishin lutur që ai të linte duhanin dhe ai, i qe bindur merakut të tyre? (Në fakt, ata që i kërkonin të linte duhanin ishin disa kooperativist nga zona e Dumres e njohur për kultivimin e duhanit. Lënia e duhanit përkoi me kohën, kur filloi tregëtia e paketave të cigares me mafien Italiane.) Shoku Zylo mediton: “Mendimet, arsyetimet, meditimet fluturojnë mbi tërfilin që thahet në diell dhe mbushen me erën e tij. Gjithë lëngu, që ikën nga kërcelli, vjen dhe hyn në shpirt dhe mban vesh nga zërat misterioz, që vijnë nga bari, lulet, fletët...” Shikoni si shkruan shoku Enver në kujtimet e tij: “Mbyll nga njëherë sitë dhe, kridhem në ato kohëra të largëta, më suket sikur jam afër me aromën e barit, me erën që fërshtëllen në qiparisa, me zhurmën e bletës që bredh nër cfakat luleverdhja.” A nuk është i njëjti monolog, ku personazhi dhe figura historike shkrihen në një të vetëm? Ja dhe një afrim me të sotmen: “Më duhet të vë sistem në punët e kulturës.”-i thotë Zylo Demkës, gjë që sot e dëgjojmë në variantin: e rëndësishme është të ngremë sistemin, të futet në sistem. “Aristofani me të qeshura çarmatoste perënditë”-thotë një nga personazhet e



romanit. Nëse “të qeshurat çarmatosëse” i drejtohen Zylos, ai duhet të plotësojë kushtin i të qenit perëndi. Po për shqiptarët ky ishte Enver Hoxha. Kush ka të qartë teorin e projektimit të vetes, që lideri lë tek mvartësit, ndjeksit, pasuesit, ithtarët, të cilët krijojnë zinxhirin komandues, si një nevojë për shumimin e vetes me shtimin e kopjeve në seri, kupton pse oborrtarët udhëheqin procesin e njehësimit të radhëve. Që sundimtari të bindet në projektimin e vetes, nuk mjafton vënia e një distiktiv tek jaka e xhaketës, por tek shëmbëllimi i pasardhësit. “Kopja kërkon të vrasë orgjinalin.”-shkruan gjermani Gustav Bucher në dramën e tij “Vrasja e Dantonit. Se si kopja vret orgjinalin paralajmërohet në romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyló” të Dritero Agollit. “Ai e rrëzon lisin duke e fërkuar.”-thuhet këndej nga Myzeqeja. Kryeministri Shehu duhet ta ketë nuhatur këtë komplot pasiv të shkrimtarit dhe urdhëroi ndalimin e botimit të romanit në revistën humoristike të kohës “Hosteni”. Shtrohet pyetja: pse orgjinali nuk e eliminoi komplotin pasiv të kopjes së tij? Enver Hoxha, ngaqë i shkruante vetë fjalimet, sinopset, nuk kishte më prodhimtar nga ai me vepra, që dilnin në seri, për të bërë dallimin me të tjerët, që e mbanin një Demkë nga pas, jo vetëm që bënte dallim me ta, por i kënaqej kopjes, si një projektim i vetes. “Ti, Demkë, mendon se unë jam njeri i thatë me kokë të mbushur vetëm me ide dhe agjitacion?”-i drejtohet eprori mvartësit të tij. Idetë ishin të Hoxhës, ndërsa agjitacioni i Alisë. Zyló po tenton t’i shpëtojë vargonjëve ideologjik nga pozita e viktimës, ku hipokriti kërkon të nxjerr përfitime nga një kohë, që të mësonte si të gënjeje. Demka ishte më i lirë nga eprori i tij dhe kjo shkaktonte zili. “Dhe para meje,-rrëfen Demka.-për një çast doli një njeri tjetër, një njeri me ndjenja lirike, që nuk e kishte njohur më parë.” Kjo anë e panjohur e Zylos, mbetet si e vetmja mundësi, që ai t’i largohet kallëpit ku qe futur, t’i kthehej jetës normale. Njëherësh kjo është dhe thirrja e shkrimtarit për të shpëtuar nga skllavëria e të qenit kopje. Zylos i njihej veçse shkëlqimi teksa shihte rënien e të tjerëve. “Përpiqu të shkëlqesh sa më pak.”-ishte këshilla, që i jepej kujtdo, që merrte një detyre të re, një post. Zyló nuk largohej me vullnet të lirë, ishin të tjerë ata që i qarkullonin, apo i vidhnin. Shkrimtari merr përsipër ta rrëzojë vetë, duke na kujtuar tërmetin artificial të De Radës. Gjithsesi në sytë e orgjinalit rrëzimi i kopjes nuk ngjallë ligështim, ngaqë e ka siguruar përjetësinë me projektimin e vetes, edhe pse dëshuan mos autori po i binte pragut të dëgjonte dera. Kësisoj rrëzimi deux ex machina i Zylos nuk është i plotë, nëse nuk i vjen radha Demkës të ngjitet.

Demka vjen tek e sotmja me imazhin e *spin doctor* të njohur si strateg të fushatave elektorale, i cili merret me kurimin e imazhit të fitimtarëve të radhës, ardhur nga bota e nëndheshme. Njihen kompanit lobuese në rehabilitimin e imazhit. Me fjalë të tjera, dje mbanin gjallë Zylon, sot e rehabilitojnë atë në sytë e publikut. (Ruzvelt mbahet mend si presidenti, që rrethohej me poetë, shkrimtarë, skenaristë, regjisorë, ku tre prej tyre u besonte tekstet e fjalimeve, duke bërë punë e Demkës. Teodor Sorensen është i njohur gjatë presidencës së Kenedit, si hartues i fjalimeve të tij, i cili e lavdëron Kenedin për intuitë momentale duke e ndryshuar tekstin e përgatitur prej “Demkës” me efikasitet të lartë. (Thënia e famëshme e Kenedit: “Mos pyet se ç’ka bërë atdheu për ty, por çfarë bën ti për atdheun tënd”, është një shprehje e adaptuar nga një shkollë private, me sugjerimin e Demkës, *spin doctorit*, ku thuhej “Mos pyet se ç’ka bërë shkolla për ty, por çfarë bën ti për shkollën tënde.”) Një shekspirolog mbahej në stafin e Klintonit vetëm për të futur në fjalimet e tij ndonjë thënie të përshtatshme nga Shekspiri.

Meqë e nisëm me shkëmbin e rrëzuar të Kavajës, po u kujtoj vargun e njohur të Driteroit: “Unë Devoll, një shkëmb i yti i pagdhendur”. Në kohën kur gjithkush latohej, rrumbullakosej, ku guri i rrumbullaktë preferohej për të zënë qoshen, shkrimtari nuk ha të gdhendur? Nga të gjitha zanatet ai që mori publicitet më shumë ishte ai i gurgdhendësit, ku skulptorët kaluan në plan të dytë. Ndaj Demka shprehet i pikëlluar: “Unë nuk isha mësuar të kundërshtojë mendimet e eprorëve të mi.” “Askush nuk e ka luksin sot, të shfaq mendime personale.”, thotë Ayn Rand tek “Revolta e Atlasit”. “Veshi: organ që dëgjon në radhë të parë përgjegjës.”-ishte një nga maksimat e shokut Zyló. Edhe Driteroi ka një libër poetik me titullin “Fjala gdhend gurin”, sikurse një roman të titulluar “Dështaku”. Pagdhendja e tij, qysh në krye të herës, nuk është gjë tjetër veçse inkonformizmi i tij, që s’kemi pse e ngatërrojmë me latimin e Demkës apo matufepsejen e Zylos. “Mund t’ia lija këto libra Aranitit, por ai nuk e zotëron këtë gjuhë. Araniti i mallkon librat. Ka libra të cilëve nuk u besoj.”-shprehet Zyló në çastin e rënies, të dorëzimit të detyrës. Kush është ky që i mallkoka librat? Cilët janë këto libra, që nuk u besoka më? Pikërisht persekutorët e artistëve, që i burgosnin, internonin, u hiqnin të drejtën e botimit dhe ato libra që morën më qafë Don Kishotin. Nuk është e vërtetë ajo që thotë kritika se “Zyloja dhe komisari Memo janë dy prej personazheve që e kanë vënë autorin në provën e skemës.” Komisari Memo është një trupëzim idesh, sikurse është kritikuar me kurajo në kohën e zylove, të cilët e donin të standartizuar me frazizma, sikurse këshillonte dhe kryeministri i kohës, që heroi pozitiv duhet të jetë pa të meta, kur vetë do dilte një katran me bojë. Zyló nuk vuan nga iluzionet, përkundrazi e ushtron iluzionin në dobi të pushtetit të tij, për t’u dukur i kohës, i suksesshëm. Për të shpjeguar shkëlqimin e Zylos, të kohës që mburrej me ndërtimin e hidrocentraleve, do na mjaftonte vargu i Eposit të Kreshnikëve: “Fort po ndrit aj diell dhe pak po nxeh.” Rendën pas ndriçimit, madhësisë së rreme, duke u munguar ngrohtësia. Ata pretenduan se po krijonin epokë dhe mbetën pa kohë.

Një perspektivë ndryshe mbi poezinë e Lleshanakut

LOJA/AMBIGUITETI ME VDEKJEN – SI ËSHTË DASHURIA?

nga Ballsor Hoxha

Poezia e Luljeta Lleshanakut është gjuhë e cila shkëputë shenja, gjymtyrë, situata, e kohë, për të ndërtuar metafora poetike narrative, universe në vete, që është në të vërtetë hapje dhe përballje me ankthin e të qenit, gjegjësisht me vdekjen. Me vdekjen e kudondodhshme dhe me vdekjen në çdo moment dhe në çdo gjest e fragment të jetës nën diktaturën e Shqipërisë.

Aq më shumë ajo bartet, dhe përumbet, dhe herë të tjera nxjerrë krye në aktualen, sikur Kujdes ndaj të mbeturit të përhershëm nën këtë izolim me vdekjen nën lëkurë, dhe herë të tjera si në përcjelljen e instruksioneve në aeroplan (poezia “*Mama, unë dhe instruksionet*”).

Në ankth të të qenit ndanë vdekjes për tërë rininë e saj, në jetën e saj nën diktaturë, Lleshanaku ndërton në fragmente metaforike që ndërthurin universe të tëra në një poezi, hapjen, vendosmërinë dhe përballjen pikërisht me ankthin/vdekjen (sipas Heidegger). Ajo në të vërtetë rikthen, një jetë të zënë myk vdekjeje, mbetur në “qoshen negative”, me një fjalë paluar dhe të kaluar në të Pa – vërejtshme si qeniesim dhe si harrim ndaj vdekjes në jetën e “*ngopjes*”, pasi që është “*ngopur e keqja*”.

Dhe në zbërthimin e këtyre universeve të një jete të pamundshme, lind loja me vdekjen, ambiguiteti (Blanchot). Kur vdekja është në ty, në fjalën tënde të parë dhe të fundit, kur vdekja është e paarritshme, kur vdekja është vdekje e përhershme, kur vdekja është ‘pamundësi e mundësisë’ (Maurice Blanchot) si në jetën e përditshme të Shqipërisë së Diktaturës, mundësia e njeriut deri në vdekje, potenciali i mundshëm deri në vdekje, ‘mundësia e pamundësisë’ (Heidegger) me gjithë seriozitetin e të pranuarit të fenomenit të vdekjes përballë, poezia e Luljeta Lleshanakut është lojë, ambiguitet, respektivisht marrëdhënie me vdekjen.

Ringjallja e të humburve të diktaturës

Derisa negativja është jeta e njeriut në kah me vdekjen, dhe ajo është marrëdhënie e cila e premtan jetën (e mbetur), është potencial para dhe përballë saj. Por në ambiguitetin e gjuhës së njeriut, të vetë qeniesimit të njeriut, vdekja është edhe përbrenda jetës. Në të vërtetë, ambiguiteti është i vetmi shpëtim prej prezencës së saj. Në këtë ambiguitet ngritët edhe jeta e këtij qeniesimi, kësaj qenieje të diktaturës si në poezinë “*Realitete vertikale*”, ku gjyshi dhe babai zgjohen nga të vdekurit dhe:

... Ata nuk po orvaten të ndryshojnë ndonjë gjë/ as të kundërvihen; ndihen të freskët/ ashtu të larë në sapunin e lirë të përkohësisë.../ ...Thjeshtë e riprekin botën përmes meje/ si me një palë doreza plastike/ për të ruajtur të pastër shkaku/ në vendin e krimi.

Po kjo lojë e cila zbulon/hapë njeriun përballë vdekjes gjendet në poezinë “*E ëmbla shtëpi*” derisa “*të vdekurit i pëshpëritin shtëpisë diçka në vesh*”.

Në përzgjedhjen e poezive të Luljeta Lleshanakut botuar nga Onufri, qysh në fillim ndërtohet neutraliteti, vdekja e vdekjes (Blanchot) përmes, loja me vdekjen, derisa njeriu është ujë, ujë dhe karbon. NË të vërtetë vdekja e përvjedhur nën lëkurën e qeniesimit nën diktaturë, bëhet e jetueshme në jetën si ujë, në vdekjen si ujë, në pavetësinë e ujit, në panevojshmërinë e ujit, në riciklimin e ujit, në vetë ujin ku nuk ekziston faji.

NË poezinë “*Ujë dhe karbon*” përnjëherë zbulohet, njeriu – përbërja e tij, “*vetëm ujë dhe karbon*”. Më tutje tërë kjo poezi kulminante, herë përmbytet në pavetësinë e ujit dhe herë të tjera ngre kokën dhe del në sipërfaqe, si një kohë, sa temporale po aq edhe e “*matshme*” në njeriun, e cila duke i “*dalë përpara fatit e herë në shpinë, atje ku s’e pret*”. Tërë historia e njeriut në Shqipërinë e paemëruar është ndanë njeriut ujë dhe karbon.

Njeriu turret drejt territorit “*asgjë nuk është e jotja*”. Pastaj vjen kthesa “*tradhtia e trupit*”, lind faji, dëshmia, faji i të qenit dëshmitarë, i mbijetuar. Dinjiteti vetëvritet. Lind edhe pendimi, për përkuljen, për fajin, për dëshminë. Vuajtja bëhet gjymtyrë e trupit “*t’ia presësh thonjtë me kujdes*”. Njeriu humb dhe karbonin. “*Pse duruat?*” pyesin, rifillon edhe jeta. Ngopet edhe e keqja një herë derisa diktaturat nxjerrin squfur prej stomakut të prishur. Faji më nuk ekziston. Uji është i riciklueshëm. Ti edhe pse nuk e kupton dashurua lind, *dhe qelbesh djegësirë, tym, si një i pastrehë*.

Ujë dhe karbon. Të matshëm/ të matin peshën që kur lind.../ Vjen koha e riciklimit/ uji është i riciklueshëm/ natyra është amvisë e mire, nuk lë gjë t’i shkojë dëm.

Në këtë ambiguitet/lojë të njeriut me vdekjen, njeriu, dhe atë bashkë me gjuhën si negative, shuan gjënë të cilën e emëron, nga e cila emërohet, vetë – njeriu -, dhe e krijon idealin e saj, por edhe ideali, në ambiguitetin e vdekjes, shumëfishohet në pafundësi e deri në zhvleftësim.

Pikërisht për shkak të kësaj poeti e vdes fjalën, kështu që për ta hedhur si të parën herë, për ta nisur si për herë të parë, për të emëruar gjërat, për të lindur jetën të cilën e rrëfen (Blanchot). Poetja Lleshanaku e shpërbën, e tretë njeriun në ujë dhe karbon, e vdes, në ujë, e neutralizon, për ta pas rilindur, jo si njeri i sakrificave, vuajtjeve, e dramave, por si njeri i cili harroi të gjitha, kaloi të gjitha, dhe arriti si ujë përballë ujit. Si njeri që arriti një dënim të dytë, një ekzekutim të dytë, paradoksalisht.

Vijon në faqen 8



(Vijon nga faqja 7)

“je i lirë... “ku do të shkosh?”/... “A e di se çfarë ke humbur?!”/ Një dënim i dytë, një ekzekutim i dytë./ Si mund t’ia fshehësh ujin ujit?!

Në këtë neutralizim, njeriu është dhe shihet përsëri, përsëri siç është, nëpër të gjitha katrahurat, duke mos e ditur as dashurinë, *të qelburit si djegësirë, tym*, duke e pasur për të vetmen dëshmi të saj.

Poezia e Lleshanakut, e kthen njeriun, për ta rilindur nëpër mosjetën, dhe nëpër pamundësinë e mundësisë së jetës, për ta bartur aty ku ishte, për ta bërë të besueshëm dhe të kapshëm këtë qeniesim.

Është paradoks mjeshtëror, njeriu i ringjallur nëpër traumën e tij, përballë katrahurave të pafundme të qeniesimit të tij, dhe me këtë shpërbërjen e vdekjes përbrenda tij, të folurit e saj përmes njeriut.

Në të vërtetë , si në poezinë *“Ujë dhe karbon”*, uji vetë, dhe po ashtu edhe karboni janë sinonime për vdekjen, si në imediaten e tyre dhe po ashtu edhe në simbolikën e tyre. Neutralizimi i vdekjes në paveti dhe në asnjësi.

GJUHA

Viti 1968 në poezinë e Luljetës (Poezia *“Hapësira negative”*)

...Disa burra me uniformë/ në mes të natës bastisën kishën./ Vendasit e panë priftin e tyre/ me benevrekë të dridhej prej ftohtit në oborr/ dhe pyetën me sy njëri tjetrin të zhgënjyer:/ “ky është ai që na falte mëkatet?”...

Ambiguiteti i njeriut, marrëdhënia e njeriut me vdekjen, me realen e saj, edhe para katrahurës së diktaturës shqiptare, është i ndërmjetësuar, ka qenë i ndërmjetësuar me religjionin. Ka qenë e ditur publike, të folurit e vdekjes përmes tij, përmes shenjave dhe referencave të tij. Por, për një moment, në poezinë e Lleshanakut ai, prifti *“me benevrekë dridhej prej të ftohtit në oborr”*. Zhvishet tërë pavërejtshmëria e vdekjes (Heidegger) dhe krijohet momenti i ekzistenciales, kthimi në primordialen, në ekzistencën e pakusht përballë lakuriqësisë së *“hapësirës negative”*.

“vazhdo atje ku e la shoku”/ Një fjali e gjatë na lidhte pas njëri – tjetrit/ pa konotacion, si brenda një idiole./ Dikujt i takonte emri, dikujt folja, dikujt përemri.../ Kurse mua një pikëçuditje në fund të rreshtit/ Veç një grimasë, rastësi e keqe.

Njeriu është negative që ecën, e cila shkon kah vdekja, apo edhe nuk vdes kurrë duke mos mundur asnjëherë të perceptoj vdekjen e tij, sepse ai vdes para këtij fenomeni, gjë që do të thotë është pamundësi e mundësisë.

Por edhe gjuha është hapësirë negative e cila shuan çdo gjë dhe e rikthen në ideal. Aq më shumë që në ambiguitetin e letërsisë ideali arrin në pafundësi idealesh të cilat kurrë nuk arrijnë të dalin përtej ambiguitetit të tyre. Në të vërtetë poeti ka infinitin, por e humb fundësinë (Blanchot), gjë që do të thotë mund të lirojë të gjithë të burgosurit e botës, dhe edhe të krijoj një efekt me letërsinë dhe në letërsinë e kësaj ngjarjeje, por jo edhe të realizojë këtë ngjarje në fiziken e saj.

Në këtë negative është e mbetur, e fshehur dhe e gjetur Poetja Lleshanaku në poezinë e saj. Përballë ankthit/vdekjes, përballë të të folurit përmes vdekjes, apo të folurit me vdekjen përbrenda.

Bukuri e rrallë që mbetet në pikëçuditjen e gjuhës, në vetë vdekjen, në vetë fundin, fatkeqësinë. Në gjuhën e ekzistencializimit ky është projektion si të Kuptuarit (infantil) të vdekjes në rajonin e jetës dhe qeniesimit. Është metaforë e shumëfishtë e cila përfundon në vetë negativen e gjuhës e cila i jep vetes fund në pikëçuditjen e saj. Së pari nxënësit janë të lidhur me “didaktiken” që të lexojnë një fjali, gjë që gjuha i bashkon në një qeniesim, në një të qenur së bashku. Qoftë si komunizëm e qoftë si diktaturë komunizmi. Më tutje derisa secilit i takon një gjymtyrë, rastësia e gjuhës si tirani dhe si rastësi e lojës dhe shtyrjes së vdekjes krijon Pa-vërejtshmërinë e saj. Dhe pas shumë dimensioneve të mundshme të leximit të kësaj poezie, arrijmë tek vetëdijesimi infantil për vdekjen, por si? Përmes po të njëjtës gjuhë e cila e flet e atë si “rastësi e keqe”, që në gjithë zhargonin e post-komunizmit mund të jetë çdo gjë përpos rastësisë, asgjë tjetër përpos vdekjes.

Kjo është lojë mjeshtërore e Lleshanakut me vdekjen, në të vërtetë, këtu hapet ajo që quhet ambiguitet i njeriut me vdekjen dhe në marrëdhënie me vdekjen.

Kur errej kërkoja jashtë dritares një gjuhë tjetër/ me sy ngulur në yjësi./ Kur zbulimi im mund të ishte/ udhëtim në të shkuarën/ një galaktikë tashmë e vdekur, inekzistente/ një lajm të cilit iu desh miliona vjet për të mbërritur tek unë.

E shkuara e parë si asgjë, si ajo që lind vdekjen në prezencën e të tashmes, si ajo që thyen të ardhmen në temporale, janë shenjat e ankthit të ekzistencës i cili në të qenit të hedhur në mëshirën e ankthit të vdekjes njeriun e shtynë drejt një gjuhe tjetër, drejt një jete, një qeniesimi pa vdekje. Në paradoksin e kësaj strofe tejet të bukur, derisa zbulimi mund të jetë një e shkuar, e megjithatë i duhen miliona vjet për të mbërritur tek poetja, në tërë atë që na mëson astronomia si fakt për yjet, është projektimi i të Kuptuarit (ekzistencialist) si ankth, si pamundësi, derisa mundësia është zbulimi, e zbulimi është kërkimi i një gjuhe tjetër, një të pamundshme, një njeriu tjetër, një Publikeje (Kierkegaard) tjetër, të tjetrës, e cila nuk e mbanë vdekjen përbrenda.

...“lexo”.../ me gishtin e saj arbitrar mbi një fjalë, të cilën e ndajnë/ miliona vite dritë nga objekti./ (S’ka rëndësi se cili



ishte i pari).

Kjo është vetë poetja e cila mediton mbi ambiguitetin e negatives së gjuhës, vetë “arbitrariteti” duke vënë theksin në vdekjen e objektit/gjuhës, në kalimin e objektit në ide, miliona vite drite larg nga objekti.

Kjo përfshihet brenda meje gjithashtu/ në fshikëza tinëzare ajri, hapësira negative/ ku unë mund të gjej pak prehje historike/ por edhe nga ku mundet që të të vijë shembja.

FAJI

Njeriu rikthehet, njeriu ri-jeton, ri- përtypë historinë e tij dhe atë që i ka mbetur në tërë atë që kishte mbetur.

Por nëse jemi vetëm ujë dhe karbon/ Atëherë çfarë është dashuria?.../ ... sepse qelbesh djegësirë, tym, si një i pastrehë...

Por vjen edhe faza e lirisë, faza e hapjes së njeriut, dhe me këtë edhe të Kuptuarit, të pranuarit, të të qenit.

Mirëpo në këtë të Kuptuar kthehet faji ekzistencial,

primordial, i cili në vërtetësinë e tij, në pakalueshmërinë, në pashkatërrueshmërinë e tij ai *“nuk ekziston”*

Në lirinë e jetës së jetuar ndanë vdekjes, në prezencën e vdekjes së përhershme lind faji. Faji primordial ekzistencial, i pashkatërrueshëm dhe as i kalueshëm.

Asgjë nuk është e jotja. Turru dhe pushtoje.

Shtytja e ankthit (nga vdekja, prezenca e saj) është e pafundme, është e pandalshme. Por ç’të bëhet me dëshmitarin, pasi që janë parë prifti duke grumbulluar bishta të cigareve për një tym, e profesori i Sorbonës me një të fshirë duke e kullufitur një lëvore bostani. Zhdukjen e civilizimit.

Natyrisht, është gjithmonë faji i dëshmitarit...

... Faji nuk ekziston ironizon poetja, jemi të gjithë ujë dhe karbon, por në të vërtetë, faji është pikërisht kthimi i njeriut në vdekjen e tij, në masakrën e tij. Në heshtjen e tij. Gjë të cilën Lleshanaku e ringritë nga të vdekurit dhe e ngjallë përmes univeseve të saj, të kësaj jete në metafora tejet të bukura dhe shumëfish të dimesionuara.

VDEKJA

...Atëherë e dija pse as vdekja nuk na përfillte më. Na afrohej si qen/ na merrte erë dhe na linte rehat

Në ambiguitetin e metaforës së poezisë së Lleshanakut vdekja/ankthi i ekzistencës është pikërisht narrativizimi. Me ambiguitetin projektohet projektioni i vdekjes brenda ankthit të vdekjes dhe vdekjes përbrenda. Në të vërtetë neutralizohet njeriu, nga afërsia e vdekjes, nga realja e vdekjes, nga (pa) vdekshmëria e vdekjes (Blanchot). Vdekja është vdekje e përhershme dhe përhershëmëri e jetës, jeta është vdekje e përhershme. Brenda këtij nihilizmi lind poezia e Lleshanakut, jo si ankth, por si reale e cila është e projektuar si të Kuptuar (Heidegger).

Luljeta Lleshanaku flet për jetën e humbur të diktaturës, si vdekje e gjallë, si *“qoshe negative”*, si njeri, apo njeriun e shkrirë, të vluar, në tretje si ujë dhe karbon.

Poezia e Lleshanakut është udhëtim nëpër të gjitha katrahurat e njeriut, i cili nuk është asgjë tjetër përpos *i matshëm, si uji, si karboni* etj.

“Ishte aq afër. Ishte në ne. Ishte brenda nesh. Ishte para dhe pas, dhe në çdo gjë që bënim”. Thonë të ringjallurit e diktaturës së kaluarës së Lleshanakut. Ngadhnjim?

Ngadhnjimi, Resoluteness (Heidegger) përballë temporales së jetës, përballë vdekjes, në të vërtetë janë lojë në jetën e njeriut të mbetur të gjallë të Lleshanakut. Këta njerëz janë të vdekur të gjallë, të pamundur në të mundshmen. E jetës? Vdekjes? Janë ashtu siç ndërtohet shtëpia e re. E në shtëpinë e re, në të vërtetë, në tërë jetën tënde mbetesh në të vetmen shtëpi:

Ja ku është shtëpia së cilës i mora tetëmbëdhjetë vjet/ (Të tjerave veç u dhashë.)... /kur nuk ke fare shpresë, je i lirë t’ia vësh gishtin cilit avion të duash.../ por po të bëje me gisht qytetin më të afërt/ do t’ishte një premtim...

Apo në poezinë *“Në ikje”*, më poshtë, *Të gjithë po ikim prej diçkaje. Pa u ndalur asnjë sekondë/ duke kërkuar me sy ishull, si zogjtë në mes oqeanit.../... ai djalosh me uniformë shërbimi/ ka emrin dhe stampën e hotelit në gjoks.../ ...Tani të gjithë sytë prehen lirshëm përmbi të/ si mbi statujat lakuriqe në mes të parkut (Poezia “Në ikje”)*

Njeriu është në ikje, dhe *“emri dhe stampa e hotelit”* si emërim, si shtyllë, si strehë, si ndalje, apo edhe si mundësi hapjeje/përballjeje me ekzistencën, kalojnë për një çast, në *“statujë lakuriqe”* si projektim i të tashmes në të kaluarën, si Pa-vërejtshmëri e ankthit të ekzistencës, të mungesës së spirancës. Të asgjësë, në të vërtetë, që e quajmë jetë, të asgjësë, të mbetur si premtim (Derrida) në emrin dhe stampën që e shndërrojnë njeriun në premtim strehe, në premtim kuptimi, në premtim ndaljeje. Të ikjes.

Në ekzistencën tonë Dashuria është vetëm temë e ekzistencës, Publike, dhe e shenjë e të *“pastrehut”*, e në këtë qenieisim të zhveshur nga vdekja dhe prania e saj. Care (kujdesi) primordial (Heidegger) është tepër i largët, tepër i mundur nga sundimi i ankthit. Krejt çka mbetet është ambiguiteti i lojës me të.

Kuptomë.../ Njësoj si ti/ unë mendoj se ajo është një send pa histori/ si molla që ti e kafshon vetëm një herë/ dhe flak pa u ndier fajtoare. (Poezia “Mirëkuptim”).

Fluturimi i dytë

tregim nga

ZIJA ÇELA

Kur u hap fjala se babë e bir, Ikari dhe Dedali, do të fluturonin mbi qiellin e qytetit të tyre, shumë athinas morën rrugën drejt kodrës së Akropolit. Pikërisht atje do të ishte baza e nisjes. Fakti që fluturuesit kishin dështuar në Kretë herën e parë, e rriste më tepër turmën dhe emocionet. Si banor i Tokës dhe gjallesë këmbësore, ndryshe nga shpendët, dukej se njeriut i qe mohuar Qielli përgjithmonë.

Sidoqftë besimi tek Ikari, miku besnik i Platonit dhe nxënësi i hershëm i Sokratit, nuk mungonte. Në qytet ende kujtohej si ishte shprehur njëherë Sokrati rebel: “Do të vijë koha kur Ikari ka për të ditur vetëm një gjë, atë që s’di asgjë. Por atëherë ai do të jetë bërë krijues i Të Vërtetave.” Kështu që sfidën dhe shpirtin e lirë, me gjasë, i kishte të rrënjosura qysh në rini.

Por sa dhe si do të përballej me rrezikun Dedali, djali që tashmë ishte në moshën e dikurshme të babait? Dhe, sidomos, do të ndikonte tek ai përvoja e hidhur e provës së shkuar? Kureshtarët më të mëdhenj, siç pritej, ishin ata që e kishin përfunduar gjimnazin me Dedalin, por edhe ata që ende venin në gjimnaz. Kurse vetë i ati, sado bluante përbrenda, nga jashtë nuk jepte shenja mëdyshjes.

Veçse në çastet që po lidhnin krahët pas trupit, Ikarit i zuri syri një grup djemsh që flisnin të nxehur, duke bërë gjeste me këmbë e me duar. Për çfarë kishte hyrë grindja ndërmjet tyre? Përderisa me ta ishte edhe Kritobuli, kushëriri dhe bashkëmoshatar i të birit, ndoshta më vonë do ta mësonte përse ishin përçarë. Ndërsa, aty për aty, Ikari mendoi se djemtë po vinin baste. Ndoshta gjithë kundërshtitë me njëri-tjetrin i kishin për strukturën e krahëve dhe teknikat e lëvizjes në ajër. Por tashmë ai nuk kishte kohë t’u jepte sqarime të tilla. Bashkë me të birin ishin në vijën e nisjes dhe do t’u duhej të merrnin vull për fluturimin.

Kur u shkëputën nga trualli, në fillim ndjenë një boshllëk në stomak. Por duke vënë në punë muskujt e fortë të shpatullave, e fituan shpejt ekuilibrin në pozicionin horizontal. Sa qartë po u zbulohej qyteti tani me atë vargun e kodrave, që i vinin rreth e qark. Veçse për pamjen asnjëra s’i afrohej kodrës së Akropolit, ku ishte ndërtuar Partenoni, vepër e skulptorëve Itkini e Kalikrati, të cilët ishin dënuar më pas për abuzime me fondet. Fluturuesit guximtarë i ranë rrotull Tempullit të Virgjëreshës, duke soditur grupet e statujave mbi fronotonet. Atje spikaste figura e Perëndeshës Atena, emrin e së cilës mbante qyteti, një skulpturë e punuar në ar e fildish nga Fidias i famshëm. Ndërsa njerëzit i ndiqnin nga poshtë, duke treguar me gisht herë njërin e herë tjetrin, atë e bir dukej sikur komunikonin atje sipër, sepse largësia që i ndante mbetej thauja e pandryshueshme. Natyrisht, nuk kishin radio, por kishin disiplinë dhe intuitë për rrymat e ajrit. E këto i vinin në shërbim të itinerarit, që kishin caktuar paraprakisht për fluturimin.

Mirëpo kur Ikari u nis drejt Mureve të Gjata, që dikur e kishin bërë Athinën të barabartë ushtarakisht me Spartën, Dedali pati një shmangie. Duke shtuar ritmin e krahëve, mori përpjetë qiellit, çka e detyroi të atin të kthehej me një merak në zemër, sepse pikërisht lartësia u kishte sjellë aksidentin në sprovën e Kretës. Ai fluturim kishte qenë një shpikje nga nevoja. Mbreti Minos i pati izoluar atëherë në labirintin, që ishte ngritur për përbindëshin Minotaur. Në ato rrethana ngujimi, Ikari thuri krahë prej puplash dhe fluturoi me djalin për t’u arratisur. Por ky u ngrit aq lart, sa pastaj ra në det.

Dy ishin versionet që qarkullonin për shkakun. Disa thoshin se, meqë ngjitja e puplave ishte bërë me dyllë, brumi i tij kishte shkrirë nga dielli dhe flatrat ishin shprishur. Por Poseidoni, perëndia e detit, mendonte ndryshe. Sipas tij nuk kishte qenë ndonjë pakënaqësi e Heliosit, por e Zeusit: “Ti, mor dykëmbësh mjeran, ti ke paturpësinë të rrekesh për t’u ngritur në lartësinë e fronit tim?” Dhe në qiell të thatë, nga zemërimi për shpërfilljen, i goditi flatrat e djalit me një degë rrufeje. Mirëpo në atë kohë Poseidoni kishte pasur konflikt me vëllain e tij, Zeusin fuqiplotë, që sundonte si satrap mbi majën e

Olimpit. Prandaj në mbretërinë e vet i doli kundër, duke ua shpëtuar jetën dy fluturuesve, njëri prej të cilëve kishte rënë në det dhe tjetri ishte ulur ndanë tij.

Sapo u bashkua me të birin dhe ia vëzhgoi krahët, Ikari u qetësua. E gjeti tekta fluturonte nën një re të bardhë, që kushedi ku e kishte zbrazur shiun dhe tani lëshonte vetëm hije. Atij iu kujtua vetvetiu trimi Leonidha që, në krye të treqind spartanëve të tij, kishte ndalur mijëra persë në Grykën e Termopileve. Dhe kur pushtuesit e kërcënuan se do t’i lëshonin sipër stuhitë e shigjetave, ai u përgjigj: “E po më mirë ahë, do të luftojmë në hije!” Pastaj, duke fluturuar drejt detit për t’i shfaqur nderim Poseidonit, atë e bir kujtuan burra të tjerë legjendarë. Muret e Gjata u sollën ndër mend mençurinë e Themistokliut, që kishte ngulmuar për fortifikimin e qytetit-shtet, ndërsa ikja nga labirinti u kujtoi lavdinë e Tezeut, heroit të Atikës, që vrau përbindëshin Minotaur.

Në kthim ata fluturuan përsëri thauja paralel. Sa shumë do të kënaqej Platoni, sikur të ndodhej në Athinë, duke i parë së bashku atje lart! Por Ikari ia kishte kursyer mikut emocionet e rrezikut. Ndaj kohën për fluturim e zgjodhi kur mungonte filozofi, mësuesi i madh i të birit, i cili kishte vajtur në Sirakuzë. Por edhe pa këtë akt guximi, çfarë kishte dashur të thoshte për dishepullin e tij, Platoni e kishte thënë tashmë. Një ditë, tekta dilte nga Akademia që vetë e kishte themeluar, disa të rinj e kishin provokuar me fjalë cytëse për Dedalin. “Mos harroni, djem gazmorë”, u kishte thënë filozofi, “përparimi arrihet shkallë-shkallë. Dedalit nuk i mungojnë Virtutet dhe këto mund ta çojnë te Njohja.” Të dilte nga goja e Platonit kjo lavdëratë për një bashkëmoshatarin e tyre, sidomos binomi Virtyt dhe Njohje, ishte diçka e pazakontë. Prandaj pati mes të rinjve nga ata që u galduan, nga ata që vetëm u gëlltitën, si dhe nga ata që njëkohësisht u gëlltitën dhe u zverdhën në fytyrë.

Ndërsa i afroreshin bazës, prej ku qenë nisur dhe turma po gjallërohej, papritur Ikarit iu ringjall dyshimi brejtës. Atij iu duk se nga njëri krah i Dedalit, dhe pikërisht nga pjesa e brendshme, kullonte një bulë lëngu si të ishte pikë shiu. Po përjetonte një fanepsje apo ndonjë paralajmërim të kobshëm? Mos po fluturonin shkëndija nga Qerrja e Diellit, duke u përhapur deri aty? Ku kishte gabuar në konstruktim?

Ai u ngjit më lart dhe, kur i bëri atij krahu një kontroll nga sipër, asgjë të gabuar nuk vërejti. Për t’i mbrojtur rrënjët e puplave, përveç dyltit, kësaj here kishte përdorur rrëshirë, ngjitës nga zhardhokë bimorë, fije shtrënguese liri, si dhe ca balestra të lehta prej kallami kundër nxehtësisë. Por as Qerrja nuk tregonte ndonjë trazim tani, përkundrazi, Heliosi sikur u buzëqeshte me dashamirësi. E kjo do të thoshte se perëndia e Diellit po mbante anën e tyre, duke ia lënë në dorë Zeusit vendimin për fatin e mëtejshëm.

Mirëpo babë e bir e kishin paramenduar edhe blatinin për Zeusin. Për nder të tij, ata do ta mbyllnin fluturimin duke i rënë tri herë kryq e tërthor asaj hapësire të Partenonit, që binte në drejtim të Olimpit, malit të shenjtë. Aso kohe të tilla ishin marrëdhëniet me zotat, secili prej tyre kërkonte përkushtim të plotë nga njerëzit e zakonshëm, por pa i dhënë askujt siguri si do të silleshin ndaj tij.

Kur arritën mbi kodër dhe po merrnin kthesën e parë nga e djathta, bashkë me përvijimet e relievit u bënë më

të dukshëm edhe qytetarët. Për t’u shprehur ngazëllimin dhe mirënjohjen e tyre, disa kishin nisur të brohorisin. Më të papërmbajturit kishin flakur pelerinat dhe kërcenin pupthi, si të donin t’i arrinin. Ikari ia doli të dallonte entuziashtët. Madje pikasi edhe grupin e djemve që, për nga gjestet kundërthënëse, dukeshin gjithnjë të përçarë. Atij i erdhi keq që ishte nisur pa ua plotësuar dëshirën, pra, pa u folur për strukturën e krahëve dhe teknikën e fluturimit. Por mendimet iu ndërpre në befasisht dhe të gjitha shqisat i përqendroi te vëzhgimi i Dedalit. Jo, tani nuk mund të flitej më për dyshime. As për fanepsje, të cilat zgjasin një çast dhe pastaj vjen kthjellimi. Tani kishte bindjen se nga flatrat e të birit kullonin sumbulla të lëngshme, që dendësoheshin vazhdimisht.

Çfarë po ndodhte, ku qëndronte e keqja?! Ç’mund të ishte ky kërcënim po aq idhnak, sa rrufeja e Zeusit dhe krateri i Heliosit?! Sado pyeste veten, Ikari s’po arrinte të përgjigjej. Tashmë i dukej se vetë bota ishte kthyer përmbys, sepse në vend që rrezatimi të vinte nga lart-poshtë, po vinte nga poshtë-lart. Atij i bëhej se herë-herë vizëllonin në ajër ca rreze që, duke ardhur nga toka, i godisnin flatrat e të birit drejt e në faqet e brendshme. Ishin të holla, të shpejta, të verdha e të kuqe njëherësh, përvëluese si flaka në mish.

“Ç’furrë i lëshon?”, pyeti veten përsëri, “ku është burimi i tyre?”

Mirëpo as Ikari ngadhënjyes, krijuesi i së Vërtetës se njeriu mund të fluturojë, nuk po e zbulonte dot burimin e fshehtë. Turma ndoshta ende s’e kishte nuhatur rrezikun, ndërsa djemtë as që i hidhnin më atij ndonjë vështrim. Sytë e tyre ishin ngulitur vetëm te Dedali.

Duke dashur t’ia ndërpriste fluturimin, Ikari i thirri të birit që të zbriste me urgjencë. Pastaj, ngaqë rrymat e ajrit e pengonin dëgjimin, ia përsëriti thirrjen dhe bëri t’i afrohej, për ta mbrojtur nga poshtë me trupin e tij... Por çasti fatal kishte mbërritur. Flatrat e dobësuar u shkërmoqën dhe honi i boshllëkut e përpiu Dedalin.

Sa të tmerrshme e të pafundme iu dukën ato çaste të atit. E kishte të pamundur ta shkurtonte kohën e uljes, duke i mbledhur krahët ngjashëm me skifterin, që bie pingulthi si të jetë gur. Për të humbur lartësi, atij iu deshën rrotullimet spirale të lejkut, siç i quante vetë. Megjithatë, kur preku tokën, flatrat që e kishin mbajtur lart, e penguan të ecte. Atëherë, për ta ndihmuar, iu afruan disa djem që ose e kishin kryer, ose ndiqnin ende gjimnazin. Mes tyre njohu bashkëmoshtarë e shokë të të birit, por iu drejtua kushëririt që vrapoi me të parët:

“Kritobul, përse po vinit baste ju?”

“Sepse kishte ziliqarë që ishin kundër Dedalit. Vunë baste për të mësuar se deri ku mund të arrijë fuqia e smirës.”

“Kjo fuqi e zezë mund të arrijë deri atje, sa të vrasë edhe njerëz!”, ia ktheu i dërmuar Ikari.

Nuk priti t’ia jepnin lajmin të tjerët. Tashmë ishte i bindur se i biri kishte ndërruar jetë. Dhe askush s’mund ta ndryshonte të vërtetën, hovja e dytë e Dedalit aty ishte ndërprerë përgjithmonë.

Ndërsa Ikari thonë se vazhdon të fluturojë edhe sot e kësaj dite. Jo vetëm me avionët e udhëtarëve, ku ndodhem unë, por edhe me anijet kozmike. Veçse zemërgjerët shtojnë se fluturon bashkë me kujtimin e të birit.

(Në linjën Tiranë - Verona, 2014)



LLAMBO RUCI

Homeri dhe Himara: Hyrje në botën dhe rrugëtimet homerike

Kur isha fëmijë shkolle në Dhërmi të Himarës dhe belbëzoja vargje, kur bëja bé me betimet pagane himarjote për diellin, zjarrin, vatrën mes shtëpisë, kur strukesha i ngjethur nga rrufetë dhe bubullimat e pafundme dimrit përballë në Akrokeraunet shtrëngatore (“*Shkëmbinjtë akrokeraunas/ shpesh të famshëm për shkatërrimin e anijeve*”, si thoshte Horaci), ku Zeusi “ndëshkonte” mosmikpritësit dhe besëshkelësit, nuk mund të dija se, sipas legjendës, në këto brigje kishte shkelur në lashtësi Odisea i famshëm i **Omirit** (Homerit), stërgjyshit të poezisë europiane.

Më vonë, kur lexova dhe kuptova botën homerike, te mjegulla e përhershme në qafën dhe kthesat e Llogarasë, si tis i mbetur i shpërthimeve të dikurshme vullkanike, që ngjallet dhe përhumbet shpejt shkrepave të Çikës, gjeja nyjën që lidhte këto brigje të rrufeve me përfytyrimin poetik të Homerit tek “Odisea” (XI, 14-9) për kimerët (Κίμυριοι, *it.* Cimmerii) dhe peizazhin e tyre:

“Atje ishte vendi dhe qyteti i kimerëve, që i mbulonin re dhe një errësirë e trashë. Kurrë me rrezet e tij nuk i ka parë dielli, as kur në qiellin me dritë yjesh lind, as kur prapa drejt tokës kthehet nga qiejt, veç vdekatarët e mjerë i mbulon një natë kobzeze”.

Pikërisht këtu në vendin e himarjotëve, shkruan Spiro Rusha, përgjatë bregdetit jomikpritisë keraunian, Pukëvilit i doli “... përballë Himara (Chimara), që i përkiste Chimera antike, emër i cili tashmë mbahej nga distrikti i himarjotëve të tmerrshëm... Akrokeraunet, ose më saktë malet Keraune janë emërtuar kështu që në lashtësi, nga termi grek *keraunos*, që do të thotë bubullimë, për arsye të lartësisë dhe veçanërisht për shkak të ekspozimit të tyre ndaj detit, të ndriçuar shpesh me dritën e vetëtimitave. ... Keraune (Ceraunia) është vendi i cili, sipas disa studiuesve, përmendet nga Circea në udhëzimet e saj drejtuar Ulikisit... Nëse Homerit do të kishte zgjedhur malet e Himarës për skenën e veprimeve infernale, që zhvilloheshin mes mjegullës së dëmshme, me të cilën ato mbuloheshin asaj dite, gjërat duhet të kishin marrë rrjedhë krejt tjetër gjatë periudhës tri mijëvjeçare...”. Përballë “Fanos, *Othonos* i antikitetit, që mendohet të jetë rezidenca e Kalipsos, i njohur në Odisenë e Homerit dhe Telemakut të Fenelonit”...

Ja dhe përfytyrimi i Homerit për Himarën-Kimerë (*Iliada*, VI, v. 179-182):

... Kimera e frikshme...
pjellë njerëzore nuk ishte ajo, por soj hyjnor,
dragua nga prapa, luan përpara, në mes dhi.
Ishin të brendshmet zjarr dhe flakë fryma e saj.

Gavril Dara i Riu tek e famshmja “Kënga e sprapsme e Balës” e përshkruan mrekullisht stihinë-Himarë antiturke:

Kështu me vehte mendoja, 55
Kur një krismë me përmendi...
- Do jetë era në ato të dushqe
A lugati endacak?
Por këtu s’qaset... as ujku,
Që i nginjur diku struket, 60
As dhe dreri frikakak,
Që këcen i shqetësuar...
Këtu n’t’errët mos jan’ futur
Pararojet e armiqvet,
Që ditën gjithnjë kan’ frikë? 65
Jo, jo kurr’, për ushtëni time
N’t’errët Arbri s’do të bjerë,
Se dhe copëtuar e shtypur
Me drit’ botën do e mbulojë!
Ashtu si kulshedrat natën¹ 70
Kthyer stihis’ së Himarës,

1 v. 70-82. Kupto: Përbindëshi (stihia) i Himarës (sipas autorit, një mal vullkanik në Shqipërinë Jugore) u qëndron i vendosur kulshedravet, që i vërviten duke i hedhur përsipër shi e breshër e gjëmë. Qëndrimi i vendosur i stihisë së Himarës kundër kulshedrave këtu krahasohet me qëndrimin e vendosur të Shqipërisë kundër armiqve turq. v. 77. I vjen metë = i vjen mangët, i pakësohet.

I vërtiten duke i shtënë
Shi me breshër e me gjëmë;
E ajo ngrihet e i qëllon
Me shkrepimë e bubullimë; 75
E kur k’putur e plagosur
I vjen met’ fryma e fuqia,
Me syt’ keq të zgurdulluar,
E pëlçet me këmbë malin,
E derdh zjarrin, porsi lumë 80
Dhe e ndezur plot shkëndija
E përpirë bie në ferr.

Kjo mbrytje poetike me ndjesinë homerike të heronjve dhe fenomeneve, që shkrepnin tej në Akrokeraune, më shtynë fillimisht të merresha me *Odisenë* dhe më pas me *Iliadën*. Një ndërmarrje e vështirë që kërkonte vullnet, njohuri dhe përqasje me përvoja të tjera, që citohen në literaturën e botimit. Dhe e nisa kështu për dy arsye: se *Odisea* është një endje poetike nëpër pellgun mesdhetar me etjen e aventurës dhe zbulimit të botëve të reja, të panjohura të Perëndimit, ku u vërtitën heronjtë e lavdishëm të Trojës, pasi hyjnitë i mbuluan me lavdi e plaçkë, i ndëshkuan lloj-lloj për dobësitë e tyre njerëzore. Dhe legjendat e djepit mesdhetar këta heronj, por edhe fenomene të tjera para dhe pas Trojës, i përplaste nëpër Akrokeraune si përplasnin dallgët një barkë në furtunë dhe mbetjet a të shpëtuarit dëshmojnë për tragjedinë.

Në botimin *Himara në stuhitë e shekujve* nga Spiro Rusha, ceken të dhëna të vyera të lidhjes së krahinës me mitologjinë dhe legjendat e lashta të Mesdheut. Kështu ai përmend se Apollodori thotë se “/Odhiseu/ pasi bëri fli për nder të Hades, Persefonës dhe Theirezisë, duke kaluar më këmbë nëpër Epir, arriti te thesprotët dhe sipas orakullit të Theirezisë zbuti zemërimin e Poseidonit me flijime”.

Sipas Homerit Odisea u nis nga ishulli Ajaja ku banonte hyjnesha Circe dhe sipas porosive të saj lundruan që nga perëndimi drejt lindjes dhe arritën “aty ku është krahina dhe qyteti i burrave himarjotë” (“Odisea” botuar në Lipsia, 1860, f. 166); populli aty shton më poshtë, jeton pa i parë rrezet e diellit për shkak të reve të mjegullës, që e mbulon tërë krahinën. Homerit nuk e shpjegon shkakun e këtyre reve dhe mjegullës së vazhdueshme në qiellin e Himarës, por F.C.H. Pukëvili, i cili e ka vizituar tërë malësinë e Akrokeraunëve, kur kryente

funksionet e konsullit të Francës në Janinë pranë Ali Pashë Tepelenës, na thotë se janë rezultat të vullkaneve të shumta. Fenomenet e tyre (vjellën e tymit të mjegullës dhe të llavës) ishin zhdukur sepse vullkanet kishin pushuar së vepruari, por Pukëvili e mbështet tezën e tij në ekzistencën e gjurmëve të tyre, të cilat ai i ka parë vetë gjatë vizitave që ka bërë në këtë krahinë (“Voyage dans la Grece”, f. 250-251).

Sipas Pukëvilit, Homerit ka dashur të përcaktojë Akrokeraunët kur hyjnesha Circe me selinë e saj në ishullin Ajaja, duke e udhëzuar për rrugën detare që duhej të ndiqte, i tregoi plazhin e zbarkimit, ku do të gjente hyrjen e Tartarit (Aornin), të cilin duhej ta vizitonte për të pyetur hijen e falltarit Tiresia, për t’i thënë nëse do të mund të arrinte në ishullin e Itakës apo jo. Atëherë kjo grykë e Tartarit (Aorn), nuk do të jetë ajo që Straboni e vendos në buzën e lumit Akeront të Thesprotisë, por ajo që gjendej në Akrokeraunët. “Kur Plini tregon një qytet të Kimerasve të quajtur edhe në ditët e sotme Himarë, emër që do të jetë ruajtur qysh nga një antikitet shumë i largët. Pra, prioriteti i Aornit, probablisht i përket Akrokeraunëve, ku princi i poetëve e bën të shkarkojë heroin e saj që u nis nga ishulli i Circes, para se të drejtohet për te mbreti paqësor i Feakëve” (Pukëvili, “Voyage dans la Grece”, f. 250). Prioriteti i Aornit të Akrokeraunëve mbështetet edhe nga dijetari i shquar athinas, Apollodori, i cili shkruan në veprën e tij “Biblioteca”, se Odisea pasi bëri fli për nder të Hadit, Persefonës dhe Theirezisë, duke kaluar më këmbë nëpër Epir, arriti te Thesprotët dhe sipas orakullit të Theirezisë, zbuti zemërimin e Poseidonit me flijime (sipas “Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë”, f. 76). Nga citati i mësipërm del se në Thesproti ka shkuar pasi bëri fljimet, që do të thotë se ato i bëri jo në Thesproti, ku vendosi hyrjen e Tartarit (Aornin) Straboni, por në një tjetër vend përpara se të shkonte në Thesproti. Dhe kuptohet se ky vend ka qenë në Akrokeraunet, në Palestë, afër tempullit të Furie, hyjneshave të mallkimit e të gjakmarrjes: “Hie furit et/ saepe palestinas jurat adess deus” (Ovid. Factorum 4, sipas Pukëvilit në “Voyage dans la Grece” f. 250).

... Kthimi i grekëve për në atdhe pas rënies së Trojës dhe dyndja e fiseve të dorëve në Peloponez, në Kretë dhe në ishujt e tjerë të Egjeut, janë dy ngjarjet, që krijuan një gjendje trazirash e përlëshjesh të armatosura midis popujve të ndryshëm të Mesdheut Lindor. Një pjesë e forcave luftarake greke humbën drejtimin gjatë lundrimit, njësoj si Odisea, për shkak të stuhive, të cilat i shtynë drejt territoreve të huaja dhe i detyruan të ngulen në vendbanime të reja. Gjatë kësaj periudhe një grup pellazgësh (ose pulasta) të Palestinës, pas disfatës që pësuan nga izraelitët e Davidit, për t’i shpëtuar zgjedhës së pushtimit, zbarkuan në malet Akrokeraune, në plazhin e Palasës së sotme.


Ndjenjat e autonomisë së banorëve të Himarës u manifestuan në mënyrë të qartë edhe gjatë luftës civile midis Jul Qezarit dhe Pompeut, i cili ishte vendosur me forcat e tij në Iliri dhe në Epir, ndërsa me flotën e tij ishte bërë zotërues i detit Adriatik dhe detit Jon, por në krahinën e Himarës nuk kishte vënë dot këmbë. Edhe Jul Qezari nuk e bën zbarkimin me forcat e tij në Palestë të Himarës me anë të dhunës, por u mor vesh me drejtuesit e krahinës. (A. Baldacci, “Studi speciali albanesi”, vol. III, p. 225.)

Pa marrëveshjen me vendasit nuk vlente aspak gjenia e Qezarit, midis një kaosi malesh shkëmbore, që puqeshin me brigjet e detit të pabesë, si ato që shtrihen që nga Kepi i Gjuhëzës deri në Onhesm (Sarandë), e që karakterizon Himarën në shikimin e saj të llahtarshëm, sidomos në vjeshtë dhe në dimër. (A. Baldacci, vep. cit. f. 228.)

Kur Homerit flet për arritjen e Odisesë në Himarë, përmend arritjen e tij “në kufijtë e oqeanit, aty ku ndodhet krahina dhe qyteti i burrave kimeras”. Që këtej del se emri i Himarës si krahinë është parësor në krahasim me qytetin, i cili si krijesë më e vonshme nga vetë krahina ka marrë edhe emrin e saj. Mbas çështjes së emrit Himarë, si emër parësor i krahinës, i cili është bërë edhe emër i qytetit si qendër e të gjitha fiseve të himarjotëve, lind pyetja e etimologjisë së emrit Himarë (ose Kimerë).

Në “Dokumente për Historinë e Shqipërisë” - pjesa e dytë, 1499-1506, Himara përmendet me emrat: Zimara, f. 196; Zimarjoti, f. 281 dhe në veprën e Nilo Borgia-s “I monaci brasiliani in Albania...”, botim i vitit 1935, f. 162 emërtohet Chimara. Si shihet në këto emërtime, figuron togfjalëshi “mar”. Ndërkaq, sipas Max Myler-it, emri i perëndisë helene ARIS dhe i asaj latine MARS e kanë origjinën nga sanskritishtja MARU, perëndia e stuhive, ajo që shkatërron, që shpartallon. Në qoftë se e pranojmë këtë shpjegim etimologjik, atëherë mund të arrijmë në përfundimin se edhe etimologjia e emrit të Himarës e ka burimin në emrin sanskritisht të perëndisë së stuhive, të shkatërtimeve që janë pasojë e luftërave. Këtë përfundim e mbështesim në atë se në emrat e Himarës që kemi përmendur më sipër, është pjesë përbërëse rrënja e fjalës sanskritisht “mar”. Edhe rrënja e emrit “Hi”, e Himarës është sipas Stuart Manit, e trashëguar nga indoeuropanishtja, njësoj si fjalët: hënë,

Homer ILIADA



Në shqip nga
LLAMBRO RUCI

BOTIMET TOENA

hije, hyj dhe hy etj. (S. Man, “Shqipja si gjuhë indoeuropiane” - Konferenca e parë e studimeve albanologjike, f. 135). Pra emri Himarë është identik me emrin e perëndisë pagane të luftës, ARIS në greqishten dhe MARS në latinishten. Për këtë shpjegim na vjen në ndihmë dhe fakti se emri i ditës së dytë të javës që në mbarë shqipen është e martë, në të folurën e fshatit Qeparo edhe të fshatrave të tjera të Himarës, deri në vitet ’40 të shekullit XX ka qenë e marë dhe nga shumë të moshuarit edhe sot vazhdon të thuhet e marë. Nga pikëpamja e lashtësisë Antonio Baldacci e çon përpara epokës homerike. Ai këmbëngul se emrat e njëjtë të Himarës dhe të Panormit të Akrokeronëve me ata të Sicilisë nuk janë rastësi, por u përket arkeologëve për të zgjidhur problemin nëse Himara ngjitet deri në epokën kreto-mikenase. (A. Baldacci, vep. cit. f. 234.)

Gjeto Kola ndër të tjera shkruan: “PALERMO - asht fjalë helenike qi d. m. th. shqip “Portë e vjetër”. Emni i vërtetë i ktij asht Kastri pse përmendet nëpër gojëdhana e kangë popullore të Shqiptarëve t’Italis, e të Greqis’ e prej popullit të Himarës. Ky qytet pat kenë në za në kohë të vjetra si Himara, Onesmi, Oriko etj. të cillët u rrafshuen prej Luc Pal Emilit, pris i ushtrinavet romake vjetin 163 mbas Krishtit, i cilli zaptoj kto vende e kshtu u shqym qytetnimi e perparimi i pellazgve. Në ket rasë prishi ma se 70 qytete e mori ma se 300.000 vajza e djelm rob, e i dergoj n’ Itali per të shtuem mënderen e frigen neper vise t’ona. Banorët e Kastris u shperndan do në Greqi, Qerfoz (Korfuz), e tjerët morën malet e Shqipnis. Mbas pak kohet u rivendosen...

Ali Pasha Tepelena, si thame ma parë, ngrehi kështjellin në rrenime të Qytetit Kastrija.

Historija thotë edhe qi kur u ndez Troja mbasi hiku Enea me barkë, erdh e u ndal në ket lima(n). Pozita asht e shqelqyeshme; porti ka formen e nji patkonit kali.

Ktu qindruen himarjotët ne kohë të Turqis, por si i mujt i fut dhe rrenoj themelisht qytetin Kastri; luftarët i burgosi, e banorët i dboj malevet të cillët sajuen Qeparon, Borshin, Kuçin, Pilurin, Vuno, etj. Flota tregtare e luftare gjen në ket lima nji mprojtje të sigurët ndër dallga të mdha”.

Është e habitshme, por edhe në ballë të kalasë që Ali Pashë Tepelena ndërtoi në Panormo (Palermo) të Himarës për Vasiliqinë, sipas legjendës, në pllakën e mermertë të gdhendur në greqisht, ishte shkruar Himni i Aliut. Pavarësisht nga autori i kësaj poezie epigramatike, Vilaras apo Psalidhas, kuptimi është jashtëzakonisht domethënës. Autori i saj, një intelektual grek i përmasave të Zosimeas, lartëson figurën e pashait nga miti në histori, nga Faethonti, biri i Diellit te Shqiponja e Epirit, Pirroja, nga Athinaja, bijë e pamposhtur e Zeusit dhe hyjneshë e diturisë, tek Aresi hyu i luftës. Aliu, kjo figurë legjendare në sytë e popullit dhe të muzës së poetëve të Janinës, ndërlihdet bukur me kalanë e pathyer...

Ktheni ploret pa frikë, o detarë të huaj
në detin mes Panormos mërinë e erës shuaj,
dhe këtë që tani shihni në ballin tim si yll
është trofe fitoreje, kala që shkreptin,
më ngritën me zell nuse himarjote,
armike ndaj armiqve dhe ndaj miqve shoqe.
Më njohu Faetonti, më kishte Pirroja nakar,
më mban heroi Tepelenas Aliu i Parë.
Në vendet e Epirit i plotfuqishëm Zot
dhe me shpatë në dorë gjeneral i pashoq,
nën urdhër ushtarë ka pesëdhjetë mijë
pa gjumë dhe pa frikë kundër armikut të tij.
Në Janinë prehet luani i trimëruar,
pjellë e Athinasë, nga Aresi mëkuar.
Më 5 shkurt 1814

Proverbiale dhe homerike është lidhja e himarjotit me vendlindjen, me atdheun, pikërisht ai *nostos*-i i famshëm (*kthimi*) i Odisesë, udhësit të paepur nëpër botën e lashtë të Mesdheut. Ja ç’thotë Pukëvili (*Udhëtim në Greqi*, Paris, 1820): “Këto vende për ditë kanë për himarjotët joshje të reja. Duan buçimën e ujëvarave, që bien mes maleve të tyre. Gëzohen duke dëgjuar gjëmimin e detit, që shpërthen në anëdetet e tyre. Me ngazëllim ndjekin fërshëllimën e erërave dhe të gjithë e dashurojnë dhe e bekojnë vendin e egër, që u qëlloi me gjithë varfërinë e tij. Kështu banori i këtyre maleve është më tepër patriot nga niseti, adhuron me fanatizëm vendin, që e lindi. Qoftë në mërgon, qoftë në pëson fatkeqësi apo lumturon, nuk humb kurrë trajtën e ëmbël të krahinës së tij. Një instinkt i veçantë ia kujton kurdoherë. Dhe kurdoherë kujtimet e rinisë, e detyrojnë të kthehet pas në strehën e prindërve të vet”.

Marin Barleti, te vepra e tij monumentale “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut”, shkruan se Topiajt “... ishin të njohur si princër edhe për sundimin e Himerës së Ulksit. Ky është një vend malor kundrejt Korkyrës, ku banon një popull i pamposhtur dhe trim, që të mos them luftarak, të cilin ne e quajmë zakonisht himarjotë. Ata janë të siguruar vetëm me mbrojtjen natyrore të vendit, aty s’ka bërë gjë dora



Llabro Ruci në Delf, tek Apolloni, 1987.

apo mjeshtëria e njeriut. Ata i kanë përbuzur gjithmonë me sukses turqit e harbuar pas nënshtrimit të Epirit me vdekjen e Skënderbeut dhe kanë jetuar gjer në këtë kohë pa e njohur sundimin e huaj, me njëfarë lirie të pashoqe të natyrës”.


Ndërsa Joan Kamilli, një misionar i Propagandës Fide të Romës, “nga Drimadesi (Dhërmiu), më 13 qershor 1668”, në një letër shkruan për vendasit: “Naturisht janë fisnikë (sojllinj), duanë luftënë dhe, më tepër se me nga çdo gjë tjetër, zbavitënë me armë, e janë armiq, pothua, me gjithë botënë. Jan’ armiqë me Latinët, jan’ armiqë me Tyrqitë, janë dhe armiqë nërmiet tyre, kaqë sa një fshat vritetë me tjatin, si të Krishterëtë që goditenë me Tyrqit fqinjë. Dhe s’ka anë tjetërë për t’i qetuarë veçse një shum’ e madhe të hollash a krahu i Perëndisë.

... Njerëzitë janë shumë fisnikë dhe fort të zotëritë për çdo punë. Në mos fare, janë mjaft të mirë; dhe sa për tani janë në barbari e në pagdhendësi të madhe se s’ kanë as të parë, as qeveri, as no njëfarë diturie dhe janë në varfëri të thellë. Në vetija janë më të tepërët pa dhelpëri, të besësë, dhe vetijat e pështira janë të paka nër ta, dhe imzot më ka thënë shumë herë që, në mes të një qint vetave q’u nxjerr fajetë (kur rrëfihen), mezi gjen dy a tre që të kenë bërë faj vdekjeje; nga ky shkak më tepërë pëlqen një shpirt të këtyre njerëzve, se një qint të nonjë kombi tjetërë” (Revista “Kalendari Kombiar” e Lumo Skëndos, f. 46-52, Sofje, 1901).

Ndërsa Bajroni në poemën e mirënjohur të Çajld Haroldit (*Kënga e dytë*), me penelata të ndezura portretizon malet e Himarës dhe himarjotët:

Të ngrysur çohen lart përpara syve,
Si amfiteatër vullkanik natyre,
Së majti djathtas, alpet e Himarës...
Të bijt’ e Himarës që s’falin as mikun,
Si mundet ta lënë të gjallë armikun?
Si s’markan dot gjak me pushkët besnike,
Ka shenj’ më të bukur se zemra armike?

Në “Gazetën Shqiptare” (*Milosao*), 13 dhjetor 2015, në shkrimin “Në Himarë bashkëjetoi greqishtja e shqipja... por ka gjurmë toponimesh edhe arabe etj.!” studiuesi i njohur Dhori Q. Qirjazi, ndër të tjera sjell një fakt interesant: “Rreth 2500 vjet më parë, në një mbishkrim, që i drejtohej Orakullit të famshëm të Dodonës, thuhej:



(Lidhur me vendosjen e banorëve të Himarës, [ata shtrajnë pyetjen] nëse duhet (apo munden) të vendosen këtu.)

Nga teksti i mbishkrimit nuk kuptojmë se ç’vend kanë zgjedhur këta himarjotë të stërlashtë për t’u ngulitur, as edhe arsytet pse kanë vendosur të shkojnë gjatë. Për nevojat e punimit tonë, ka rëndësi fakti se ata shkojnë diku tjetër, rrahin udhët e detit a të sterësë, pra ngrënë ura të motmoçme, dhe se mbishkrimi është shkruar në dialektin dorik të greqishtes së vjetër”.

Ky tis homerik i Himarës dhe jehona e largët e fëmijërisë buzë Akrokerauneve me ndeshjet e hyjnive dhe përbindëshat e shkreptimave, ishin shtysë për të risjellë në shqip me një tingëllim dhe gurgullimë jonike në shqipen e sotme *Iliadën* e pavdekshme të Homerit...

Duke punuar me Iliadën, u përvijua një mënyrë përkthimi, që i afrohet origjinalit në vargje, emërtime dhe konstruktin figurativ të poemës, apo i fjalëpërfjalshëm brenda mundësisë së leximit, në mënyrë që të ruhet aroma e origjinalit, si dhe të përputhet fjalësi i emrave të përkthimit me atë homerik.

Ky përkthim ka disa risi.

Ndërsa te botimi shqip i mëhershëm (para gjysmëshekulli), numri i vargjeve nuk i korrespondon origjinalit (p.sh.: Kënga I, Homeri: 611, përkthimi i mëparshëm shqip: 770; Kënga XV, Homeri 745: përkthimi i mëparshëm shqip: 925 etj.), te përkthimi im vargjet përputhen me origjinalin homerik, duke bërë të mundur edhe krahasimin e tij me botime të përkthimit në gjuhët e mëdha të botës.

Në përkthimin e mësipërm është përdorur vargu i lirë, duke ruajtur trajtën dhe ekuivalentin, me sa është e mundur, të leksikut të origjinalit, pa i shtuar apo hequr fjalë dhe shprehje homerike, dhe kësisoj të shijohet në një mënyrë tjetër bota e famshme e antikitetit me heronjtë, ritet fetare, zakonet, fushëbetejat dhe dyluftimet mes heronjve etj., si dhe bota e perëndive të Olimp, që ndërlihdet me veprimet dhe bëmat e njerëzve në tokë. Në të kam ndjekur shembullin e përkthimeve moderne, që synojnë qasjen besnike ndaj veprës së Homerit (në dallim nga punimet e kohëve të shkuara), duke përdorur si model përkthimet e Iliadës të viteve të fundit nga Kostas Dukas, Rosa Calzecchi Onesti dhe nga Giovane Cerri (shih literaturën).

Përkthimi shoqërohet nga një shtojcë, e cila bën të mundur që poema të kuptohet nga një rreth i gjerë lexuesish, jo vetëm nga studiuesit e letërsisë antike greke dhe romake: Nga disa studime shoqëruese personalitetesh të shquara të fushës; nga një aparat i hollësishëm me një numër shumë të madh prej rreth 1900 shënimesh, ku ka interpretime vargshesh, vendesh, por edhe të instituteve të drejtësisë, hakmarrjes, mikpritjes, dyluftimit etj., një botë homerike e interpretuar që nga komentuesit e lashtë gjer te studiuesit e sotëm, një enciklopedi e vërtetë; nga “Fjalori i emrave”, në tri gjuhë: shqip, greqisht, italisht, me referencat e këngëve dhe vargjeve përkatëse.

Pra, është një përkthim me varg të lirë, i shoqëruar nga një aparat shpjegues, *për herë të parë në shqip*, si një instrument për të lehtësuar leximin dhe për të kuptuar më mirë epokën, traditën, heronjtë, fenë e grekëve të lashtë, për lexuesin e thjeshtë dhe studiuesin e letërsisë së antikitetit.²

Fund nëntori, 2015

2 Literatura:

- Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, Tiranë 2002;
- Marin Barleti, Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut, Tiranë 1967;
- Pukëvil, Në oborrin e Vezirit të Janinës, Tiranë, 1999;
- Gjeto Kola, Himara, (“Hylli i Dritës”, 1939 (Nr. 3-7, 8-10, 11-12)-1940 (1-2);
- Kostas Haxhiantoni, Himara kështjella e pathyer..., Athinë, shkurt 2002;
- Gavril Dara (i Riu), Kënga e sprapsme e Balës. Kthyer në gjuhë të sotme dhe përgatitur nga Sh. Demiraj, Drejtoria e botimeve shkollore, Tiranë, 1965, f. 51.

Iliada

HOMER

Përkthyer nga Llambo Ruci

Fragment nga kënga e parë

Botimet Toena, 2019

Libri i parë,

Murtaja dhe mëria

Këndo, hyjneshë,¹ mërinë e Akil Pelidit, rrënimtaren,² që brenga pa fund u shkaktoi akejve

dhe në Had rrokullisi shumë shpirtra burrërorë heronjsh, ata i bëri pre të qenve³ dhe gjithë orlave,⁴ vullneti i Zeusit po kryhej,⁵ qysh në fillim kur u grindën dhe u ndanë, Atridi, prijës i burrave dhe Akil hyjnori.⁶ Dhe nga hyjnitë kush ndezi armiqësinë mes tyre? Biri i Zeusit dhe i Letosë,⁷ i zemëruar me mbretin, dhe një murtajë të keqe⁸ solli në ushtri e korrte popujt 10 se nuk nderoi Krisin, priftin,⁹ Atridi, që erdhi në anijet e shpejta¹⁰ të akejve

1 Ndarja e *Iliadës* dhe e *Odisesë* në njëzet e katër libra apo këngë, që është bërë duke përdorur gerrat e alfabetit jonik, për të shënuar secilin prej tyre, është vepër e gramatikanëve aleksandrinas. Titujt e vënë në krye për çdo libër, tregojnë se si për shumë shekuj janë emëruar pjesë të ndryshme të poemës. Ato janë pajisur nga shënimet, si dhe nga Eustazio-ja, por duhet të kenë zënë fill nga praktika e recitimeve rapsodike, ngaqë dëshmhohen qysh në epokën klasike (*“Bëma e Diomedit”, Herodoti, a, 116 etj.*). *Vargu I. Si* në tekste të tjera arkaike, *Iliada* hapet me një hyrje ku thirret hyjnesha frymëzuese e këngës dhe rrëfeket, shkurt, tema e kompozimit. *Hyjneshë*: është Muza, që i dikton poetit ato që duhet të thotë. Le të ndërmendim dhe vargun e parë të *Odisesë*. Sipas konceptit të kohës, vepra e aedit frymëzohet nga hyu dhe kjo thirrje ishte lutja e një besniku, i cili e di se sa i vështirë, por edhe sa i rëndësishëm, është funksioni i saj. Madje gjersa ishte Muza, që fliste me gojën e poetit, aedi mund të përshkruante dhe skena, që luheshin në Olimp, se të mos harrojmë, që sa thoshte, ishin për atë vetë dhe për dëgjuesin, të vërteta, pa shkaktuar habi se nga i mësoi. Muzat gjetkë emërohen në shumë (*Iliada* II, 484 etj.). Bija të Zeusit dhe të Mnenosinës (“Memoria”, *Kujtesa*), Muzat janë hyjnesha të muzikës, të këngës dhe të valles. Janë ato që mbikëqyrin veprimtarinë poetike, duke i dhënë apo duke i mohuar aedit aftësinë për të endur fillin e një kënge të caktuar. Ky solidaritet i ngushtë mes bijave të kujtesës dhe fjalës poetike, është i rikthyeshëm te karakteristikat e vetë këngës epike, thelbësisht gojore (e improvizuar në fazën më antike, pastaj në një fazë pasardhëse, recituar përmendësh), që kërkonte një mësim të gjatë të kujtesës, një mnemoteknikë të vërtetë e të veçantë pak a shumë të ndërgjegjshme.

2 *2. Rrënimtaren*: Në origjinal mëria e Akilit karakterizohet e *mallkuar*. *Akili*: bir i Peleut dhe nip i Eakut. E mbajmë mend nga *Odisea*, sidomos nga përgjigjja që i dha Odisesë, të cilin e quajti të lumtur për nderimin që gëzonte sa jetonte, dhe për pushtetin që gëzonte në Had: Vdekja nuk ka ngushëllim! Do të preferoja të punoja i gjallë në arën e ndonjë varfanjaku, sesa të mbretëroj në Had mbi të vdekurit. Këto fjalë tregojnë se sa ishte i lidhur heroï me jetën. Dhe tek *Iliada* do të shohim të njëjtën dashuri të Akilit për jetën. Ndërkaq do ta flijonur i gatshëm për të marrë hak për vdekjen e mikut të tij më të dashur, Patroklit. Brengën për jetën Akili e ruan edhe brenda në Had.

Naim Frashëri, përkthimin e Këngës I të poemës: “Iliadhë e Omirit” (1896), botuar në Bukuresht, e fillon: “O vashë! Këndo mëninë/ E Aqileht Kordhëtarit...” Si shihet, Naimi përdor trajtën e gegërishtes: *mëninë* (mërinë), që i përngjan origjinalit homerik: mínin (Μῆνιν).

3 4-5. Jo gjithmonë pas për të varrosur të vdekurit. Mungesa e varrimit konsiderohej nga të lashtët si një fyerje e rëndë për të vdekurin dhe një pengesë për zbritjen e shpirtit të të ndjerit në Had.

4 5. *Orli*, shpend grabitqar, i madh, mishngrënës; shqiponjë a hutë.

5 5. *Vullneti i Zeusit*: Është premtimi i Zeusit bërë Tetit për të favorizuar në betejë trojanët, duke shkaktuar vdekjen e shumë akejve dhe duke “shpërblyer” kësioj Akilin për fyerjen pësuar nga Agamemnoni.

6 7. *Atridi, prijës i burrave*: Agamemnoni karakterizohet shpesh *prijës i burrave*, prijës i ushtrisë, kishte marrë komandën e fushatës, ngaqë mbretëronte në shtetin më të fuqishëm të kohës, *në Mikenën me shumë ar* (shih v. 276 etj.). Kur poeti flet për Atridin, nënkupton atë, jo të vëllanë, Menelaun.

Dhe Akil hyjnori, në origjinal *d(h)ios*, që e ka prejardhjen nga Zeusi. Ky karakterizim u jepet mbretërve, heronjve, grave të famshme, se konsideroheshin të lindur nga hyjnitë, krenoheshin se rridhnin nga Zeusi. Poeti përveç *hyjnilindur* (v. 337 e gjetkë), i quan dhe *hyjnimëkuar*, ushqyer nga hyjnitë (176 e gjetkë).

7 9. *Biri i Zeusit dhe i Letosë* është Apolloni.

8 10. *Dhe një murtajë të keqe solli*, sëmundja shfarosëse, që dërgon Apolloni, përputhet dhe me karakterizimin e hyut, Apollon Smintheas (*Smint eas*, hyu i minjve). Në Troadë e gjetkë, adhuronin Apollonin si hyun që largonte sëmundjet. Dimë se murtaja përhapet nga minjtë dhe Apollon Smintheas ishte hyu, që kishte fuqinë të shkaktonte dhe të dëbonte murtajën. Apolloni mbante epitetin harkargjendhtë, se ishte hyu i harkut dhe i shigjetës, si paraqitet edhe në artet figurative; lidhur me këtë privilegj, ishte aftësia e hyut për të qëlluar persona të veçantë apo popuj të tërë me sëmundje të vetëtimta apo me epidemi, të ndjera në imagjinatën e grekëve si efekt i shigjetave të tij hyjnore.

9 11. *Prifti*: Krisi ishte prift i Apollonit.

10 12. *E shpejta*, mbiemër i qëndrueshëm tradicional i anijeve, element stolisës i tyre. Përdoret jo vetëm në kuptimin konkret, por edhe që të mos kalojmë pa vënë re dhe t’u gëzohemi anijeve, të cilat kanë plot nëntë vjet, që rrinë tërhequr në tokë.

për të liruar të bijën, duke sjellë shpërblesë të pafund;¹¹ në dorë mbante kurorat e Apollon largshigjetarit mbështjellë në skeptrin e artë dhe luste gjithë akejtë, 15 por mbi të gjithë dy Atridët, prijësit e popujve: “Atridë dhe ju akej të tjerë këmborefortë,¹² ju dhëncin hyjnitë, që kanë shtëpitë e Olimpit, të shembni qytetin e Priamit, të arrini shëndoshë në atdhe; por lironi bijën time të adhuruar dhe shpërblesën pranoni 20 duke përnderuar të birin e Diosit,¹³ Apollon largshigjetarin”.¹⁴ Atëherë të gjithë akejtë e tjerë thirrën e thanë të respektojnë priftin, të pranohet shpërblesa e ndritshme; vetëm Agamemnonit në zemër kjo s’i pëlqeu, Atridit, dhe e dëboi me të keqe, e fjalë të rënda i tha: 25 “Plak, mos të takofsha prapë, pranë anijeve zgavroshe, a të vonohesh këtu tani, apo të kthehesh prapë dhe mos s’ të shërben skeptri dhe kurorat e hyut.¹⁵ Atë unë s’do ta liroj; më parë pleqëria do ta gjejë në Argos¹⁶ në shtëpinë time, larg atdheut, 30 të end në avlëmend dhe shoqe shtrati ta kem. Mos më zemëro, ik menjëherë, në do të mos ta pësosh”. Kështu tha dhe u tremb plaku e fjalës së tij iu bind; i heshtur shkoi nëpër rërën e detit shumëdallgësh; dhe kur u gjend larg, shumë e luti plaku 35 mbretin Apollon, që e lindi flokëbukura Leto: “Dëgjomë Harkargjend, mbrojtës i Krisës¹⁷ dhe i Killës hyjnore, zot në Tenedo,¹⁸

Smintë,¹⁹ nëse të ndërtova tempull të të gëzohet zemra,

11 14. *Në dorë mbante kurorat e Apollon largshigjetarit*: Në origjinal kemi fjalën stemata (στέμματα), ishin cepat e lirshëm të një kordeleje prej leshi, me vlerë fetare, mbështjellë në majë të skeptrit, që mbante prifti. Krisi është këtu edhe lutës edhe prift, prandaj ia vlen ta nderojnë dyfish. Ka shumë mundësi, që këto kordele të ishin në realitet të Apollonit, dmth. të stolisnin shtatoren e tij brenda në tempull, dhe Krisi t’i ketë sjellë me vete si dëshmi të lidhjes së tij me hyun. Këto fasha ishin kordele prej leshi, që shërbenin si zbukurime të shenja në ritualet e hyjnive të ndryshme: mund të ishin veshur nga prifti shërbyes, apo të ishin nga shtatorja e hyut, a të mbështillnin bisqet që mbanin në dorë pjesëmarrësit në rit. Krisi dëshiron t’u drejtojë lutjen e tij akejve duke u paraqitur në cilësinë dhe madhësitinë e priftit të Apollos: për këtë shkon në kampin armik me skeptrin të mbështjellë nga kordelet e shenja.

Apolloja është quajtur ἐκατόβολος, *shigjetar* (me epitete ekuivalente ἐκατηβόλετης te v. 75; ἐκάεργον te 147; ἐκατηβόλος 370; ἐκάτος te v. 384; ἀργυρότοκος,*harkergjend* te v. 37), se ishte hyu i harkut dhe i shigjetës, me të cilët është pasqyruar në artet figurative. Lidhur me të, privilegji i hyut ishte aftësia për të qëlluar persona të veçantë, apo popuj të tërë me sëmundje zhuritëse apo epidemi, të ndiera në imagjinatën e grekëve si efekt i shigjetave të tij hyjnore.

Kriseida dhe Briseida quhen nga Homeri vajzat nga emrat e etërve të tyre, Krisi dhe Brisi. Si thonë poetë të tjerë, emrat e vërtetë të tyre ishin Ipodamea dhe Astinomi.

Naimi v. 12-13 e përkthen: “Nd’ anijat të ahajinjet/ Kishte sjellë dhe kanisqe”. Pra, *shpërblësën e pafund* e quan *kanisqe*.

12 17. Krisi i drejtohet kuvendit (asamblesë), që merr gjithë vendimet e rëndësishme, ndan plaçkën e luftës, siç është thënë shpesh dhe mund të thirret nga cilido prej krerëve (në v. 54 nga Akili); Agamemnoni, që është një i parë mes të barabartëve (titulli i “mbretit”, që nga ana tjetër e mbajnë dhe të tjerët, nuk duhet të na gënjejë), mund të shpërdorojë pozitën e tij dhe nga epshmëria e asamblesë, për të detyruar vullnetin e tij, si këtu, apo për të kryer një padrejtësi në dëm të një prijësi tjetër, si do të bëjë pas pak. Por bëhet fjalë për shpërdorim dhe padrejtësi, si do të dëshmojë pjesa tjetër e *Iliadës*.

Këmborefortë: epitet i akejve, që përsëritet shpesh e shpesh tek *Iliada*: Kollçik, kallca, këmbore; në Epokën Klasike dhe në Mesjetë, ishte pjesë e armaturës, që mbronte pjesën e përparme të këmbës, nga gjuri gjer në fund të saj.

Naimi përkthen kësisoj: “Ahajinj, o pulpmirë”, pra akej këmborefortë.

13 21. *Dios*: Zeusi. *Kronidi*: i biri i Kronit (Kronos), Zeusi.

14 21. *Apollon largshigjetarin*: Apolloni është hyu shigjetar, i cili duke goditur nga larg qëllon shenjën. Me karakterizimin *largshigjetar*, i cili shoqëron dendur emrin e hyut, që këtu duhet të jetë ngarkuar me peshë kuptimore, poeti parapërgatit skenën e vargut 44 e në vijim, ku do të shohim *largshigjetarin* Apollon në veprim. Apolloni është mbrojtësi më i rëndësishëm i Trojës (shih V, 436; XVI, 698 etj.).

15 28. ... *mos s’ të shërben skeptri dhe kurorat e hyut*: këto fjalë janë fyerje e madhe në fetarinë e Apollonit. Ndaj dhe kundërshtia klerikale e hyut është e egër, si shihet më poshtë. Agamemnoni njëherësh tregon pavarësi mendimi dhe besim në fuqitë njerëzore.

Naimi këtë varg e përkthen: “Se pastaj s’të bëjnë punë/ As stapi yt i florinjtë./ As kuror’ e Apollonit!”.

16 30. *Në Argos*: me emrin Argos, poeti nënkupton herë shtetin e Agamemnonit në Argolidë, si këtu, herë qytetin Argos, që mban gjer tani të njëjtin emër (IV, 52), herë Greqinë Jugore, veçanërisht Peloponezin, në dallim me atë veriore (VI, 152), herë të gjithë Greqinë (IX, 246, shih I, 382, dhe gjetkë: Argej).

17 37. *Krisë*: qytet afër Trojës ku Krisi ishte prift i Apollonit. Një qytet me emrin Krisë me një tempull Apoll Smint(h)eut, gjendej në bregun perëndimor të Troadës, afër qytetit të vonët të Hamaxitos.

18 38. *Killës hyjnore*: e shenjtë, qytet i Troadës (afër Trojës). Gjeografi Strabon (13, 1, 62 etj.) theksonte se ende në ditët e tij ekzistonte një vend i quajtur kështu, në gjirin Adramyttion, ku ngrihej një tempull i Apollon Kileut. Po, sipas Strabonit, ajo nuk ishte mjaft afër detit për t’u identifikuar me Krisën homerike; duhet të ketë qenë pranë detit (shih v. 430 etj.), në fushëitirën Adramyttion, jo larg nga Killa dhe nga Teba, ngaqë Kriseida u zu robinjë në Tebë (shih v. 364-369).

Si karakterizim qytetesh nënkupton: që e mbrojnë hyjnitë. Në fund të fundit të gjitha qytetet mund të karakterizohen të shenja, sepse ia kushtojnë ndërtimin e tyre ndonjë heroï, pasardhës hyu dhe kanë një hy mbrojtës.

Tenedos: një ishull i vogël i Egjeut, në jug-perëndim të Trojës. Ruan gjer tani emrin e tij. Nga këto vargje kuptojmë se në rajonin e Trojës duhej të ekzistonte adhurimi i veçantë i Apollonit.

19 39. *Smint(h)é*: epitet i Apollonit si shkatërrues i minjve fusharakë. Këtë mbiemër (Smintheys, Sminthios) Apolloni, sipas Aristarkut, e mori nga *Smintis* - qytet trojan, ku ekzistonte një tempull i hyut; sipas Eolikut emri rrjedh nga: σμίνθος (smíntos), mi fusharak, sepse si ky ashtu dhe kafshë të tjera tokësore, ishin simbole shortarie; sipas të tjerëve (Apion, Eustatios) ka kuptimin e μιοκτόνος (mioktónos), vrasës minjsh, dmth. çliroi vendin nga ca plagë të frikshme të minjve fusharakë, që zhduknin prodhimet. *Nëse të ndërtova... nëse të dogja ... më kryej*: një shprehje tipike lutjeje: nëse ndonjëherë të kam kënaqur, ndihmomë tani.

ExLibris | E SHTUNË, 9 JANAR 2021

nëse ndonjëherë të dogja kofshë të majme²⁰ 40 demash a dhish, këtë dëshirë më kryej: Shigjetat e tua danajve t’u shpagueajnë lotët e mi”. Kështu foli duke u falur dhe e dëgjoi Feb Apolloni e zbriti nga majat e Olimpit i inatosur në zemër, me hark në supe e kukur të mbërthyer lart e poshtë. 45 Krisën atëherë shigjetat mbi supet e të inatosurit kur u nis; dhe zbriste me natën përngjarë. Qëndroi pastaj larg anijeve dhe lëshoi një shigjetë, e frikshme ishte ushtima e harkut të argjendhtë; mushkat shigjetoi në fillim dhe qentë e shpejtë, 50 pastaj mbi ta duke hedhur shigjeta të hidhura i shënonte; e paprerë zjarre të vdekurish digjeshin, dendur. Nëntë ditë hyu fluturonte shigjetat mbi ushtri; dhe të dhjetën popullin²¹ në kuvend thirri Akili, siç ia shtiu në mend hyjneshë Hera, llërëbardha,²² 55 që pikëllohej duke parë se si vdisnin danajtë. Dhe kur ata u thirrën e u mblodhën grumbull të gjithë, mes tyre u ngrit Akili këmbëshpejtë²³ dhe u tha: “Atrid, tashmë ne të sprapsur, besoj, pas do të kthehemi, nga vdekja në shpëtofshim, 60 gjersa murtaja dhe lufta bashkë i rrënojnë akejtë. Pra, le të pyesim ndonjë falltar apo një prift,²⁴ a një ëndërrshpjegonjës,²⁵ - dhe ëndrra vjen nga Zeusi, - të na thotë pse u zemërua aq shumë Feb Apolloni;²⁶ mos është hatërmбетur nga ndonjë mblatë a hekatombë,²⁷ 65 apo aromë qengjash dhe dhish të pjekura të zgjedhura dëshiron baraspeshë që mynxyrën të largojë prej nesh”. Këto foli dhe u ul; dhe mes tyre u ngrit Kalkant Testoridi,²⁸ mes falltarëve i parë, që gjithë të ardhmen njihte, të sotmen, të kaluarën 70 dhe u priu anijeve akeje gjer në Ilion me shpirtin profetik dhuruar nga Feb Apolloni. Atyre dëshirëmirë ai u foli dhe u tha: “Më grish të shpjegoj Pelid, nga Zeusi i dashur,²⁹ zemëratën e Apollonit mbretit largshigjetar; 75 unë do të flas, por ti mendohu dhe m’u beto³⁰ vërtet të më ndihësh i gatshëm me fjalë e me dorë, se më ngjan do të ndez inatin e një burri, që mbi të gjithë argejtë sundon dhe akejtë i ka nën dëgjese; se më i fortë mbreti i mëritur me një burrë më të dobët, 80

20 40. *Nëse ndonjëherë kofshë të majme të dogja*: kur bënin fli, kishin zakon të digjinin në altarin e hyut kofshët e kafshës së therur, pasi i lyenin me shtresë të dyfishtë dhjami, që të digjeshin me shejt. Përsipër vinin copa të tjera mishi nga kafsha e prerë, që të krijohej përshlypyja se po ofrohej e gjithë kafsha. Në kohën kur digjej, spërkatej me verë, libacion i hyut. Të përbrendshmet dhe copat e tjera të mishit, ndaheshin mes besnikëve. 21 54. *Populli* (λαός) në origjinal: ushtarët, luftëtarët, burrat. 22 55. *Llërëbardha*: në origjinal λευκόλενος, apo krahëbardha, epitet zbukurues, që pasqyron bukurinë e hyjneshës. Poeti e përdor dhe për gra të vdekshme, Helenën (III, 121), Andromakën (VI, 371) e gjetkë. Herën do ta shohim kurdoherë mbrojtëse të grekëve. Mitologjikisht sjellja e saj justifikohet me fyerjen, që i ka bërë Pari me gjykimin (“Gjyqin e bukurisë”) e tij (XXIV, 25 etj.).

Në luftën e Trojës, Hera, bashkë me Athinanë dhe Poseidonin, marrin pjesë në anën e grekëve dhe janë kundërshtarë të trojanëve; në të kundërt, Apolli, Afërdita dhe Aresi mbrojnë trojanët. 23 58. *Këmbëshpejtë*: mbiemër tradicional, i qëndrueshëm, zbukurues, që pasqyron një veti të Akilit (shih: *me këmbët me krahë*, v. 121 e gjetkë). Epitet që aludon në përgjithësi për aftësinë, shumë të rëndësishme për një luftëtar, për të ndjekur armikun dhe anasjelltas, për t’i ikur atij gjatë betejës. Nga ana e kritikës moderne është shtruar një hipotezë që çiftëzimi i qëndrueshëm i këtij epiteti me emrin e Akilit, e ka origjinën nga ndonjë rrëfim antik, që s’na ka arritur, ku kjo cilësi e Akilit, kishte një peshë përcaktuese në zhvillimin e ndonjë ngjarjeje. Është gjithashtu e mundshme që të vihet në raport me një episod të vetë *Iliadës*, ku shpejtësia e Akilit është theksuar me ngulmim të parreshtur, domethënë me ndjekjen e trefishtë të Hektorit rreth murit të Trojës (XXII, 136 etj.). Ky problem i pranishëm edhe në kritikën antike, shkaktoi në ndonjë rast hamendje të çuditshme. Një gramatikan i shek. I të e.s., Ptolome Chenko, rrëfen dy mite, që mund të merret me mend se kanë lindur me qëllim që të shpjegojnë shpejtësinë e Akilit: 1) që Kironi, të cilat ai i ishte besuar, i kishte vënë thembërn e Damysos, më i shpejti i Gjigantëve; 2) që Teti e kishte pajisur me krahët e Arkes, një hyjni, që e syrgjynosi Zeusi në Tartar, ngaqë kishte luftuar përkrah Titanëve gjatë luftës mes tyre dhe hyjnive olimpike.

24 62. *Falltar a prift*: punë e falltarëve ishte t’u interpretonin njerëzve shenjat e hyjnive, që zbulonin të ardhmen: gjëmime, fluturime zogjsh etj. Në Këngën e 17-të të *Odiseë* (v. 383) përmenden midis *demiuurgëve*, dmth. mes atyre, që ofrojnë disa shërbime publike. Prifti ka një kuptim më të gjerë sesa falltari. Prifti ishte përgjegjës për të gjitha ceremonitë kushtuar hyjnive, flijimet etj. dhe supozohej se njihte dëshirat e hyut, që i shërbente (shih v. 65).

25 63. Ëndërrshpjegonjës: që interpreton ëndrrat, të cilat i dërgojnë hyjnitë - këtu i referohet vetëm Zeusit - dhe shumë herë ishin tregues për të ardhmen për ata që dinin t’i interpretonin. Këtë ta kujtojmë më poshtë (*Iliada* II, 1-6), ku Zeusi dërgon ëndrrën mashtruese dhe shkatërruese tek Agamemnoni. Akili këtu nuk e ndien, sigurisht, se ëndrra mashtruese vjen nga Zeusi, që më pas, përgënjestrohet nga realiteti.

Naimi vargun 62-63 e përkthen: “Shtjes’ a faltorë të gjejmë./ A nonj’ ëndërrrëfënjës./ (Se dh’ ëndërra vjen nga Hyji), / Të pyesim e të na thotë.” 26 64. Akili është i sigurt se Apolloja është shkak i sëmundjes, sepse atij i atribuoheshin epidemitë me vdekje të papritura. 27 65. *Ndonjë hekatombë*: fjalë për fjalë: “Fli prej njëqind qesh”, përgjithësisht fli e pasur edhe me kafshë të tjera, veç qeve” (shih v. 309 dhe gjetkë). Në v. 99, 431 etj, karakterizohet e *shenjtë*, hyjnore, se i përket botës së hyjnive.

28 69. *Testorid*: i biri i Testorit, kështu Homeri quan dhe Alkmaonin, të cilin e vrau Sarpedoni (XII, 394). Mbase Alkmaoni është vëlla i falltarit Kalkant. Testori ishte bir i Apollonit apo Idmonit me Laotoin. *Kalka Testoridi*: Kalkanti, i biri i Testorit, është falltari i ushtrisë greke. 29 74. ... *nga Zeusi i dashur*: δούφιλος, që e do Zeusi, është një mbiemër tradicional, që u kushtohet shumë heronjve, si Fenikës (I, 168), Hektorit (X, 49), Odisesë (XI, 419), dhe të tjerëve. Shih shënimin: *hyjnor*, I, 7.

30 77. Kalkanti për të thënë mendimin e tij, kërkon përkrahjen e Akilit, gjë që do të thotë se ia kishte frikën Agamemnonit.

se dhe po të gëlltit zemërimin atë ditë, atëherë më pas gjersa të marrë hak inatin mban në gjoks; mendohu nëse do të më shpëtosh”. Dhe Akil këmbëshpejt iu përgjigj e i tha: “Ki kurajë e thuj profecinë hyjnore që të di mendja, 85 se për Apollonin³¹ i dashur nga Zeusi, që Kalkant

uratat t’i dëgjon, ti danajve shfaqu profecitë hyjnore, dhe gjersa unë të rroj dhe të hap sytë mbi tokë, askush, mbi ty s’do të ngre dorë të rëndë pranë anijeve n g a gjithë danajtë, as dhe po të përmendësh Agamemnonin, 90

që tani shumë lëvdohet se qenka më i forti i akejve”.³² Dhe falltari i paqortueshëm³³ mori guxim e tha: “As për blatë s’është hatërmбетur, as për hekatombë, por është prifti shkak, që Agamemnoni s’e nderoi;³⁴ dhe as i liroi të bijën, as e pranoi shpërblesën, 95 ja pse na pikëlloi e do të na pikëllojë Largshigjetari. Dhe më parë murtajën e frikshme s’do të largojë nga danajtë, pa i kthyer më parë të atit vajzën syndritur;³⁵ pa shpërblesë, të pablerë³⁶ e pa dërguar një hekatombë të shenjtë në Krisë; atëherë mund ta zbutim e mbase falja bëhet”. 100 Këto tha dhe u ul; e u ngrit mes tyre heroi Atrid, sundimtar i shumë popujve,³⁷ Agamemnoni, i helmuar; dhe vreri i frikshëm të brendshmet e zeza³⁸ i përmbytëte të gjitha e i shkëlqenin sytë porsi flakë. Me një shikim kuptimkeq shpejt Kalkantit i thirri: 105 “Falltar i të keqes³⁹, jo, kurrë s’më the një ogur të bardhë, mendja jote dëshiron të liga gjithnjë të parashohë; fjalë të mirë kurrë nuk ke folur as ke kryer. Dhe tani mes danajve profetizon duke thënë se për këtë shkak Largshigjetari u dërgon fatkeqësi, 110 ngaqë shpërblesën e pasur të bijës së Krisit s’doja të pranoja; po, unë dëshiroj më mirë vajzën në shtëpi të kem, që e çmoj vërtet mbi Klitemnestrën, gruan time të ligjshme, se më poshtë saj nuk është as në trup e në pamje, as në mendje e në punë. 115 Veç nëse kjo gjë nevojitet, prapa do ta kthej, popullin shëndoshë e mirë e dua, kurrë të mos shfaroset. Por përgatitmëni shpejt një dhuratë tjetër, se unë vetëm nga argejtë pa pjesë s’duhet të mbetem, s’është e hijshme,

31 86. Akili betohet për Apollonin (hyun e falltarisë, por edhe të Krisit, i cili kishte dërguar murtajën tek akejtë) se do ta ndihmojë.
32 91. ... *lëvdohet se është i pari i akejve*: këto fjalë nuk janë qortim për Agamemnonin, është kryekomandanti, mbreti më i madh (shih v.6 etj.). Që Akili t’i thotë falltarit: mos u tremb, do të të rri pranë edhe sikur të duhet të përballoj kryeprijësin, është diçka e natyrshme. Por paralelisht poeti përgatit përplasjen Akil-Agamemnon.
Akili duke thënë këtë frazë (“... sot lëvdohet se është i pari i akejve”) për Agamemnonin, njëherësh vë në dyshim kreun (udhëheqjen, komandën) e tij. Kjo do të thotë se përpara se Agamemnoni të vendosë për të marrë Briseidën nga Akili, dasia mes tyre ka filluar. E nisi Akili me qëndrimin dhe fjalët e tij. Veprimi i mëpasme i Agamemnonit që të mëtojë vajzën nga Akili, mund të jetë përgjigjia e mbretit dhe e prijësit të grekëve, që ta sjellë në rregull. Madje dhe veprimi i Kalkantit, që të kërkojë përkrahjen e Akilit për të folur, i rrëfeu Akilit se ajo që do të thotë, do të ishte diçka e keqe për Agamemnonin. Dhe e përkrah menjëherë, e ndërkohë akuzon Agamemnonin, dhe pret përluljen e prijësit.
33 92. ... *i paqortueshëm*: fisnik, i patëmetë, i përkryer, i shquar, i papërgënjeshtuar. Mbiemër epik, që paraqet një lavdërim të përgjithshëm dhe i referohet më shumë pozicionit shoqëror të heroit: le të kujtojmë Egjistin e paqortueshëm (fisnik) në Këngën 1 të *Odisesë* (v. 39), ku përjashtohet çdo ngjyrim moral.
34 94. *Atridi e përbuzi*: që nuk e nderoi si duhej, e ka fyer. Shih dhe v. 244.
35 98. ἑλικώπιδά κοῦρην: vajza me sy të ndritshëm, ky është i vetmi rast te Homeri, që epitetin ἑλικώπυ e referon një κοῦρη, vajze. Në të gjitha rrethanat e tjera shfaqet në formulën ἑλικώπες Ἀχαιοί (shih p.sh.: v. 389). Kritikë antikë dhe modernë janë ndarë lidhur me kuptimin e shprehjes: shumë kuptojnë ἑλικώπυ = “me sy të lëvizshëm”, “me vështrim të gjallë, të ndezur”, sipas të tjerëve, përkundrazi kupton “me sy të zezë”.
36 99. ... *pa shpërblesë, të pablerë*: Krisi kishte ardhur me dhurata të pasura, që të shkëmbente lirinë e të bijës. Tani Kriseida duhej t’i kthehej të atit pa qenë nevoja për shpërblesë.
37 102. ... *sundimtar i shumë popujve*: karakterizim i Agamemnonit, shih *prijës i burrave* (v. 7), prijës i heronjve, i ushtrisë: Agamemnoni me një sundim të gjerë.
38 103. ... *të brendshmet e zeza*: mund të supozonim se të brendshmet janë të zeza nga zemërimi, shih: u nxi zemra ime. Por, meqë herë të tjera *të brendshmet e zeza* mbushen me vrull, me forcë, me kurajë, është më e saktë të themi që të brendshmet janë të zeza, se gjenden në brendësi të trupit, pra kemi të bëjmë me një mbiemër tipik, që nuk i referohet rastit të veçantë me të cilin ndeshemi.
Dhe një shpjegim tjetër: ὀφρέας (frenes, *it.* precordi), shkolla hipokratike quan kësisoj diafragmën, por ngjan që te Homeri ky term, i përdorur në njëjës a shumës, i korrespondon në përgjithësi gjithë sa gjendet rreth zemrës, në gjoks, shih p.sh. te VIII, 413; XVI, 481, 504; *Odisea* IX, 301. Imagjinohej që ὀφρέας ishin ideja e emocioneve, dashuri, zemërim, kurajë dhe e mendimit dhe zgjuarsisë.
39 106-108. Agamemnoni si duket i referohet një profecie tjetër, dhënë nga Kalkanti në Greçi, para fillimit të luftës, sipas së cilës flota do të nisej për në Trojë vetëm kur t’i sakrifikohej Artemidës një nga vajzat e Agamemnonit, Ifigjenia.

se të gjithë e shihni që dhurata ime gjetkë shkon”.⁴⁰ 120 Ia ktheu këmbëshpejt Pelid baras me hyjnitë: “Atridi lavdimadh, më kamjedashësi nga të gjithë, shpirtmëdhenjtë akej si të të japin dhuratë? Mos dihet vallë se ka diku plaçkë⁴¹ të pasur të përbashkët? Gjithë sa nga qytetet që pushtuam u ndanë 125 dhe t’i bëjnë prapë grumbull popujt s’është e drejtë. Por ti tani atë për hir të hyut liroje dhe akejtë trefish e katërfish do të ta shpërblejmë nëse dikur Zeusi e jep të pushtojmë qytetin e Trojës me mure të fuqishme”. Dhe i fuqishmi Agamemnon atij iu përgjigj e tha: 130 “Por kështu, dhe pse qenke trim, Akil pamjehyjnor, dredhisht s’do t’ia dalësh mbanë, lehtë s’do të më bindësh. Vërtet dashke që ti të kesh dhuratën tënde e mua të më mungojë dhe më nxit atë ta kthej pas. Por nëse më japin një dhuratë akejtë shpirtmëdhenj 135 sipas shijes sime, pjesë e barasvlershme, mirë do të jetë, e po s’më dhanë, do të vij me dorën time të marr ose tënden, a dhuratën e Ajaksit apo atë të Odisesë⁴² do të marr; e te kush të vij më ngjan zemërimin do t’i cingërit. Por të gjitha këto bashkë do t’i mendojmë pastaj: 140 Tani një anije të zezë⁴³ të shtyjmë në detin hyjnor, dhe rremtarë të zgjedhur të mbledhim, e një hekatombë brenda të vëmë dhe në të faqebukurën⁴⁴ Kriseidë të hipim dhe prijës një nga krerët këshilltarë, Ajaksi, Idomeneu apo Odise hyjnor, 145 apo ti Pelid, tmerr i gjithë burrave me flinë mund të zbutësh Largshigjetarin”. Egër e pa dhe u përgjigj Akili këmbëshpejtë: “Ah, interesaxhi, veshur me paturpësi, cili nga akejtë i gatshëm do të bindej nga fjalët e tua 150 në udhë të dalë a me burra të luftojë trimërisht? Se unë nuk erdha që me heshtëmbajtësit trojanë këtu të luftoj, të cilët në asgjë nuk më kanë faj; se kurrë nuk dolën të na marrin qetë apo kuajt, dhe kurrë as në Ftian plisëmadhe e burrë ushqyese⁴⁵ 155 s’më rrënuan prodhimet se mes nesh gjenden shumë male hijegjatë e deti zhurmëmadh. Por ty, o i paturp, të ndoqem, që të gëzoheshe, nder të merrnim për Menelaun dhe për ty, fytyrëqen, nga trojanët; dhe për këto nuk shqetësohesh, nuk i përfill. 160 Dhe tani kërcënon të më marrësh dhuratën, për të u mundova shumë e ma dhanë bijtë e akejve.⁴⁶ Se kurrë baras me ty nuk kam pjesë, kur akejtë shkelin ndonjë kala të shumëpopulluar të trojanëve; por më të shumtën e luftës së stuhishme 165 duart e mia e qeverisin, e pastaj po të gjendemi në ndarje, pjesa jote shumë e madhe dhe unë të vogël, po të dashur sjell në anije kur kthehem i dërmuar nga beteja. Por tani në Ftia do të shkoj, se është shumë më mirë të kthehem në atdhe mbi anijet zgavroshe,⁴⁷ e s’ndërmend për ty 170 të rri këtu i panderuar e kamje e pasuri të mbledh”. Dhe atij iu përgjigj mbreti burrave Agamemnon: “Ikë nëse zemra të shtyn, unë ty vërtet”⁴⁸ s’do të të lutem të rrish me mua, pranë meje kam dhe të tjerë që do të më nderojnë, dhe mbi të tërë Zeusi i gjithëditur.175 Ti më je më i urryeri nga mbretërit hyjnimëkuar⁴⁹

40 120. Nga kjo pikë e tutje, shihet se *kjo kundërshti* ka prejardhje të largët, përtej rastit të tanishëm, dhe vështirë të ndërtohet. Dhurata për të cilën diskutohet është vlerësimi, që secili merr për aksionet, që ka kryer, dhe e bëjnë secilin me “nderin” personal. Agamemnoni, kreu ushtarak i zgjedhur, merr më shumë se të tjerët, por nëse një Akil, konsiderohet më i fortë se ai, nuk ekziston ligj, që e detyron të bindet.

41 125. Akili do të kujtojë më pas se vetë ai me njerëzit e tij ka shkatërruar dymbëdhjetë qytete; në rrjedhën e poemës, prej tyre emërohen Teba, Lirnesoja, Lesboja, Skiroja, Tenedi, Pedasi. Plaçka e luftës, marrë nga këto qytete, përbëhej nga tripodë, kazanë, ar, bronz, hekur, kuaj, mushka, kope, qe dhe gra të bëra sklave (IX, 122-130; XIX, 243-248; XXIII, 259-261, 549-550).

42 138. ... *do të vij me dorën time/ të marr ose dhuratën tënde a të Ajaksit apo atë të Odisesë* i thotë Agamemnoni se po të japë dhuratën e tij (Kriseidën), do të marrë ose të Akilit, ose të Ajaksit ose të Odisesë (madje, që të shohë dhe reagimin e dy mbretërve të tjerë).

43 141. Anija ishte e zezë se trupi ishte lyer me katran, për t’i rezistuar veprimit gërryes të ujit.

εις ἄλα ὄϊαv, në detin hyjnor: në këtë rast epiteti ὄϊαv, i kthyer në “hyjnor”, sipas traditës, ruan dhe ngjyrimin original: “i ndritshëm”.

44 143. καλλιπάρηov, me faqe të bukura: epiteti i bukurisë femërore, thënë edhe për Briseidën (v. 184, 323,346), Leton (XXIV, 607), Helenën (*Odisea*, XV, 123) etj.

45 155. Naimi vargun “as në Ftian plisëmadhe e burrë ushqyese”, e përkthen: “As në bimërat të Ethisë/ pëllore dhe burramadhe”.

46 162. Shprehje që në thelb është sinonim i *akejve*; por thekson faktin që në luftë shkojnë të rinjtë, kurse etërit pleq qëndrojnë në shtëpi.

47 170. Naimi: “Me anijat kryekthyer...” (të kthehem mbi anijet zgavroshe).

48 173. Krerët, që ndjekin Agamemnonin janë bashkuar me të me një aleancë të lirë, jo në një raport vasaliteti, dhe mund të tërhiqen nga ajo kur të dëshirojnë.

49 176. Mbretërit thirrreshin kësisoj se besohej që dinjitetin dhe autoritetin e merrnin nga Zeusi. Në përkthimet italisht përdoret forma: *alunni di Zeus*, xnënës, dishepull i Zeusit. Ne preferuam përthimin e drejtpërdrejt nga Homeri: hyjnimëkuar (ushqyer nga Zeusi).

se grindjen⁵⁰ etje ke, betejat edhe luftërat, e nëse je kaq i fuqishëm, këtë ta ka dhënë një hyjni. Shko në shtëpi me anijet e tua, me shokët e tu dhe mbi mirmidonët mbretëro; unë s’të llogarit aspak 180 e mërinë tënde shpërfill, por kanosjen time dëgjo: Ashtu si më merr Kriseidën Febi Apollon, atë me shokët të mi dhe anijen time, do ta nis, por do të marr Briseidën faqetrëndafile duke ardhur unë vetë në çadrën tënde, që të mësosh 185 se sa më i fortë jam se ty dhe të frikësohet tjetërkush të më flasë i barabartë a të më përngajë kur gjendet përballë”. Kështu foli dhe u hidhërua Pelidi e zemra në gjoksin leshtor i rrihte mëdyshas: Të nxirrte shpatën e mprehtë që varej pranë kofshës 190 dhe t’i shpërndante të gjithë e të therte Atridin, apo të qetësonte zemërimin dhe zemrën të përmbante. E këto kur vërtiste nëpër mendje e shpirt, nga këllëfi shpatën e madhe hiqte, por erdhi Athinaja, nga qiejt dërguar nga llërëbardha Herë, 195 që për të dy njëlloj kujdesej e i donte me gjithë shpirt;⁵¹ i ndenji pas dhe nga flokët e verdhë kapi Peleonin, e dukshme vetëm tek ai, askush tjetër s’e shikonte. U shtang Akili, u kthye prapa dhe e njohu menjëherë Palladë Athinanë; me një shkëlqim tmerrues nëpër sy 200 duke u kthyer asaj i foli me fjalë fluturake:⁵² “Përse erdhe bijë e Zeusit mburojëmbajtës?⁵³ Të shohësh vallë përdhunën e Atrid Agamemnonit? Por të them qartë dhe më ngjan, kjo do të kryhet, me këtë fodullëk të pavend, shpejt do të humbasë jetën”. 205 Dhe hyjneshë Athina sykaltra⁵⁴ atij iu përgjigj: “Erdha të të përmbaj zemërimin, po të më dëgjosh, nga qielli; më dërgoi hyjneshë Hera llërëbardha, që për të dy njëlloj kujdeset e ju do me gjithë shpirt; eja, ndale grindjen, me dorë shpatën mos e nxirr. 210 Po me fjalë po deshe shaje me ç’të të zërë gjuha. Dhe si të them e do të bëhet, do të shohësh, dhurata të trefishta të paçmuara një ditë do të të japin për këtë përdhunë; por na dëgjo, përmbaje zemërimin”. Dhe duke iu përgjigjur Akili këmbëshpejtë i tha: 215 “Fjalës suaj, hyjneshë, është e nevojshme t’i bindem dhe pse në zemër fort i mëritur; kjo është më e mira, kush hyjnitë i dëgjon dhe ata e dëgjojnë shumë”. Foli e mbi dorezën e argjendte mbajti dorën e rëndë dhe në këllëf shtyu prapë shpatën e madhe, iu bind 220 fjalës së Athinasë dhe ajo prapë në Olimp u ngjit mes hyjnive, në pallatin e Zeusit mburojëmbajtës. Atëherë përsëri Pelidi me fjalë sharake iu kthye Atridit pa përmbajtur zemërimin: “O sarhosh, syqen⁵⁵ dhe me zemër dreri, 225 kurrë s’u armatose me ushtrinë për luftë, as të shkosh në pritë me akejtë më trima s’të ka guxuar zemra, kjo të ngjan porsi vdekje! Vërtet është më e lehtë në kampin e gjerë të akejve t’i rrëmbesh dhuratat atij që sy për sy të flet, 230 mbret popullngrënës, që urdhëron përmbi të pavlerë, ndryshe Atrid kjo padrejtësia jote e fundit do të ishte. Por një fjalë të them dhe do të bëj një betim të madh: Për këtë skeptër,⁵⁶ i cili kurrë më degë apo gjethe s’do të nxjerrë, pasi la trungun atje në male ku u pre 235 e s’do të lulëzojë më, gjersa përreth ia zhvoshku bronzi

50 177. ... *se grindjen* (ἐρις) *etje ke, betejat edhe luftërat*: Erida ka hedhur mollën në dasmën e Peleut me Tetidën, pra të prindërve të Akilit. Kishte të shkruar sipër: ‘Më të bukurës’. Këtë mollë ia shpunë Parit tri hyjneshat: Athinaja, Hera dhe Afërdita, që të gjykonte dhe t’ia jepte më të bukurës. Kjo mollë ishte shkaku i luftës së Trojës. Duke thënë këto, Agamemnoni i kujton Akilit se familja e tij, dhe ai vetë, ka lidhje me fushatën dhe nuk është dorëjashtë, si theksonte më parë. Shënojmë dhe frazën e Pausanias (*Arkadiket*, 25, 6), që thotë: Kur dikush zotërohet nga zemërimi, arkadët e quajnë “ἐρινόειν” (eriniin). Këtë mund ta lidhim me atë që arkadët ishin pasardhës të Pellazgut dhe Akili falet më pas te “Zeusi pellazgjik” (XVI, 233). Kjo Eridë mund të rrëfejë “gisht pellazgjik” në fillim të historisë, që përfundoi me luftën akej-trojanë.
51 196. Hera dhe Athinaja duan ta shohin Trojën të shkatërruar nga urrejtja për Paridin, i cili në konkursin e famshëm të bukurisë, i dha çmimin Afërditës, por *Iliada* nuk e njih ose rrëfen se nuk e njih legjendën (XXIV, 30, shënimi).
52 201. ἔπειτα πτερόεντα, *fjalë që fluturojnë*: formulë shumë e zakonshme si tek *Iliada* dhe tek *Odisea*, mbështetur në imagjinatën që kur fjala shqiptohet fluturon përmes ajrit nga folësi te dëgjuesi.
53 202. αἰγυόχοος te Homeri është epiteti vetëm i Zeusit, tek autorët e mëvonshëm edhe i Athinasë; fjalë për fjalë do të thotë “që vringëllon mburojën”. Zeusi tundte mburojën për të mbjellë terror mes ushtrive, apo për të mbledhur retë për një shtrëngatë (shp. i botimit *Bur*). Pantazidi e shpjegon si *mbajtës i egdës* (mburojëmbajtës).
54 206. γλαυκῶπις, me sy të kaltër, epiteti i Athinasë me etimologji të pasigurt dhe interpretime komplekse. Komenti aleksandrinas theksonte se hyjneshat thirrje kështu se kishte sy γλαυκοί, *një* term që shpreh njëherësh shkëlqimin dhe ngjyrën e kaltër të kulluar.
55 225. Akili e thërret Agamemnonin κυνώπα, “fytyrë prej qeni”, më lart në v. 159. Qeni te grekët ishte simbol i paftytrësisë, i paturpësisë (shih VIII, 423, 483; XI, 362; XIII, 623 etj.); krahasimi me të do këtu të theksojë paturpësinë e mbretit, që shoqërohet me një paburrëri thelbësore, përfaqësuar në përballjen me drerin. Epiteti u përmendet edhe grave e hyjneshave: Helena e atribuon shumë herë (III, 180; VI, 344; *Odisea* IV, 145); Hefesti ia përmend Afërditës së pabesë (*Odisea* VIII, 319) dhe Agamemnoni Klitemnestrës besëthytëse.
56 234. Skeptri në fjalë nuk i përket Akilit, por është ai që kasneci i vë në dorë atij që ngrihet të flasë në asamble, për të treguar legjitimitetin, karakterin zyrtar, pra autoritetin e ndërhyrjes së tij (shih: II, 279; III, 218; X, 321, 328; XXIII, 566-568).

Adam
poezi nga
ARBËR
SELMANI

KUR VDIQ BABA

Kur vdiq baba,
vdiq një pjesë e imja,
vdiq pak edhe nana e pak edhe motra me të,
vdiqën këmishat e tij
vdiq rroga ime e fundit në xhepin e djathtë
vdiq ditë e bekuar,
vdiqën kërkimfaljet, shuplakat e forta, dëshirat që i pata
andrrat që s'i pata
vdiq pazari i mëngjesit, edhe krejt mëngjesi vdiq atë ditë.

Kur vdiq baba,
Ka vdekë edhe një lis diku në malin e shenjtë,
Ka vdekë një e mirë, një mirësi, një përrallë që nuk u tregua më,
Ka vdekë trupi që jeta nuk i dha gjë prej gjëje,
Se nuk quhet jetë
Kur çdo pesë vjet, fatkeqësia gjen paqen e saj mbi ty.

Kur vdiq baba,
Vdiq copë copë në tepihun e banjos.
U zvarrita deri te rubineti për ta larë fytyrën,
Për ta parë vdekjen time,
Për të harruar sa trupi po vdiste në po të njëjtën ditë.

Kur vdiq baba,
Kush nuk u kfill më në shtëpinë time,
Vdiq zënka e fundit, vdiq një bursë studimi për Amerikë,
vdiq edhe diploma e shkollës, që sot s'është as leckë.

Vdiqën burrat e dobët të kësaj bote,
Vdiqën gratë të cilave natyra iu dha shkelma shpesh e më shpesh.
Vdiq me babën edhe lumturia ime,
Vdiqën detet ku dikur futa trupin tim të pakohë,

Vdiqën fushat ku jam rritë i gëzuar,
Vdiq i dashuri im i harruar,
Vdiq gruaja ime që nuk do të ekzistojë kurrë.

Me vdekjen e babës ka vdekë një copë e imja e vjetër.

Me babën ka vdekur edhe e bukura,
Kompleti i librave të Asdrenit dhe Kapitali i Marksit,
Ka vdekur çdo poezi e Rumi.
Kur vdiq baba,
E ndjeva pickimin në shpirt dhe shtrëngimin e Zotit
I pashë para meje ata që nuk janë të bukur sa ai
Se askush nuk është më i bukur se bukuria hyjnore e babës,
Se krejt patën jetën e mirë, po jo i imi babë
Se shumica morrën përqaftime kur ai derdhi lot,
Se fati ka shëtitur në qytet këmbëzbathur po babën
tim nuk e takoi dot.

Kur vdiq baba, zanat e bardha më janë kthyer në gjarpër të zi e të gjatë.

Kur vdiq baba,
Krejt orenditë e shtëpisë i kam rrotullu e nuk e kam gjetë,
Morra avion, e as në shtetin tjetër për të nuk kishte vend,
I mblodha dromcat e mërzisë dhe i kapa bashkë, i përthekova
Kur vdiq baba,
Ka vdekur edhe një perëndi diku lart që u lodh së jetuari,
Ka vdekur një Eros që ditët e mira i pati të porositura,
Kanë vdekur shokët e tij, shoqet, kanë vdekur të afërmit që nuk janë kurrë të tillë.
Kur vdiq baba,
U ula buzë lumit të lotëve të mi dhe qava.

ADAM

Ti më jepe dashni të nanës
Ti më jepe dashni të babës
Ti që emrin e ke nur
Ti që sytë mi dhe tri net
Tri ditë t'bardha i patëm bashkë.

Adam.
Ty që t'i fala fjalët e pakta
Që humba në leshin e gjoksit tand
Humba në mjekrrën tande
Humba si humbet luga në mjaltë
Mjaltë goja jote
Deti im i munguar
Natë për natë të kam ledhatuar
Ty që më dhe andrra

E andrrat që i qava se i doja e su bënë të vërteta.

Humba nëpër këmbët tua
Humba e nëpërkëmba në ty
T'i deshta sytë
Bisedat
Trupat qe na u prekën
Ecjen tënde fëmijërore
Pafajësinë e njeriut të mirë
Sa mirë o Zot
Sa i mirë është një Adam i jetës time
Një Adam si ky.

Ty që u duke i heshtur
Që lexon Çehovin e që më puth mua në mes kapitujsh
T'i kushtoj ty këto vargje
A është këngë kjo, nuk e di
Por e këndova sylot dje.

Ty, lumi unë që të pata
Lumi unë që qava
Që të zhvesha
Që të putha në plagë
Në dhembje
Në dritë të syve
Që të shikova si perëndinë në lëvizje.
Që u kujdesa për ty si për fjalën e thënë
Por ishe ti ai që m'përqafove
Që m'hutove
Që m'ktheve në një llambë që ndizet
Si llamba që unë e fikja kur flinim.

Në datë 20,21 e 22.
Adam.
Humba brenda gojës tënde
Humba në duart që i bashkonim,
T'pata tvetmin ty,
Ti mdeshte për të rrahurat e zemrës tande
Ti më prite
Vrapove më shpejtë se unë
M'përqafove
Të ftohtit u kthye në ndjenjë
E nxehtësia nuk ish përvëluese
Krahët mi morre, mi puthe
Më deshte me trupin tënd hyjnor
Mi preke sytë e ma puthe ballin
Më bëre mollën tënde.

Pak prej meje morre
Mi numërove vuajtjet pa t'i thënë
Ti e vërejte sa isha dhënë pas teje
Ti mi dashurove duart
Duart tua i shumëzove më të miat
I puthëm bashkë, e ato na zhveshën turpin.
U ndamë ndoshta.
Më dhe gotën e ujit
E unë natën t'i shprisha flokët
E unë e dija që ishe i veçantë
T'i tregova mërzitë e mia
Të thjeshtat, më pak të dhimbshmet
Por nuk fola, se të putha
Çdo pjesë të trupit.
Çdo grimcë
Çdo vrimë
Çdo aromë tënden e morra me vete ditë për ditë, Adam.

Drita e mëngjesit ishte më e mirë me ty,
Mu bëre dikush që nuk e kisha
Mu bëre përqaftimi qe e pata rrallëherë
U liga
U treta në ty
U bëra një copë trupi e vogël
Karshi teje.
U bëra i papritur afër teje
Afer muskujve që agimeve i puthja
I numëroja
I mallkoja që s'janë të mitë çdo natë.
Më fal Adam,
Kam qarë shumë kur u ktheva
Kur u braktisëm.



Kujtimet në shtambën e harresës *poezi nga* METI DISHA

1 - NË KOHË KARANTINE

komshiu im,
na nevojitet një lumturi pa arsye.

muret e karantinës janë muret e shtëpive tona,
dhe dritaret janë tejqyra drejtuar botës.
i kemi duart e vockla, nga lutjet e vockla,
në të cilat nuk zënë më vend dëshirat e kësibotshme.
përtej, ti pi duhan dhe mendohesh
nga një tjetër dritare me gjysëm fryme.
është koha të lumturohemi pa arsye - të them,
-si budallenjtë?! - ma pret ti dhe bën me shenjë muret...
jo, si fëmijët, të them dhe bëj me shenjë lulet.

është mars dhe buzëqeshjet tona
janë modeste si rritje pensionesh,
ato zënë përherë veç 2.5 përqind të fytyrës.

...kështu pra, të jemi të lumtur, komshiu im, krejt pa arsye,
pavarësisht turinjve që varim kur është fund muaji
dhe presim lajmin e madh në celular q'u hodhën rrogat,
pavarësisht turinjve të varur të grave tona,
teksa u tregojmë hënën e re, me sy që na ndrijnë
dhe ato vënë duart te barku,
sa herë është fundi i ndonjë muaji,
apo fillimi i ndonjë tjetri.

2 - MESNATA NË ODË

vij vonë te kjo derë.
brenda meje gjithnjë
ajo ndjesia e vonësës.

janë të gjitha aty: qilimi i ftohtë,
çardaku i drunjtë, qelqi i akullt i dritares
dhe muret prej guri latuar qyshkur,
ku babai mbante fjalën e tij.
zërat jehonin pa mundur të dilnin jashtë
dhe oda ishte kryekëmbë portret i tij.

asgjë nuk ka ndryshuar
veç kujtimet janë ende të rrjedhshme
në shtambën e harresës.

3 - PËR TË THJESHTËN

ajo donte të dukej e thjeshtë.
i kapte flokët mbledhur nga pas
si një vegjë filxhani që rrethon një boshllëk.

mes gjithë stromcave të një paji,
pëlqente veç një fustan të gjatë,
e nga të tjerat veçonte dashurinë
qe nuk e gjen në garderobë,
as në kuletë, në mesditë kur të duhet të paguash faturat,
apo kur rrëmon në reliktet e rafteve,
apo as në kasafortë atje diku midis tapisë së shtëpisë
dhe unazave me flori saf të gjyshërve,
por dashuria shfaqej veç në të errët,
si neoni në akrepat dhe numrat e një ore
që shndrit për pleqtë kur ngrihen nga halli te urinojnë
dhe s'gjejnë dritë pas mesnate.

ajo ishte e thjeshtë si thesar i cili është i tillë
për sa kohë nuk është gjetur;
i vjetër, mbi të cilin koha ka hedhur tradhëti,
fjalë të hidhëta, zhgënjime,
sikurse shiu që nga njëra anë ja njom rrënjët trëndafil,
kurse kërcellin dhe gjethet ja mbush me stërkala prej
balte.

ajo ishte e thjeshtë edhe kur ai, i dehur, u kthye në shtëpi
dhe e pa ashtu përlyer prej gatimit, gjithë erë gjelle...
ajo e priti me një buzëqeshje,
një buzëqeshje si për të ndrequr një gabim në shkreti...
kur hëngri grushtin dhe njëri dhëmb iu thye,
por që nuk qau, ngaqë s'ish hera e parë
që nuk e dallonte më neonin e shndritshëm
dhe flil kështu, kaq thjeshtë, ja tha edhe gjykatësit.

tani ajo, një trëndafil nga ato erëmirët,
plot gjemba dhe me stërkala dheu nga shirat,
kërkon veç një dorë e cila do ta ujitë dhe aq.

4 – DOBËSITË

burri mendohet i qetë
me të pasmen e kokës mbi pëllëmbë të dorës,
dora e mbështetur mbi nënkresë
si një makinë e ngjitur në karrotrec,
në një shtrat me të shoqen e cila fle gjysëm e zbuluar.

janë dobësitë ato që të bëjnë burrë, mendon
duke ledhatuar lehtë supet e saj
si Akili, i cili kur kruante thembrën,
e dinte mirë se po kruante dobësinë e tij.

për Akilin, dobësia fshihej nën këmbë
që të mund të shkilte mbi të
dhe ky është kamuflazh mjeshtëror,
se veç atëherë njerëzve nuk do t'u shkojë mendja,
se kush është ai budalla që shkel mbi dobësinë e vet?!

gruaja fle e qetë, pa e ditur
se krejt në mënyrë të pavullnetshme
është kthyer në motiv ekzistence
që kur t'i vijë koha, do të shkilet nga këmbë e burrit,
(si kamuflim ndaj syrit të keq),
apo nga goditjet e fatit
që duan ta gjunjëzojnë burrin atje te thembra.

5 - BARDHI DHE UNË

me Bardhin nuk flasim tepër
në kafe, në mëngjes, ai ulet tek pullë
në një tavoline të madhe veçmas e cila ka katër karrige.
kjo tregon shumë për të, sa herë kur vjen herët
dhe syri i tij vështron të gjejë një vend
ku nuk mund ta zëtejë vetmia.



vendi ku zgjedhim të ulemi,
atëherë kur nuk e kemi mendjen,
është vendi të cilit ne i përkasim.

bardhi jeton tri blloqe shtëpish më tutje,
nuk është martuar, por shpresat i mban ndezur,
kjo kuptohet nga tre vendet bosh në tavolinë...
në mos njëra, tjetra do mbushet.

ai më përshendet, mirëmëngjes më thotë,
kur më sheh të ulur vetëm
në një tavolinë të vogël
me dy karrige,
ngushtë si në një tra
që duhen veç dy vetë për të mbajtur ekuilibrin
nga të dyja anët.

i qëndroj besnik idesë së ekuilibrit
dhe bardhi e di fort mirë këtë gjë, kur më thotë:
ulesh përballë një karrige bosh
në pozicion shahisti drejtuar me përpikmëri,
si besimtarët në namaz ndaj Kiblës.

por unë jam hoxhë, o bardh,
hoxhë i lodhur duke falur xhenaze ëndrrash.

6 - MALLI QË S'HIQET

gjatë viteve të studimit
kam qenë i trishtuar si një qen rruge.
në auditor, prisja që ndonjë pedagog me burrëri dhe
guxim
të shkruante në tabelë atë q'e dija prej kohësh,
kumtin e epokës në atdheun tim ku u linda:
“ju hasët në rrugë qorre,
ju lutemi mos thurni ëndrra!”

askush nuk e bëri.
më lanë të lirë të bridhja
me sy që shndriste në to e gjelbërta.

unë e di, se mërgimtarët fort i merr malli për vendin e tyre,
por ju them që është më e zorshme të të marrë malli
për atdheun tënd në atdheun tënd!
dhe m'e zorshmja është të mund të çash përtej ëndrrave,
pa u kapur pas shpresës,
të kalosh muret e qorrsokakëve,
të grisësh limitin e durimit
dhe vetminë ta kesh besnike si qen.

sot eci trotuarit gjysmë i harruar.
në trastë kam këmishën e një malli që s'më hiqet
dhe veshur kam këpucë pengjesh të pagrisshme,
mbledhur në kaq e kaq vite
në garderobën time të zemrës.

këpucët e mia shkelin mbi gjethe të rëna në pellgje të vogla
dhe hapërdajnë ujin gjithandej, në qindra copëza,
ku në çdo stërkalë dhe në qelqet e syve të kalimtarëve
reflektohet nga një copëz gjethe e zverdhur;
dihet, çdokush e ka hisen e vet prej vjeshte.

eci. kam ende abdesin e sabahut
- nuk vonoj kur më thërret Zoti,-
dhe shkoj në punë i vonuar si gjithnjë,
atje në zyrën e një redaksie
ku dikur ka punuar ervin hatibi,
dhe ai: një qen i trishtë q'e lodhnin oraret;
e ndjej se po shkel mbi gjurmë të pluhrosura,
sot nuk kam ëndrra, por vizione.

ju thashë jam gjysëm i harruar...
ngaqë nuk jam i harrueshëm krejt.
nga kryet, më shkunden mbi supe herë pas here
ca fije thinjash kasnece që m'i çon koha,
por nuk trembem, ngaqë, për mua si poet,
vdekja është antonim i kujtesës...

por mua do më mbajnë mend këpucët,
pellgjet, muret, letrat dhe njerëzit
e në kujtesën e gjithnajtës
era e poezisë do valëvisë sa andej këtej
këmishën e këtij malli që s'më hiqet.

PËR VEPRËN E RULFOS


Bajram Karabolli

Aty nga viti 2000, rastësisht, në një revistë letrare në Buenos Aires, lexova tregimin *Thuaju të mos më vrasin* të shkrimtarit meksikan Huan Rulfo. Ky lexim më la një mbresë të fuqishme. U mahnita me artin magjik të shkrimtarit, por edhe u dëshpërova për mjerimin tim, që nuk njihja një shkrimtar të tillë. Menjëherë, gjeta dhe lexova gjithë veprën e tij. Ishte një zbulim i madh për mua. Një shkrimtar vetëm me dy vepra letrare: *Rrafshina në flakë* (Vëllim me tregime, 1954) dhe *Pedro Paramo* apo *Murmurimat* (Roman, 1956), një nga më përfaqësuesit e Realizmit Magjik dhe i Boom-it në oqeanin e letërsisë latinoamerikane, pothuaj i panjohur në Shqipëri. Thashë me vete: Nuk do të vdes pa e përkthyer në shqip këtë autor të magjishëm. Vite më pas, iu futa veprës letrare të Rulfos. Pasi mbarova *Pedro Paramon*, pata fatin të takoj shkrimtarin spanjoll Javier Serkas (Javier Cercas), autorin e romanit interesant *Ushtarët e Salaminës*, përkthyer në shqip prej Bashkim Shehut. Nga Serkas mora vesh se Rulfo nuk qenqesh njohur sa duhej si shkrimtar i madh, vetëm sepse përkthimi i tij në anglisht kishte qenë i dobët. Duke pasur parasysh këtë gjëmë (po e quaj kështu përkthimin e keq) që i ishte bërë këtij shkrimtari dhe gjuhës së tij sa rurale aq edhe universale, u bëra edhe më i vetëdijshëm për vështirësinë dhe rëndësinë e përkthimit të tij në shqip. Kësisoj, iu ktheva disa herë përkthimit të veprës së tij, duke punuar me gjongulin më të madh dhe dëshirën më të zjarrtë, për ta bërë këtë autor të fliste sa më shqip. Në këtë kuptim, sado që jam munduar t'i qëndroj besnik autorit dhe gjuhës së tij, mendoj se kam anuar nga lexuesi shqiptar.

Vepra e Rulfos nuk është më shumë se 300 faqe, po për të janë shkruar e vazhdojnë të shkruhen mijëra faqe. Me emrin e tij ka dy çmime letrare në letërsinë amerikano-hispanike. Pse nuk shkroi më, për tridhjetë vjet, derisa vdiq më 1986? Është një enigmë. Kur miqtë e tij e pyesnin pse nuk shkruante më, ai u përgjigjej me shaka: sepse xhaxhai im që më rrëfente historira ka vdekur.

Huan Rulfo (Juan Rulfo), emri i vërtetë i të cilit ishte Huan Nepomuseno Péres Viskaino (Juan Nepomuceno Pérez Vizcaíno), i përket brezit të viteve '50 të shekullit që shkoi. Rulfo lindi në qytetin Sajula (Sayula) të shtetit meksikan Halisko (Jalisco), më 16 maj 1917. U rrit në fshatin San Gabriel, në rrethinat e Sajulës, një fshat i vogël rural, i sunduar nga supersticionet dhe kulti për të vdekurit. Familja e tij vuajti pasoja të luftërave kristiane (1926 - 1928), një kryengritje e besimtarëve katolikë kundër qeverisë meksikane, ku iu vra edhe i ati. Janë pikërisht këto vite në jetën e 10-12-vjeçarit Rulfo që do të lënë gjurmë të pashlyeshme në universin e tij të pikëlluar dhe do ta frymëzojnë e do ta ushqejnë fantazinë e tij për të krijuar atë vepër letrare, sa të shkurtër aq edhe brilante. Ai shpërthim mujshie, ato gjurmë të thella dhimbjeje prej dhunës revolucionare, do të ndikojnë fuqishëm në vizionin e tij ndaj botës, gjë që reflektohet qartë në veprën e tij, sidomos tek tregimi *Rrafshina në flakë*.

Huan Rulfo, edhe pse pak prodhimtar, është një nga shkrimtarët më me emër të shekullit XX. Sipas një ankete të realizuar nga editoriali më prestigjioz, Alfaguara, Huan Rulfo, edhe pse ka shkruar aq pak,



BAJRAM KARABOLLI

konsiderohet një nga shkrimtarët e shquar të gjuhës spanjolle, i ngjashëm me Borhesin për nga mënyra e të rrëfyerit. Rulfo është shkrimtari meksikan më i përkthyer në gjuhët e huaja. *Rrafshina në flakë*, si rrallë vepër tjetër letrare, është përkthyer në njëqind e dyzet gjuhë.

Rulfo, ashtu si dhe Borhes, Fuentes, Markes, Asturias, Karpentier, Isabela Alende, Mario Vargas Josa etj., i përket lëvizjes letrare të shekullit XX, të quajtur *Realizmi magjik*. Në veprat letrare të shkrimtarëve të kësaj gjenerate, në mënyrën më të përsosur të mundshme, kombinohet realiteti me fantazinë. Për romanin "Pedro Páramo" Horhe Luis Borhes thotë se është një ndër romanet më të mirë të letërsisë hispanike, me të cilin autori u fut në radhën e shkrimtarëve të mëdhenj të kësaj letërsie. Ndërsa nobelisti Garsia Markes për këtë roman ka thënë: "Në qoftë se unë do të kisha shkruar një roman si ky, nuk do të shkruaja më kurrë në jetën time." Dhe vërtet e çuditërisht Huan Rulfo nuk shkroi më. Pas botimit të këtij romani ai pothuaj e braktisi letërsinë, duke punuar në një kanal televiziv dhe duke u kthyer kështu në një mit letrar, me heshtjen e tij.


Kanë kaluar plot 60 vjet nga dalja në dritë e romanit *Pedro Paramo* dhe përgjatë kësaj periudhe më se gjysmëshekullore kjo vepër letrare nuk ka pushuar së qeni një ikonë e vërtetë për shkrimtarët, për prirjet, për epokat dhe stilet e ndryshme letrare. *Pedro Paramo* vazhdon të jetë një libër i pashtershëm për studime dhe analiza të posmodernitetit. Ja ç'shkruan Markesi i madh për mrekullinë që ndjeu, kur lexoi veprën e Rulfos:

«Shkrimtari dhe miku im Alvaro Mutis, me hapa të gjatë, ngjiti të shtatë katet e pallatit tim, me një pako librash në dorë, prej nga nxori librin më të vogël dhe, duke u shkrirë në gaz, më tha: "Dreqi ta marrë, lexoje këtë mashtrues, nëse do të mësosh!". Ishte "Pedro Paramo".

Atë natë nuk vura gjumë në sy, derisa e mbarova së lexuari për të dytën herë; qysh nga nata e tmerrshme kur, nja dhjetë vjet të shkuara, kisha lexuar "Metamorfozën" e Kafkës, në një bujtinë të kobshme studentësh të Bogotasë, kurrë nuk kisha përjetuar një tronditje të ngjashme. Të nesërmen lexova vëllimin me tregime "Rrafshina në flakë" dhe u çmerita njëlloj. Shumë më vonë, në paradhomën e një konsultoreje, në një revistë mjekësore, gjeta tregimin kryevepër të Rulfos "Trashëgimia e Matilda Arkanhelit". Pjesën tjetër të atij viti nuk munda të lexoj asnjë autor tjetër, sepse të gjithë më dukeshin kot.

Ende nuk më qe fashitur trandja, kur dikush i tha Karlos Velos¹ se unë qenqesha i aftë t'i recitoja përmendsh paragrafë të tërë nga "Pedro Paramo". E vërteta ishte edhe më: mund të recitoja komplet librin nga fillimi në fund dhe anasjelltas, pa ndonjë gabim të ndjeshëm, madje, mund të thosha se në cilën faqe të botimit që kisha

1 Karlos Velo (Carlos Velo 1909 - 1988) - kineast spanjoll i mërguar në Meksikë pas Luftës Civile në Spanjë



unë gjendej çdo episod dhe nuk kishte tipar të karakterit të secilit personazh që të mos e njihje në thellësi.»

Siç u tha më lart, e gjithë vepra letrare e Rulfos nuk i kapërcen 300 faqe, ndërsa komentet, analizat dhe mbresat për të janë mijëra faqe.

Serhio Lopes Mena (Sergio López Mena) vë re te tregimet e Rulfos një teknikë të re rrëfimi dhe një sërë procedimesh të reja si “pakësimi apo eliminimi i tregimtarit të gjithëdijsëm, mungesa e veprimit udhëzues dhe e retorikës libeske, prodhimi apo përpunimi i diskurseve nga perspektiva e personazhit, rrjedha e vetëdijes së protagonistit, ndryshimi i sekuencave në rendin logjik, mbivendosja e planeve narrativë, dialogu, monologu i brendshëm” dhe pohon se “me përdorimin e kësaj teknike, e shfaqur tashmë në veprën e shkrimtarëve amerikanoveriorë dhe atyre europianë, Rulfo tërhoqi vëmendjen rreth nevojës për të aktualizuar narracionin meksikan”.

Huan Rulfo arriti një dimension të ri në narracionin meksikan me këto teknika të reja rrëfimi. Ai rinovoi teknikat narrative të traditës meksikane, duke përdorur mjete të reja si strukturat jo të vijueshme dhe duke thyer apo zëvendësuar kohën dhe hapësirën; përdori një rrëfyes në vetën e parë, duke e vendosur atë në këndvështrime të ndryshme narrative dhe duke përdorur me mjeshtëri monologët e brendshëm. Dhe mu për shkak të braktisjes apo kapërcimit të kësaj norme tradicionale, vepra e tij shqetësoi kritikët, të cilët, në vitet e para, do të kërkonin te proza rulfiane një realitet ëndrrë apo magjie, mrekullie apo fantazie. Por, mbi të gjitha, ata i shqetësoi struktura e romanit të tij, sepse qenë mësuar me një zhvillim të paracaktuar, me një stil të njohur, ku gjithçka shkonte vaj, në një sekuencë logjike, me kohët e foljes në të shkuarën, në të tashmen apo në të ardhmen, me hapësira të përcaktuara qartë.

Por, më vonë, pas këtij “kompozimi të çrregullt” u zbulua një strukturë e ekuilibruar, një kompozim i hollë dhe një rregull i vërtetë brenda atij çrregulli në dukje, që e bëjnë *Pedro Paramon* një nga romanet më tërheqës. Endja midis realizmit dhe magjisë së mitikes bëri të ketë komente interesante për stilin e veçantë dhe për atë mënyrë të shkruari që e dallojnë romanin e Rulfos në historinë e letërsisë. Vlen të theksohet se stili i Rulfos mbështetet te gjuha popullore, më saktë tek e folmja e fshatarëve të Haliskos, një nga shtetet më rurale të Meksikës, e folme që, sipas studiuesve të veprës së Rulfos, është shumë e kursyer dhe tejet e përpiktë, me fraza të shkurtra dhe plot epitete. Pra, një gjuhë shumë shprehëse. Këtë gjuhë të dialogut të përditshëm popullor Rulfo e përpunoi me kujdes, duke e pasuruar estetikisht e duke ia përshtatur stilit të tij.

Ja, ç’thotë lidhur me këtë Alfonso Reyes (Alfonso Reyes):

«Mund të konsiderohet realist romani i *Rulfos* për përshkrimin e një epoke historike, por sigurisht vlera e tij qëndron te mënyra e veçantë me të cilën autori diti ta përdorë këtë histori, ku narracioni i vendosur mbi plane të ndryshme kohore merr një vlerë të veçantë që intensifikon vetë natyrën e fakteve. Do të ishte nevoja që, për një vlerësim të saktë të veprës së *Rulfos*, duhet të studiohej stili që ka arritur të përdorë ky shkrimtar, në një mënyrë aq të shkathët, te romani i tij i mrekullueshëm “*Pedro Paramo*”»


Pedro Paramo hynë në kategorinë e së çuditshmes, është puro magji, e shprehur me një gjuhë poetike dhe simbolike. Dy realitetet, ai i të gjallëve dhe ai i të vdekurve janë përzier aq mjeshtërisht sa është vështirë ta gjesh kufirin midis tyre. Por, me sa duket, kështu ndodh në mendësinë e një popullsie rurale dhe religjioze, ku autori ka vendosur ngjarjet:

“Është e vërtetë *Dorotea - do të rrëfëhet ai -, më vranë murmurimat*”.

«Të kuptuarit e kësaj të vërtete të përtej varrit është sikur mbi ne të binte papritur një kërcënim: njësoj si Huan Preciadoja edhe ne, papritur, do të fillojmë të dëgjojmë zëra, rënkime, fragmente këngësh apo vajesh

“Shamia që më dha e dashura me lot ishte lagur”,

Jehe betejash dhe dashurish të fshehta, mesazhe dhe paralajmërime që vijnë nga asgjëja, duke na trullësuar veshët e duke na treguar se edhe shuarja jonë



po afron. Ashtu si edhe udhërrëfyesja jonë, edhe ne fillojmë të besojmë se shpirtat e të vdekurve janë aty, pranë nesh, duke folur me ne.», thotë Horhe Volpi, në prologun e një botimi të *Pedro Paramos*.

Autori e vendos personazhin rrëfyes, Huan Preciadon, në kufijtë e vdekjes dhe, nëpërmjet tij, vetvetiu edhe lexuesi vendoset në ata kufij. Kjo është një mjeshtëri e shkrimtarit për të kuptuar personazhet e tij dhe historitë e tyre. Ndryshe, ne nuk do ta kuptonim dot Pedro Páramon dhe karakterin e çuditshëm të tij, torturën e tij të brendshme dhe përçmimin e tij për të tjerët. Në mënyrën më të magjishme, autori na merr për dore e na shpie në ato realitete, ku ne mund t'i kuptojmë personazhet e të përjetojmë ndeshtrashat e tyre. Kësisoj, edhe pse Pedro Paramo ishte një mujshar i vërtetë, lexuesi arrin ta përjetojë dhimbjen e tij për vdekjen e Suzana San Huanit, së vetmes grua që kishte dashur në jetë. Po ashtu, lexuesi, falë mjeshtërisë së autorit, do të futet lehtë në botën e brendshme të kësaj gruaje vizionare, gati të çmendur, dhe do ta kuptojë se ajo është një bartëse e pafajshme fatkeqësie, thua se vjen nga soji i Helenës së Trojës, duke përshkuar tërë historinë e letërsisë, derisa mbërrin te personazhet e

shquar e të dalë mendsh të Folknerit.

Pra, Rulfo dallohet nga shkrimtarët e tjerë për mënyrën e tij të veçantë të të rrëfyerit, sepse personazhet e tij jo vetëm rrëfejnë, por flasin nga brenda dhe lexuesi, realisht, dëgjon zërat e tyre.

Ja ç’thotë José Manuel Kavajero (José Manuel Cavallero):

«Te romani i Rulfos planet narrative mbivendosen e ndërthuren, derisa formojnë një lëmsh të ngjeshur me tregues tematikë. Kufiri midis së mbinatyrshmes dhe së natyrshmes, midis së trilluarës dhe së besueshmes, bëhet gati i pakapshëm.»

Duke mos dashur kurrsesi të analizoj e të komentoj veprën letrare të Huan Rulfos, sepse, sinqerisht, as që do të mundja ta bëj dot, po e lë lexuesin ta shijojë artin e tij magjik.

Dhe, së fundi, nuk mund të rri pa falënderuar redaktorët Arlind Novi e Ataol Kaso, të cilët, me kulturën dhe shijet e tyre të holla letrare, duke e krahasuar përkthimin tim me përkthime në gjuhë të tjera, bënë vërejtje e sugjerime që më ndihmuan për ta pasuruar edhe më mirë përkthimin tim prej origjinalit spanjisht.

Aktori më i madh e dikur më i inatosur i brezit të tij, tashmë është edhe piktor, kompozitor, shkrimtar dhe hero i Instagram-it. Ai tregon se si temperamenti i tij evoluoi për t'u bërë i butë.

ANTHONY HOPKINS:

‘Veproni sikur është e pamundur të dështoni’

Çdokush që e ka ndjekur Anthony Hopkins-in në Instagram kohët e fundit, është gostitur me një pamje nga afër të anëve të shumta të tij. Kemi Hopkins-in emocional që luan në piano për macen e tij Niblo, në vilën në Malibu; Hopkins-in qesharak që bën kërcimin e këngëtarit Drake në rrjetin social TikTok; imituesin që bën theksin e aktorëve Sly Stallone dhe Arnold Schwarzenegger; mbajtësin e plot këmishëve Hawaiiane me natyrë e shumëngjyrëshe.

Por, ndoshta më shpesh nga të gjithë këto ka qenë Hopkins-i frymëzues dhe filozofik – i cili i bën thirrje brezit të ri sot se, pavarësisht gjithçkaje që po ndodh për momentin, ata mund t'i realizojnë ëndrrat e tyre (në korrik ai postoi këtë gjë: “Urime të diplomuarve të vitit 2020... Kam lexuar diku, nuk e mbaj mend nëse ka qenë Testamenti i Vjetër, ose mendoj ka qenë një shaman, dhe ky shaman tha – kishte thatësi, bagëtitë po ngordhnin, njerëzit po vdisnin në shkretëtirë – dhe shamani tha, ndërtoni digat... Ndërtoni digat dhe shiu do të bjerë”).

Kanë kaluar shumë dekada qëkur Hopkins, i cili tani është 82 vjeç, hoqi dorë nga pirja e shpeshtë e alkoolit dhe nga shkaktimi i telasheve, por ai është sërish një individ enigmatik, e rreziku i ndryshimit të papritur të temperamentit, qëndron ende. Ky rrezik ka qenë esenca e tij si aktor – nuk e dije kurrë se çfarë apo kush do të vinte më pas, qoftë nëse po luante Mbretin Lir në skenën e Teatrit Kombëtar apo po fitonte një çmim Oscar për portretizimin e tij të Hannibal Lecter-it, vrasësit serial në filmin Heshtja e qengjave. Në vitin 1973 ai u largua në mes të produksionit të Makbethit; dy vite më pas piu gotën e fundit. Nga ajo kohë ai është kthyer në një nga yjet më prodhimtarë të Hollywood-it, duke u bërë kandidat edhe për katër çmime të tjerë Oscar për filmat Dita e mbetur, Nikson, Amistad, dhe këtë vit, Dy Papat. Jeta e tij mund të kishte qenë një

histori e talentit të shpërdoruar, por është një histori shëlbimi. Dhe është padyshim shtetari i mençur e i vjetër në moshë me zërin e ëmbël nga Uellsin jugor që më flet prej Malibusë, jo antiheroi me pëshpërimën kërcënuese ose zërin çjerrës.

Ai më tregon çdo gjë për postimin motivues. “Ai postimi për të diplomuarit e vitit 2020, po mendoja se sa shkatërruese mund të jetë për një brez të tërë të rinjsh që sapo dalin në jetë, e papritmas pedagogu i tyre nuk është më. E kam fjalën, çdo të ndodhë? Prej kësaj më erdhi ideja, sepse unë në jetë kam besuar dhe kam përfytyruar një rezultat të fuqishëm. Veproni sikur gjithçka është e mundur. Veproni sikur besoj. Edhe nëse, ndonjëherë, gjithmonë ka dyshime, por kur këto dyshime vijnë, unë i mposht dhe besoj se do të funksionojë. Veproni sikur është e pamundur të dështoni”.

Në të shkuarën ai ka thënë që nuk është i sigurt se në çfarë beson nga njëra ditë në tjetrën (“Zoti, Santa Claus, apo zana Tringëllimë”). Sot, ai duket se ka mbërritur në përfundimin se çfarëdo force që ekziston, vjen së brendshmi. “Kam mbijetuar gjithë këto vite, e pavarësisht dyshimeve apo të kaluarës sime, habitem vazhdimisht dhe mendoj se ka të bëjë me – këto janë fjalë të fuqishme – besimin në një lloj energjie që zotërojmë brenda vetes. Unë nuk jam psikiatër, nuk jam filozof, asgjë prej këtyre, por... është diçka që ndoshta e kam shfrytëzuar kur isha i vogël. Dhe jam i bindur se mund ta bëjnë edhe fëmijët e sotëm. Besoni në të, besoni dhe shiheni veten tuaj brenda një së ardhmeje të fuqishme”.

Shqetësimi i tij për brezin e ri ka rezultuar në një projekt disi të papërshtatshëm (për ata nga ne që nuk na hiqet nga mendja figura e Hannibal Lecter-it që ha mëlçi), por sidoqoftë të admirueshëm. Ai po nxjerr qirinj e difuzorë aromatikë, dhe një parfum

Anthony Hopkins (i frymëzuar nga aromat e fshatit të fëmijërisë së tij në Margam, pranë qytetit Port Talbot në Uellsin jugor), në mbështetje të fushatës Asnjë Fëmijë i Uritur, të nisur nga shoqata bamirëse Share Our Strength. “Kishim rreth një vit që punonim me të e më pas karantina ndryshoi rrjedhën e jetës, duke na sjellë nëpër mend vështirësitë e mëdha që kanë prekur familjet në të gjithë botën, veçanërisht fëmijët që nuk shkojnë dot në shkollë. Është diçka shkatërruese kjo që ka ndodhur dhe gjithçka që mund të bëjë është të ofroj një vizion pozitiviteti që njerëzit mund ta kapërcejnë këtë”.


Paketimi do të përfshijë pikturat e Hopkins-it, sepse përveçse është një nga aktorët më punëtorë të Hollywood-it, ai është edhe një piktor disi i njohur, për të mos përmendur edhe kompozitor, veprat e të cilit janë regjistruar dhe luajtur në skenë nga Orkestra Simfonike e Birmingham-it. Ashtu si Richard Attenborough, ai mund të jetë aktori më i mirë i brezit të tij, por mesa duket në mendjen e Hopkins-it të ri, dalja në skenë si aktor ishte diçka dytësore.

Muzika ishte dashuria e tij e parë dhe kur ishte fëmijë, improvizonte në piano. “Doja të bëhesha pianist”, thotë ai, “dhe krejt rastësisht u bëra aktor”. Atij gjithashtu i pëlqente të vizatonte kur ishte fëmijë, dhe mendonte të bëhej karikaturist. Megjithatë jo për shumë kohë. “Takova një burrë që punonte te gazeta e përditshme Western Mail, i cili ishte vetë artist e karikaturist, dhe më tha, ‘Ah, kërkon zotësi të madhe’, ndaj hoqa dorë nga kjo ide...”

Iu desh një gjysmë shekulli që të merrej sërish me pikturë, i nxitur prej gruas së tretë, Stella Arroyave-s, e cila kishte parë shkarravinat që ai bënte mbi skriptet e filmave. “Ajo është burimi i energjisë”, thotë ai. “Pa vizatimet e mia dhe më tha ‘Ti duhet të pikturosh – thjesht bëje’. E njëjta gjë me muzikën. Më dëgjoi teksa luaja një pjesë muzikore dhe tha, ‘Çfarë është kjo?’ Unë ia ktheva, ‘Nuk e di, thjesht diçka që e krijova qindra vite më parë. Dhe ajo më tha, ‘Epo, duhet të bësh diçka me të’. Ndaj e përshtata për orkestër dhe ajo ia dërgoi dorëshkrimin André Rieu-së. Ai e luajti e unë nisa të kompozoj më shumë”.

Shumë nga pikturat e tij janë vepra ekspresioniste që të trazojnë, në të cilat sytë e ngulët kanë një zjarr Hopkins-eshk që vjen nga thellësitë e kanavacës. Një vorbull ngjyrash neoni, boja e përhapur gjithandej si një pastë e trashë. Janë edhe peizazhet, disa prej tyre Hopper-eske, të tjera më impresioniste. “Nuk jam i mirë në ndjekjen e udhëzimeve dhe nuk mund të ulesha në lëndën e artit e të vizatoja një mollë”, thotë ai. “Në fillim mendoja, ‘Nuk mund të pikturoj’. Megjithatë një zë tjetër më tha, ‘Epo, provoje njëherë, askush nuk do të fusë në burg nëse nuk funksionon”.

Njëra pikturë, Ballo në hënë, përmban kafshë të egra, përfshi një elefant rozë me qerpikë flirtues, të mbështjella rreth kokës së një burri të vjetër në moshë, ndoshta një referencë kjo kur shkoi me gjyshin e tij në cirkun e Port Talbot-it, në vitin 1947. Është një moment i cili shfaqet në një nga kompozimet e tij muzikore, dhe fëmijëria në një familje të klasës punëtore në Margam paraqitet vazhdimisht si frymëzim në veprat e tij. Ai ishte fëmijë i vetëm, djali i një bukëpjekësi. Babai ishte një burrë i rreptë që e mësoi të qëndronte me këmbë në tokë. Ndërsa mamaja i nixti anën muzikore, duke i blerë një piano të vogël për £5. Një nga pikturat e tij tregon dy punëtorë të çelikut, kokat e tyre ovale të ngjashme me ato të piktorit Munch, duke ecur krah për krah, teksa kontrasti baritor i këtij peizazhi industrial shfaqet në



një kompozim orkestral paksa nostalgjik, të quajtur thjesht Margam. “Jam përditë i vetëdijshëm për të shkuarën time”, thotë Hopkins. “Një pjesë të mirë të kohës ëndërroj sikur jam kthyer atje. Qëndrova pak kohë vitin e kaluar për realizimin e një dokumentari mbi jetesën time në Uells, dhe e çova nëpër mend kthimin aty”.

Do të ishte një rrugëtim i gjatë pas deri te momenti kur, të paktën në shkollë, ai nuk ishte i lumtur; shumë nga problemet që e shqetësonin kur ishte i ri, ai i lidh me këtë kohë. “Nuk kam qenë dhe aq i zgjuar kur isha në shkollë”, thotë ai. “Më shihnin si fëmijë i mbrapshtë dhe, sigurisht, në moshën e adoleshencës, ndihesha tejet i zemëruar e i hutuar, dhe nuk dija se ç’rrugë të zgjidhja. Më dukej sikur nuk kisha asnjë shpresë. Dhe mbaj mend që i thashë babait, ‘Një ditë ke për ta parë’. Më kujtohet, kanë qenë Pashkët e vitit 1955, dhe ia thashë me bindje të plotë babait, i cili në fakt më inkurajonte gjithnjë. Ia thashë sepse notat i kisha shumë të këqija. ‘Një ditë’, thashë, ‘ke për ta parë’. Dhe më kujtohet që nga fundi i atij viti fitova një bursë te Kolegji i Muzikës & Dramës i Uellsit Mbretëror, e brenda 10 viteve në jetën time ndodhën gjëra të jashtëzakonshme. Ende kthej kokën pas dhe pyes veten se si ndodhën. Mendoj se erdhën prej atij momenti të rëndësishëm”.

Sigurisht, gjatë rrugës ka hasur edhe në vështirësi. Ai tregon një histori kur në vitin 1960 udhëtoi nga Uells drejt teatrit Old Vic për një provë, dhe regjisori i tha, “Ah, a e di, ndoshta një ditë, por nuk mendoj se e ke aftësinë tani”. Njëzet vite më pas, i njëjti regjisor erdhi në dhomën e zhveshjes së Hopkins-it kur ky i fundit po luante rolin e një manjati të tmerrshëm gazete në Teatrin Kombëtar, në dramën me titull Pravda të dramaturgut David Hare, dhe i kërkoi falje. “Kështu qenka jeta”, thotë Hopkins me moskokëçarje.

Në vitin 1965, ai u ftua prej Laurence Olivier-it që t’i bashkohej Teatrit Kombëtar. I ri e ambicioz siç ishte, ai u bë shpejt qendra e vëmendjes. Në autobiografinë e tij, Olivier mban mend që ia dorëzoi Hopkins-it rolin e Edgar-it në dramën Kërcimi i vdekjes të dramaturgut Strindberg, sepse ishte me apendicit: “Një aktor i ri në moshë në teatër me perspektivë të shkëlqyer, i quajtur Anthony Hopkins, më dubloi dhe mori rolin e Edgar-it si një mace që ka miun midis dhëmbëve”.

Hopkins kujton atë periudhë dhe më pas punën me David Hare-n për dramën Pravda në Teatrin Kombëtar në vitin 1986, si dy momentet më të lumtura në teatër. Megjithatë, mesi i viteve ’80 shënoi edhe fundin e tij si aktor skenik. Performanca e fundit u realizua në vitin 1986, ku luajti Mbretin Lir me regjisorin Hare. Po trokiste Hollywood-i. Peter Hall, drejtori i atëhershëm i Teatrit Kombëtar, thotë me keqardhje, “Ky ishte Shekspiri i fundit i Tony-t, dhe është trishtim që mbaroi aty”.

A pendohet ai që u largua nga teatri? “Thjesht ndjeva se nuk po e përballoja dot. Nuk e bëja dot aktin. Dua të them, nuk isha shumë social. Mendoja, ‘Ende nuk përshtatem’. Më pas rrethanat ndryshuan, mbërrita në Amerikë, luajta te filmi Heshtja e qengjave dhe kjo ma ndryshoi disi drejtimin, e mendova me vete, “Ndoshta duhet të vazhdoj këtë”.

A do ta merrte ndonjëherë parasysh mundësinë e kthimit në skenë? “Pesë vite më parë kam punuar me aktorin Ian McKellen për filmin Kostumisti. E admiroj atë, Juli Dench-in dhe të gjithë ata që e kanë këtë këmbëngulje, këtë ambicie për t’u ngjitur në skenë. Unë, për fat të keq... ndoshta jam tepër nervoz për ta ekspozuar atë anë të vetes sime. Nuk mendoj se e kam fuqinë për të qëndruar, nuk mendoj se e kam karakterin që të përsëris të njëjtën gjë çdo mbrëmje. Jo, nuk kam asnjë dëshirë që të kthehem. Vetëm nëse ka një ofertë të jashtëzakonshme – dhe do të më duhej të mendohesha dy herë”.

Njëherë David Hare i tha Hopkins-it se ishte personi më i zemëruar që kishte takuar ndonjëherë. Dhe në një dokumentar të emisionit Southbank në kohën kur ai dhe Hopkins po punonin për Mbretin Lir në vitin 1986, Hopkins tha, “Tërbimi i Lirit është kaq shpërthyes... e zbulon të gjithin... Unë e kam atë tërbim”. Nga i ka ardhur ky tërbim i brendshëm dhe si ka mësuar ta kontrollojë?

“Mendoj se kishte të bënte me... kohën e fëmijërisë, kur isha i paqëndrueshëm, që nuk përshtatesha... Nuk



ishte një tërbim shpërthyes apo ndonjë zemërim i tillë. Ishte thjesht energji... Unë thjesht e quaja energji, një energji e mospërshtatjes. Nuk mund ta shpërdorosh të gjithë kohën duke u ndier i tërbuar vazhdimisht, sepse jeta është tepër e shkurtër dhe ka për të dëmtuar. Ndaj unë kam qenë thjesht me fat që mbijetova gjithë këto vite dhe po, kam jetuar dy jetë... Ndonjëherë kujtoj jetën time përpara 40 vitesh dhe mendoj, Zot, sa problematik kam qenë. Nuk ndihem krenar për të shkuarën time. Nuk do ta shmangja dot, e tillë ka qenë për mua. Por nuk jam krenar për gjërat që kam bërë. Kam shkaktuar ca dëme. Dy njerëz me të cilët punoja ndërruan jetë, i dhanë fund sepse shkatërruan jetën e tyre. Jo, edhe unë atë rrugë kisha marrë dhe mendova, ‘Falë Zotit që shpëtova prej saj’. Unë nuk jam evangjelist. Nuk jam as predikues. Jam i lumtur që shpëtova prej atij makthi sepse nuk ishte i këndshëm. Nuk isha shumë i sjellshëm, por një njeri vërtet i shëmtuar. Ndaj përgjatë viteve mendova me vete, ‘Qetësohu, qetësohu’. Jam thjesht me shumë fat që jam gjallë”.

Ai thotë se rreziku i marrjes së virusit Covid-19 e ka detyruar të refuzojë rolin në një film me Kenneth Branagh-in (“një nga aktorët e mi të preferuar”). Megjithatë ai është ende i entuziazmuar pasi u shpall kandidat për aktorin më të mirë suportues të çmimit Oscar, për filmin Dy Papat, ndërsa gruaja e tij e ka caktuar aktor në një film që ajo e ka shkruar vetë dhe është regjisore, të titulluar Elyse (transmetohet nga

data 4 dhjetor), ku Hopkins luan rolin e një psikiatri që ndihmon një grua të re në moshë, e cila pëson një krizë mendore. Gjithashtu, në dhjetor del edhe filmi i dramës së mirënjohur të Florian Zeller-it, Babai, në të cilin Hopkins është një burrë që po zhytet në çmendi. Pas Festivalit të Filmit Sundance më herët këtë vit, revista Vanity Fair e përshkroi si “një pjesë e shkëlqyer aktrimit, që është aq e saktë dhe këmbëngulëse teksa shpaloset. Të kujton përse Hopkins gëzon këtë status të nderuar që e ka pasur prej kaq kohësh”.

Vetë Hopkins thotë, “Është një nga filmat më të mirë ku jam përfshirë. Pesë vitet e fundit kanë qenë të mrekullueshme për mua, pasi kam punuar me Richard Eyre-in, Ian McKellen-in, Emma Thompson-in, dhe tani ky me Olivia Colman-in. Një periudhë vërtet e jashtëzakonshme”.

E kështu vazhdon, duke u përgatitur me rigorozitet për pjesët e aktrimit, duke pikturuar, duke luajtur në piano, duke shkruar skriptin e një filmi që zhvillohet në Uells, duke u dhënë strehë maceve dhe qenve, e duke veshur këmisha Hawaiian-e me vetëbesim (vijne nga një dyqan në Hawaii që quhet Jams World) – një përzierje e ndërlikuar e mençurisë dhe e një djaloshi serioz të klasës punëtore nga Port Talbot. “Vazhdo të buzëqeshësh, vazhdo të qeshësh, kjo është gjithçka që mund të bësh”, thotë ai, teksa mbyllim intervistën.

Përktheu David Hudhri

Natak

poezi nga

RICHARD DESJARDINS

Pajisi me shënime dhe e përktheu nga frëngjishtja FLURANS ILIA

Natak në gjuhën Inuït, Inuktituk, përkthehet “i pa strehë”. Richard Desjardins ka jetuar në Nunavik, pjesa veriore arktike kanadeze ku ka dhënë mësim, është frymëzuar nga jeta e banorëve të atyshëm. Ai shpjegon diku se, njerëzit e parë në Amerikë, binjakët e autoktonëve të sotëm, duhet të kenë ardhur nga ngushtica e Beringut, midis Siberisë dhe Alaskës, rreth dyzet mijë vjet më parë. Këta eksploratorë të parë primitiv pyesin veten në atë çast vendimtar, përball ngushticës që lidh dy kontinente, duhet të kthehemi dhe ripërballemi me të këqijat tona të deritanishme apo duhet të riskojmë dhe përpiqemi të kapërcejmë nga njëri breg në tjetrin? Është ky çast kur gruaja i flet burrit të saj pikërisht ndanë brigjeve të Beringut. Në fakt është një lutje në gjuhën Inuktituk, ...dhe burri quhet Natak.

Natak

Ti, ti je bash ai diell që yjet i verbon
Kur vdekjes i flet kaq e ëmbël dhimbja e saj
Për me gjet fushqetën dhe gjuajtur bishën
Për me gjet strehën zot mbi zota ti je imzot
Natak

Nuk mund ta ëndërroj jetën pa ty
Mbart kujtesën e ujrave ku jam kredhur
Tash kur ti jeton, ëndërroj ndërkohë
Gjithë qenia ime lutet pas nesh të jesh
Natak

Nuk dua të vdes mbi këtë gurajë që pata për fat
Nën shikimin e të tjerëve, dhunuar nga zotat
Nuk ka lule kjo tokë për të hedhur mbi trupin tim
E kush do i bjerë tamburëve të lamtumirës?

Do të të ndjek thellëtirave në vidhimë
Por dua tokë, o Natak, më dëgjon!
Në mundsh në do, nëse jeta na do
Do jemi bashkë gjer në çastin e fundit

Por kaq e shqetësuar jam, drita vonon
Çdo ditë e më shumë, heshtja jote më shtyp
Hapi sytë e shiko se si ujqërit na vështrojnë
Kanë zgjedhur çastin e duhur, viktimën

Dhe ja çfarë i shpëton këtij qielli të ngrysur
Psherëtima e demonit mbytur në psherëtima
Zëri! dridhet nga frika dhe gishtat i janë nxirë
Ndërkohë që të dua, ai bëzan vdekjen

Nëse vdekja shuan e kthen në zero botën
I sigurt qofsh nuk vjen veç për të, ajo
Kërkon numrin në duhet të fshehim plagët

O Natak i dashur, zemra ime ka kuptuar
Se unë vdes për të vdekur në këtë vend fatal
Po, të humbur si hiçi në rrathët e një trungu
Po, ne jemi të humbur por ende të gjallë

Hapi sytë dhe shih këtë re me zogj
Mësyjnë nga ky det i panjohur, ikin ku?
Po të them se atje tej ka bregore me lule
Eja ti shohim, ishullin po imagjinoj

Ku dita ngrihet, më ushqen dhe shtrihet
Mbi pupla të shejta dhe shpella të sigurta
Ku të ketë ujë të ngrohtë si goja jote
Kur vë në gjumë vajzën dhe i mbyll plagën

Nën shejzën e zërit tënd, mblidhen shigjetat

Kopetë e bizonëve ndjellin thërrasin flijimet
Kur hëna të shndrisë në depo të ushqimit
Dallgë frutash do dhurojë për ti dhënë jetë birit

Fati yt është i imi, nuk kemi për të ngrënë më
Do hapim shtigje shpëtimtarë në gjë të savanës
Ku do ndezësh lakuriq dëshirën time më të thellë
Që i thëret kënaqësisë tënde, ajo ma shtyp zemrën


E si për mrekulli lutjet tona sikur të plotësohen
Të qetësojnë zotat e çmendur fashisin dhimbjen
Nuk pranoj asnjë prej tyre të më marrë prej teje
Atje ku robi qahet prej dheut dhe ha rrënjë

Nuk kthehem në vende të shkelura e di
Nën ligjet e luftëtarëve që zhveshin shkorret
Kujtesë e djegur me një pishtar në dorë je ti
Po qe se duhet të kthehem, do kthehem në det

Jam e re, Natak, si një drenush në ag
Jeta kërkon nga unë dhe do që ti të vish
Të ëndërrojmë zërat, të dëgjojmë përlutjen
Ti lidhim rremat në veshkat e balenave

Do jemi të parët që do shijojmë bajamet, eja
Kapërcejmë, me vete në bohçe dëshirën e fatit
Më duaj! Më ndihmo! Tretet barku im i tharë
E ngopur jam, Natak, më duhet pak zjarr

Richard Desjardins është lindur në Rouyn-Noranda (Abitibi-Temiscamingue) më 16 mars 1948. Kalon fëmijërinë në një familje të përbërë nga pesë femijë. Në një rrajon të njohur si një nga minierat më të mëdha në Amerikën e Veriut. Në një vend ku varfëria, inflacioni, papunësia dhe ndotja e ambientit, tundon qenien njerëzore sa herë që mbyllen vendet e punës. Ajo çka mban gjallë shpirtin poetik të djaloshit, është nëna e tij që do ti jepte edukimin e parë në muzikë me mësimin e pianos. Adoleshen, Desjardins nisat në udhën e vet boheme si pianist, poet, kompozitor dhe interpret, rapsod folk, si edhe dokumentarist. Skenarist, produktor dhe realizator, filmat dokumentar, Mizë në flakë (1982), Gabimi Boreal (1999), Populli i padukshëm (2007), Histori e vërtetë (2010), Richard Desjardins ngre zërin mbi padrejtësitë, shfrytëzimin, të drejtat e autoktonëve dhe shfarrosjen e resurseve natyrore të vendit të tij.



A ka patur një armiqësi letrare William Faulkner - Ernest Hemingway?

Haley Bracken

Në Prill 1947 Uiljam Folkneri u ftua në Universitetin e Misisipit. Gjatë një seance me pyetje dhe përgjigje në një orë të shkrimit krijues, Folknerit iu kërkua të përcaktojë “pesë shkrimtarët më të rëndësishëm bashkëkohorë”. Ai renditi (sipas radhës) romancierët amerikanë Tomas Vulf, (Thomas Wolfe) Xhon Dos Pasos, Ernest Heminguej, Uilla Kather dhe Xhon Stajnbek. Kur iu kërkua të rendiste veten midis bashkëkohësve të tij, Folkneri u përgjigj:

1. Tomas Vulf: ishte shumë i guximshëm dhe shkruante sikur s’kishte kohë të mjaftueshme për të jetuar;

2. Uiljam Faulkner;

3. Dos Pasos;

4. Ernest Heminguej: ai s’ka guxim, s’ka rrezikuar kurrë të dalë kundër rrymës. Nuk njihet nga ata autorë që përdor një fjalë për të cilën lexuesi detyrohet të marrë fjalorin për ta parë nëse është përdorur si duhet;

5. Xhon Stajnbek: dikur kam pasur shumë shpresë tek ai - tani s’e di.

Tërheq vëmendjen fakti se Folkneri e vendosi veten të parin midis shkrimtarëve të gjallë. Në kohën e renditjes së këtyre shkrimtarëve, Vulf kishte vdekur para gati nëntë vjetësh. Përgjigjet e Folknerit u mbajtën shënim dhe u botuan. Marvin Black, drejtori i marrëdhënieve me publikun për Universitetin e Misisipit, bëri publik një njoftim për shtyp duke përmbledhur komentet e Folknerit ku përfshiu edhe mëtimin se Heminguej “s’ka guxim, s’ka rrezikuar kurrë të dalë kundër rrymës”. Njoftimi për shtyp u botua në *Herald Tribune*, në maj 1947.

Është e paqartë nëse Folkneri synonte që komentet e tij të ishin provokuese. (Atij i ishte thënë që studentët s’do të lejoheshin të mbanin shënime dhe se profesorët s’do të ishin të pranishëm gjatë seancës së pyetjeve dhe përgjigjeve.) Pavarësisht, konkurrencës së jashtëzakonshme, Hemingueji s’mund ta linte pa koment. Duke iu përgjigjur një versioni të perifrastuar të komenteve të Folknerit thuhet se u përgjigj: “*Ishkreti Folkner. Vërtet mendon se emocionet e mëdha jepen me fjalë të mëdha? Mendon se s’i di fjalët që s’vlejnë një grosh? Injoh mirë. Por ka fjalë më të vjetra, më të thjeshta dhe më të mira, dhe janë ato që unë përdor.* Ai më tej la të nënkuptohej se Folkneri ishte alkoolik, talenti i të cilit kishte humbur vetëdijen”.



Ky shkëmbim i hidhur komentesh nuk ishte as fillimi dhe as fundi i polemikës Folkner-Heminguej. Marrëdhënia e tyre prej më shumë se tridhjetë vjetësh u karakterizua nga konkurrenca, krahasimi dhe kritikë. Megjithëse e pranuan respektin për njëri-tjetrin, sidoqoftë nguruan në lëvdata. Për pjesën më të madhe të marrëdhënies së tyre, Folkneri dhe Hemingueji s’kanë komunikuar asnjëherë drejtpërdrejt mes tyre. Ka gjasa të jenë takuar vetëm një herë, diku midis 14 nëntorit 1931 dhe 4 korrikut 1952. (Një artikull i *Herald Tribune* botuar më 14 nëntor 1931, këmbëngul se Folkneri s’e kishte takuar kurrë Heminguejn. Rreth 20 vjet më vonë, Hemingueji aludoi për një takim të vetëm me Folknerin.) Autorët bënin komente për njëri-tjetrin tërhorazi përmes shkrimtarëve dhe kritikëve të tjerë. Midis viteve 1945 dhe 1949, Hemingueji e përmendi Folknerin në të paktën tre letra drejtuar historianit letrar Malkolm Kaulli (Malcolm Cowley). Në një letër të datës 17 tetor 1945, Hemingueji linte të nënkuptohej që Folkneri s’kishte disiplinë artistike dhe shprehu dëshirën për ta “stërvitur” Ai shkroi, “[Folkneri] ka talentin më të madh se të gjithë dhe thjesht ka nevojë për një lloj ndërgjegjeje që s’është aty ku duhet... Ai qëllon drejt e në shenjë dhe pastaj vazhdon e vazhdon pa ia gjetur fundin”.

Edhe Folkneri shkroi për Heminguejin. Kur një redaktor me përvojë në shtëpinë botuese *Random House* sugjeroi që Hemingueji të shkruante hyrjen e përmbledhjes me shkrime të zgjedhura “Folkneri për këdo” (The Portable Faulkner), 1946, Folkneri shprehu mosmiratimin e tij. Në një letër drejtuar redaktorit, ai shkroi: “Nuk jam dakord që t’i kërkohet Heminguejit të shkruaj parathënie. Më duket shije të keqe t’i kërkosh të shkruajë një parathënie për gjërat e mia. Është një lloj si t’i kërkosh dikujt në mes të një gare me kuaj të bëj komente për një kalë tjetër në të njëjtën fushë vrapimi”. Në fund, hyrjen e shkroi Kaulli.

Pasi komentet e Folknerit dolën në *Herald Tribune* në maj 1947, autorët shkëmbyen letra të shkrutra. Folkneri sqaroi se s’e kishte vënë në dyshim guximin e Heminguejit si njeri, por vetëm si artist. Ai i rrëfeu “Vëllait H” se komentet “ishin nga ato gjërat e parëndësishme që thuhën pa u menduar shumë kur je duke folur, një ide e mjegullt pa asnjë vlerë, që ti e teston duke e thënë”. Në përgjigjet e veta, Heminguej kërkoi falje për reagimin dhe tregoi se ai do të ishte i hapur për më shumë kritika konstruktive të Folknerit. Megjithëse romani i tij *Për kë bien këmbanat* (1940) “ndoshta do t’ia sillte në majë të hundës duke e detyruar [Faulknerin] ta rilexojë”, Hemingueji do të donte dinte se çfarë mendonte Folkneri për të, “si [një] vëlla”. Ai kërkoi që ata “të vazhdojnë të shkruajnë”.

Folkneri dhe Hemingueji nuk e vazhduan letërkëmbimin. Incidenti i *Herald Tribune* shënoi


fillimin e asaj që ishte periudha më e tensionuar në marrëdhëniet e tyre. Kur Folknerit iu kërkua më 1952 të shkruante një recensë të romanit të “Plaku dhe deti” të Heminguejt, ai nuk pranoi. Megjithatë, kur disa muaj më vonë ai mori të njëjtën kërkesë nga një revistë letrare e universitetit të Uashingtonit, Faulkner u tërhoq, duke e lavdëruar me kujdes romanin në një recensë një paragraf të gjatë që mund ta lexoni këtu:

Më i miri i tij. Koha mund të tregojë se është proza më e mire, unike, ndër të gjithë ne, dua të them ndër bashkëkohësit e tij dhe të mi. Këtë herë, ai zbuloi Zotin, një Krijues. Deri më tani, burrat dhe gratë e tij ishin krijuar vetë, kishin formësuar veten nga balta e tyre; fitoret dhe humbjet ishin në duart e njëri-tjetrit, vetëm për t’i provuar vetes ose tjetrit se sa të ashpër mund të ishin. Por këtë herë, ai shkruajti për mëshirën: për diçka diku që i krijoi të gjithë: për plakun që duhej të kapte peshkun dhe pastaj ta humbte, për peshkun që duhej kapur dhe më pas të ikte, për peshkaqenët që duhej t’ia rrëmbenin plakut peshkun e tij; i krijoi të gjithë, i deshi të gjithë dhe i mëshiroi të gjithë personazhet. Kështu po. Lëvdoni Zotin që gjithçka për çfarë krijoi, dashuroi dhe mëshiroi Hemingueji dhe për atë që e pengoi të mos shtonte dhe as të mos hiqte asgjë.

Nga viti 1947 deri në mesin e viteve 1950, Folkneri dhe Hemingueji u përfshinë në një betejë të fortë për prestigj letrar. Në 1949 Folkneri fitoi çmimin Nobel për Letërsi “për kontributin e tij të fuqishëm dhe unik artistik në romanin modern amerikan”. Hemingueji ndoqi shembullin me një Çmim Nobel të tijin më 1954, për “mjeshtërinë në artin e rrëfimit, shpërfaqur së fundmi te *Plaku dhe Deti*, dhe për ndikimin që ka ushtruar në stilin bashkëkohor”. Në 1953 Hemingueji fitoi një çmim Pulitzer për *Plaku dhe Deti*. Dy vjet më vonë Folkneri u vlerësua me çmimin Pulitzer për romanin *Një Fabul* (1954).

Rivaliteti i tyre vazhdoi deri në vdekjen e Heminguejt më 2 korrik 1961. Folkneri vdiq gati një vit më vonë, më 6 korrik 1962. Mirë apo keq, Folkneri nuk i tërhoqi asnjëherë deklaratat e bëra në Universitetin e Misisipit. Ashtu si i tha Heminguejit, ai u pendua që komentet ishin reklamuar dhe “keq cituar”, por mbrojti idenë se ai vetë ishte shkrimtari më i mirë i gjallë në mesin e shekullit të 20-të.

Përktheu: Granit Zela



Baronesha Karen Christenze von Blixen-Finecke (17 prill 1885 – 7 shtator 1962) ishte një shkrimtare daneze e cila i shkruante veprat e saj në danisht dhe anglisht. Ajo njihet me pseudonimin Isak Dinesen, i përdorur në vendet anglisht-folëse, Tania Blixen, i përdorur në vendet gjermanisht-folëse, Osceola, dhe Pierre Andrézel.



Unaza *tregim nga* ISAK DINESEN

Në një mëngjes veror, njëqind e pesëdhjetë vite më parë, një çifligar i ri danez dhe bashkëshortja e tij dolën për një shëtitje në pronat e tyre. Kishin një javë që ishin martuar. Martesa nuk kishte qenë aspak e lehtë, sepse familja e vajzës ishte e një rangu më të lartë, dhe më e pasur se familja e bashkëshortit. Të dy të rinjtë, njëzetë e katër vjeç dhe nëntëmbëdhjetë vjeçe, kishin ecur drejt këtij objekti që prej dhjetë vitesh; më në fund, prindërit e saj kryelartë kishin lëshuar pe.

Ata ishin mrekullisht të lumtur. Takimet që bëheshin tinëz dhe fshehtas, si edhe letrat e përletura të dashurisë, tashmë i përkisnin së kaluarës. Përballë Zotit dhe njeriut ata ishin një; në mes të ditës mund të ecnin përkrah njëri tjetrit, mund të udhëtonin në të njëjtën karrocë, dhe kështu do të vazhdonin deri në fund të jetës së tyre. Parajsa e tyre e largët kishte zbritur në tokë dhe kishte dëshmuar, çuditërisht, se ishte e mbushur me gjëra të jetës së përditshme: me tallje dhe shpoti, mëngjese e darka, qen, dele dhe shfrytëzime rastesh. Sigismund-i, i shoqi i saj i ri në moshë, vetë kishte premtuar se nga momenti i dasmës, në ecurinë e nuses, nuk do të kishte

asnjë pengesë, dhe se ajo nuk do të përballej me asnjë kërcënim. Lovisa, e shoqja, e ndjente tani se për herë të parë në jetën e saj të re, ajo lëvizte dhe merrte frymë në liri të plotë, sepse ajo kurrë nuk mund të kishte sekrete nga i shoqi. Për Lovisa-n – të cilën i shoqi e thërriste Lise – atmosfera provinciale e jetës së saj të re ishte një çështje mrekullie dhe ngazëllimi. Shqetësimi i të shoqit se ekzistenca që ai i ofronte asaj mund të linte për të dëshiruar e bënte atë të qeshte me gjithë shpirt. Vetëm para pak kohësh ajo kishte luajtur me kukulla; ashtu si tani krihte flokët, mbikëqyrte presën e të linjtave dhe rregullonte lulet, ajo, e përkushtuar, sërish përjetonte momente magjepsëse: pra, gjithçka bëhej seriozisht dhe me kujdes, por edhe me dijeninë se kishte mundësi për zbavitje.

Ishte një mëngjes i bukur korriku. Re të vogla e të mjegullta zhvendoseshin lart në qiell, ajri ishte i mbushur me një aromë të këndshme. Lise kishte veshur një fustan kambriku dhe një kapelë të madhe italiane pre kashte. Ajo dhe i shoqi po ecnin përgjatë një rrugine në mes të parkut; ishte një rruginë që gjarpëronte përmes

livadheve, korijshe të vogla e disa grumbujve pemësh dhe deri tek fusha ku po kullosnin delet. Sigismund-i kishte ndër mend t'ia tregonte së shoqes delet e tij. Kjo ishte arsyeja që ajo nuk e kishte marrë me vete qenushin e saj të bardhë, Bijou, sepse përballë shtjerrave ai do të lehte, më pas do t'i frikësonte, dhe qentë e stanit do t'i shqetësonte. Sigismund-i krenohej me delet e tij; ai kishte mësuar për rritjen e deleve në Mecklenburg e në Angli, dhe kishte sjellë me vete desh Cotswold-i për ta përmirësuar racën daneze të gjësë së gjallë. Gjatë shëtitjes ai i foli Lise-s për mundësitë e mëdha, por edhe për vështirësitë e planit të tij.

Ndërkohë ajo mendonte: 'Sa i zgjuar që është, sa shumë gjëra që di!' dhe në të njëjtën kohë: 'Sa njeri absurd që është, bashkë me delet! Është fëmijë fare! Unë jam njëqind herë me e pjekur se ai.'

Në momentin që ata mbërritën në vathën e dhenve, delmeri Mathias iu dha lajmin e keq se njëri prej shtjerrave anglez kishte ngordhur dhe dy të tjerë ishin sëmurë. Lise vuri re se i shoqi u hidhërua nga lajmi i keq; në kohën që ai pyeste Mathias-in në lidhje me ngjarjen, ajo ia shtrëngonte krahun atij duke qëndruar e heshtur. Dy djem u dërguan për t'i sjellë qengjat e sëmurë, ndërkohë që pronari dhe vartësi diskutonin detajet e ndodhisë. U desh njëfarë kohe. Lise nisi ta kundrojë veten dhe të mendojë për gjëra të tjera. Nga mendimet që i erdhën në kokë, çakërrqejf, dy herë iu mërdhezën faqet goxha, si të ishte një trëndafil i kuq, dhe më pas, dalë ngadalë përflakja iu fashit, ndërkohë që të dy burrat vazhdonin të bisedonin për delet. Pas njëfarë kohe, biseda e tyre ia tërhoqi vëmendjen. Ata kishin filluar të flisnin për një vjedhësh deles.

Gjatë muajve të fundit, ky vjedhës, si një ujk ishte futur në vathët e dhenve në zonën përreth, kishte vrarë dhe hequr zvarrë viktimat si një ujk, dhe si një ujk nuk kishte lënë asnjë gjurmë pas vetes. Tri net më parë, bariu dhe i biri në një vilë të madhe fshati dhjetë milje më larg, e kishin zënë në faj. Vjedhësi, pasi kishte vrarë bariun, kishte lënë pa ndjenja djalin dhe më pas ia kishte mbathur nga sytë këmbët. Disa persona u dërguan në të gjitha anët e zonës për ta kapur, por askush nuk e kishte parë.

Lise donte të mësonte më shumë për këtë ngjarje të tmerrshme, ndaj për t'ia plotësuar dëshirën asaj, ai e tregoi atë edhe një herë tjetër. Në strehën ku mbareshin delet kishte vijuar një përleshje e gjatë dhe në shumë vende, dysHEMEJA prej dheu ishte lagur me gjak. Në përleshje e sipër vjedhësi kishte thyer krahun e majtë; pavarësisht nga kjo, ai kishte mundur ta kapërcente gardhin e lartë me një shtjerrë në shpinë. Mathias shtoi se do dëshironte që, me ndihmën e një cope litari, ta mbyste vrasësin me të dyja duart, ndërsa Lise tundi kokën shumë seriozisht në shenjë aprovimi. Asaj iu kujtua Kësulëkuqja, më pas ndjeu një fërgëllimë gazmore që i përshkoi trupin.

Sigismund-i e kishte mendjen tek qengjat, por ai vetë ishte aq i lumtur, saqë askujt në botë nuk mund t'ia uronte të keqen. Pas një minute ai tha: 'I gjori'

Lise tha: 'Si mund të të vijë keq për një njeri kaq të lig?' Me të vërtetë që gjyshja kishte të drejtë kur tha se ti je një revolucionar që përbën rrezik për shoqërinë! Sjellja ndërmend e gjyshes, si edhe lotët e ditëve të kaluara, e bën që ta harronte historinë e frikshme që sapo kishte dëgjuar.

Djemtë sollën shtjerrat e sëmurë, ndërsa burrat filluan t'i ekzaminojnë me shumë kujdes duke i ngritur ato lart dhe duke u përpjekur t'i bënin që të qëndronin vetë në këmbë; më tej, i shtypën me gishtërinj në pjesë të ndryshme të trupit deri sa të mjerat filluan të rënkojnë. Lise u step nga kjo shfaqje, ndërsa i shoqi vuri re shqetësimin e saj.

'Shkoni në shtëpi, e dashur,' tha ai, 'kjo punë ka për të zgjatur. Ec me hapa të ngadaltë, unë do të kap rrugës.'

Kështu, ajo u zbua nga bashkëshorti për të cilin delet vlenin më shumë se gruaja e vet. Nëse kishte ndonjë eksperiencë që mund të ishte më e këndshme sesa të qëndronte aty me të shoqin me orë të tëra për t'i ekzaminuar delet, ishte pikërisht kjo. Ajo hodhi mbi bar kapelën e madhe verore me fjongot blu dhe i tha të shoqit që ta merrte atë me vete në kthim, ngaqë flladin veror dëshironte ta ndjente mbi ballë e mbi flokë. Ajo eci shumë ngadalë, ashti siç i kishte thënë edhe ai, sepse donte t'i bindej në çdo gjë. Tek ecte ndjehej e lumtur që

ishte krejtësisht vetëm, madje edhe pa Bijou-n. Gjatë gjithë jetës së saj nuk mbante mend që të kishte qenë ndonjëherë vetëm. Peizazhi rreth saj ishte i qetë, ai dukej plot premtime, ishte i gjithi i saj. Bile, dhe dallëndyshtet që çanin ajrin ishin të sajat, sepse ato i përkisnin atij, dhe ai ishte i saj.

Ajo lakoi rrugën anash korijes dhe pas një apo dy minutash kuptoi se ishte larguar aq shumë, saqë askush nga vendi ku ndodheshin delet nuk mund ta shihte më. Çfarë mund të kishte më të bukur për momentin, pyeti veten ajo, sesa të shëtiste në livadhin e blertë plot lule, dalë ngadalë, derisa i shoqi ta arrinte aty? Do të ishte akoma edhe më bukur, reflektoi ajo, sikur të rrëshqiste vjedhurazi në korije dhe të ikte, të zhdukej nga faqja e dheut prej tij, dhe kur ai, i lodhur nga delet të digjej prej dëshirës për ta takuar atë, të kthehej aty ku monopati lakohej e të bashkohej me të shoqen.

Papritur, asaj i lindi një ide; për t'u menduar mirë qëndroi pa lëvizur.

Disa ditë më parë, i shoqi ishte larguar për të bërë një shëtitje me kalë; ajo nuk kishte dashur të shkonte me të, ndaj kishte dalë me Bijou-n për të shëtitur në pronat e veta. Duke lodruar, Bijou e kishte çuar drejt e në një korije. Tek e ndiqte atë, duke u futur me kujdes nëpër shkurrë, ajo hasi në një lëndinë në mes të saj, një hapësirë e ngushtë kjo që i ngjante një kamare të vogël me perde të trasha e të gjelbra armaçi dhe perde të qëndisura me ar, me një kapacitet strehues për dy a tre veta. Në atë çast ajo ndjeu sikur kishte mbërritur në zemrën e shtëpisë së saj të re. Sikur sot të mund ta gjente atë vend përsëri do të ngulej aty pa lëvizur, e fshehur nga tërë bota. Sigismund-i do ta kërkonte skutë më skutë; ai nuk do të arrinte ta kuptonte se ç'kishte ndodhur me të, dhe për një minutë, një minutë të shpejtë – ose, ndoshta, nëse ajo tregohej e fortë dhe mizore, për pesë minuta – ai do ta kuptonte sesa vend i varfër, i zymtë dhe i tmerrshëm do të ishte universi pa të. Ajo e shqyrtoi korijen me hollësi për të gjetur aty një hyrje të pranueshme drejt vendit të fshehtë, dhe kështu hyri brenda.

Ajo bëri shumë kujdes që të mos bënte asnjë lloj zhurme, për këtë arsye lëvizi përpara jashtëzakonisht ngadalë. Kur një degëz kapi dantellat e fundit të saj të gjerë, me shumë vëmendje, ajo e largoi degëzën nga fundi i kambrikut me qëllim që ai të mos grisej. Në një moment të caktuar, kaçurrelat e saj të gjatë e të artë ngecën në një degë; me krahët e ngritur lart, ajo qëndroi në vend për ta larguar degën. Pak më tej, në brendësi të korijes, toka u bë më e lagët; hapat e saj të lehtë nuk dëgjoheshin më. Me një rrën dorë ajo mbante pranë buzëve një shami të vogël, si të donte të vinte në dukje fshehtësinë e hapave të saj. Vendin që kërkonte e gjeti, ndaj dhe u përkul për ta ndarë gjethnajën në mes që të hapte njëfarë dere për kthinën e saj të fshehtë në mes të korijes. Në përpjekje e sipër këmba i kapi palën e fustanit, ajo ndali dhe e liroi atë. Tek u ngrit, sytë i pushuan mbi fytyrën e një njeriu që ndodhej në strehë.

Ai u ngrit dhe drejtoi trupin dy hapa larg saj. Duhej ta kishte parë tek ajo avanconte drejt tij.

Ai e përpiu Lise-n me një vështrim të vetëm. Fytyra e tij ishte e mavijosur dhe e çjerrë, duart dhe qafëzat e duarve ishin të ndotura me papastërti të një ngjyre të errët. Ishte i veshur me lecka, këmbëzbathur, dhe me rrecka që i mbështillnin nyjat e zhveshura të këmbëve. Krahët i vareshin në të dy anët e trupit, ndërsa dora e djathtë mbante shtrënguar dorëzën e një thihe. Ai ishte pothuajse moshatar me të. Burri dhe gruaja vështruan njëri tjetrin.

Ky takim në mes të pyllit, nga fillimi deri në fund, kaloi pa asnjë fjalë; ajo çka ndodhi mund të jepet vetëm nëpërmjet pantomimës. Për të dy aktorët e pantomimës, ajo zgjati pafund; sipas orës, vetëm katër minuta.

Me rrezikun ajo nuk ishte ndeshur kurrë në jetë. Nuk i ra fare ndërmend as të gjykonte se në çfarë pozicioni ndodhej, dhe as ta saktësonte sasinë e kohës që do t'i

duhej për ta thirrur të shoqin ose Mathias-in, të cilin në atë çast e dëgjoi tek thërriste qentë e tij. Ajo e shikoi njeriun që qëndronte përballë saj ashtu siç do të kishte parë një fantazmë pylli: vetë akti i shfaqjes së fantazmës, jo ajo që vijon më pas, ia ndryshon perceptimin e botës personit i cili përballlet me të.

Edhe pse nuk ia ndau sytë fytyrës që kishte përballë, ajo e ndjeu se vendi i fshehtë ishte shndërruar në një strehë. Dy thasë të hedhur përtokë formonin një farë shtrati; disa kocka të brejtura me dhëmbë qëndronin aty pranë. Gjatë natës ai duhej të kishte ndezur zjarr, sepse përtokë kishte prush të shpërndarë andej e këtej.

Pas disa çastesh ajo vuri re se ai po e vëzhgonte ashtu siç po bënte dhe ajo. Tashmë, nga njëra anë, ai jo vetëm që ishte zbuluar se ku fshihej, por ishte dhe gati t'i bënte hov asaj; sidoqoftë, i sigurt, ai po mendohej ta kuptonte se çfarë kishte ndodhur. Nga ana tjetër, ajo e identifikoi veten me një kafshë të egër që ishte zënë pisk në strukën e tij të errët: figura e saj e bardhë që avitej me qetësi mund ta nënkuptonte vdekjen.

Ai lëvizi krahun e djathtë derisa e la atë të lirë të varej midis këmbëve të tij. Pa lëvizur dorën, ai përkuli qafëzën e saj dhe, pak nga pak, ngriti majën e thikës, të cilën e drejtoi nga fyti i saj. Ishte një veprim i çmendur,



i pabesueshëm. Gjatë kësaj manovre ai nuk buzëqeshi fare, por flegat e hundës i lëvizën, dhe cepat e gojës iu drodhën pak. Më pas, ai futi me kujdes thikën në millin që mbante në brez.

Me përjashtim të unazës së martesës, të cilën i shoqi ia kishte vënë në kishë një javë më parë, ajo nuk kishte sende me vlerë. Ajo e hoqi unazën pikërisht në kohën kur shamia e dorës i ra në tokë. Dora e saj, bashkë me unazën, u shtri drejt tij. Lise nuk po hynte në pazar për jetën. Natyra e saj nuk dinte ç'ishte frika, kurse tmerri që ai i po ia kallte nuk ishte frika se çfarë mund të pësonte prej tij. Ajo e urdhëroi, iu lut që të zhdukej siç kishte ardhur, por edhe që të trembej prej pranisë së saj; në fund të fundit, ajo nuk duhej të ishte futur aty. Me këtë veprim të pamatur, pamja e saj e jashtme, e një vajze të re, kishte autoritetin e madh të një priftëreshe që me një gjest të shenjtë përzë një qenie monstruoze.

Me shumë kujdes ai zgjati dorën drejt dorës së saj, gishtat e tij prekën gishtat e saj, por dora e saj nuk lëvizi aspak gjatë prekjes. Unazën, ama, ai nuk e mori. Në kohën që ajo e la dorën të lirë, unaza ra përtokë ashtu siç kishte ndodhur edhe me shaminë e dorës.

Për një çast, sytë e të dyve ndoqën rënien e unazës në

tokë. Unaza u rrokullis disa centimetra në drejtimin e tij, dhe më në fund u ndal pranë këmbës së tij të zbathur. Me një veprim të paperceptueshëm ai e shkëlmoi unazën tutje duke ia ngulur sytë përsëri fytyrës së saj. Që të dy qëndruan ashtu; nga njëra anë, ajo nuk ishte në gjendje të thoshte sesa kohë zgjati kjo, nga ana tjetër e ndjeu se diçka kishte ndodhur, gjërat kishin ndryshuar.

Ai ul në gjunjë dhe ngriti shaminë e dorës nga toka. Duke e kundruar gjatë gjithë kohës, ai sërish nxori thikën nga milli dhe e mbështolli atë me një palë nga fustani i saj prek kambriku. Kjo nuk ishte aspak e lehtë për t'u bërë, sepse krahun e majtë e kishte të thyer. Tek veptroi kështu, nxirja nga dielli dhe ndotja që kishte në fytyrë filluan të zbardheshin derisa u shndërruan tërësisht në vezulluese. Duke kërkuar me të dyja duart, ai përsëri futi thikën në milli. Ose milli ishte shumë i madh dhe kurrë nuk kishte qenë i madhësisë së duhur, ose tehu ishte ngrënë shumë – thika pushoi në milli. Për dy – tre sekonda të tjera shikimi i tij vazhdoi të pushojë mbi fytyrën e saj; më pas, ai e ngriti disi fytyrën e tij bashkë me ndriçimin që qëndronte ende mbi të, dhe mbylli sytë.

Lëvizja ishte përfundimtare dhe e pakushtëzuar. Me këtë lëvizje ai bëri atë që ajo i kishte kërkuar të bënte: ai u zhduk njëherë e mirë. Ajo ishte e lirë.

Lise bëri një hap prapa, me fytyrën e ngrirë dhe të verbër ende përballë saj, ajo u ul në gjunjë ashtu siç kishte bërë kur ishte futur në strehë, dhe më pas rrëshqiti jashtë pa kurrfarë zhurme me të njëjtën mënyrë që ishte futur aty. Me të dalë jashtë korijes, ajo qëndroi për një çast duke hedhur vështrimin rreth e rrotull në kërkim të rruginës së livadhit, dhe pasi e gjeti atë, mori rrugën në drejtim të shtëpisë.

I shoqi ende nuk e kishte lakuar anën e korijes. Por ja tek e pa dhe e përshëndeti me një gëzim të madh; ai iu afrua me shpejtësi dhe u bashkua me të.

Rrugina ishte aq e ngushtë saqë ai, pa e prekur Lise-n, qëndronte një gjysmë trupi pas saj. Ai filloi t'i shpjegojë asaj se çfarë kishte ndodhur me shtjerrat. Tek hidhte një hap para tij, ajo mendonte: Gjithçka ka marrë fund.

Pas njëfarë kohe ai vuri re se ajo heshte, ndaj dhe i erdhi pranë për ta shikuar në sy dhe për ta pyetur, 'Si është puna?'

Ajo kërkoi diku në mendjen e saj diçka për të thënë, dhe më në fund tha: 'Humba unazën.'

'Cilën unazë?' pyeti ai.

'Unazën e martesës,' u përgjigj ajo.

Tek dëgjoi zërin e vet të nyjëtonte fjalët ajo konceptoi kuptimin e tyre.

Unaza e dasmës. 'Me këtë unazë' – të hedhur poshtë nga njëri dhe shkëlmuar tutje nga tjetri – 'me këtë unazë martohem me ty.' Me këtë unazë të humbur ajo ishte martuar me diçka. Me çfarë? Me varfërinë, persekutimin, vetminë totale. Me pikëllimet dhe mëkatën e kësaj toke. 'Prandaj, atë çka Zoti e ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.'

'Do t'ju marrë një unazë të re,' tha i shoqi. Ti dhe unë jemi po ata që ishim në ditën e dasmës; unaza do të jetë po aq e mirë. Ma do mendja se edhe sot ne jemi burrë e grua, në të njëjtat përmasa që ishim edhe dje. Fytyra e saj ishte aq e qetë, saqë ai nuk mund ta përcaktonte nëse ajo e kishte dëgjuar atë që ai tha. Fakti që humbja e unazës e kishte shqetësuar aq shumë të shoqen, e preku. Ai ia mori dorën dhe e puthi. Dora e saj ishte e ftohtë, jo tamam dora që kishte puthur herën e fundit. Ai u ndal që edhe ajo të ndalej bashkë me të.

'A të kujtohet se në cilin vend e kishe unazën në dorë për herë të fundit?' pyeti ai.

'Jo,' u përgjigj ajo.


'A ke ndonjë ide,' pyeti ai, 'se ku mund ta kesh humbur?'

'Jo,' u përgjigj ajo. 'As që e kam idenë.'

Përktheu nga anglishtja:
Aristidh Shqevi
Oslo, 31.12.2020

Homer

ILIADA



Në shqip nga
LLAMBRO RUCI

BOTIMET TOENA